

ENVER HOXHA

ME STALININ

Kujtime

*ME RASTIN
E 100-VJETORIT TE LINDJES
SE MARKSIST-LENINISTIT TE MADH
JOSIF STALIN*

NË NJËQINDVJETORIN E LINDJES SË JOSIF STALINIT

Më 21 dhjetor të këtij viti mbushen 100 vjet nga .dita e lindjes së Josif Stalinit, njeriut shumë të dashur dhe udhëheqësit të shquar të proletariatit rus e ndërkombëtar, mikut besnik të popullit shqiptar, mikut të shtr enjtë të popujve të shtypur të mbarë botës, që luftojnë për tiri, pavarësi, demokraci dhe socializëm.

Gjithë jeta e Stalinit është karakterizuar nga lufta e pandërprerë dhe e ashpër kundër kapitalizmit rus, kundër kapitalizmit botëror, kundër imperializmit, kundër rrymave dhe korenteve antimarksiste e antileniniste, që ishin vënë në shërbim të kapitalit dhe të reaksionit botëror. Ai, nën ttdhëheqjen e Leninit dhe përkrah tij, ka qenë një nga frymëzuesit dhe udhëheqësit e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit, militant i papërkulur i Partisë Bolshevike.

Pas vdekjes së Leninit, Stalini udhëhoqi për 30 vjet me radhë luftën për fitoren dhe mbrojtjen e socializmit në Bashkimin Sovjetik. Për këto arsye, në zemrat e proletariatit botëror dhe të po pujeve të botës zënë një vend të madh dashuria, respekti dhe besnikëria ndaj veprës dhe personit të tij. Po për këto arsye, borgjezia kapitaliste dhe reaksioni botëror kanë një armiçësi të pakufishme për këtë nxënës besnik dhe bashkëluftëtar të shquar e të vendosur të Vladimir Iliç Leninit.

Stalini hyri në radhën e klasikëve të mëdhenj të marksizëm-leninizmit me luftën e tij të rreptë e parimore në mbrojtjen, zbatimin me konsekuencë dhe zhvillimin e mëtejshëm të ideve të Marksit, të Engelsit e të Leninit. Ai, me mprehtësinë dhe aftësinë e tij të veçantë, diti të orientohet drejt edhe në kohë shumë të vështira, kur borgjezia dhe reaksioni bënë çmos që të pengonin fitoren e Revolucionit të Madh Socialist të Tetorit.

Vështirësitë që qëndronin para proletariatit rus për realizimin e aspiratave të tij, ishin të mëdha, sepse në Rusi e në botë sundonte kapitalizmi. Por tashmë kapitalizmi kishte krijuar varrmihësin e tij, proletariatin, që ishte klasa më revoluciondre, e cila duhej të udhëhiqte revolucionin. Kjo klasë do ta kryente me sukses misionin e saj historik në luftë të pamëshirshme kundër armiqtve dhe, me këtë luftë, do të fitonte të drejtat dhe liritë, do të mente pushtetin politik në duart e veta. Në këtë rrugë proletariati do t'ia rrëmbente fuqinë politike dhe ekonomike borgjezisë kapitaliste shtypëse e shfrytëzuese dhe do të ndërtonte botën e re.

Marksit dhe Engelsit krijuan shkencën proletare të revolucionit e të socializmit shkencor. Ata kishin themeluar Shoqatën Ndërkombëtare të Punëtorëve, që njihet me emrin Internacionalja e Parë. Parimet themelore të kësaj organizate të parë ndërkombëtare të punëtorëve i përmbante Manifesti i saj Kushtetues, i cili përcaktoi rrugën e proletariatit drejt zhdukjes së pronës private mbi mjetet e

prodhimit, krijimin e partisë së proletariatit për të marrë në dorë pushtetin me rrugë revolucionare, si dhe luftën që duhet të bëjë proletariati kundër kapitalizmit dhe oportunitizmit, që u shfaq në forma «teorike» të ndryshme, në vende të ndryshme.

Vladimir Iliç Lenini, vazhduesi gjenial i veprës së Karl IVTarksit dhe Frederik Engelsit, duke u bazuar në veprat madhore të tyre dhe dukë i mbrojtur ato me një zotësi të rrallë, e zhvilloi luftën kundër rrymave të revizionistëve, oportunistëve dhe renegatëve të tjerë. Tradhtarët e hodhën tej flamurin e madh të Internacionales së Parë dhe e shkelën në mënyrë fare të hapur parullën e Manifestit Komunist «Proletarë të të gjitha vendeve, bashkohuni!». Këta renegatë të marksizmit votuan për kreditë e luftës imperialiste, në vend që t'i kundërviheshin asaj.

Lenini shkroi vepra kapitale për mbrojtjen dhe zhvillimin e marksizmit. Ai pasuroi veçanërisht idetë e Marksit e të Engelsit për ndërtimin e shoqërisë socialiste e komuniste. Duke pasur kurdoherë parasvsh zhvillimin materialist të historisë, si dhe kushtet e vendit e të kohës kur jetonte ai, Lenini luftoi për krijimin dhe konsolidimin e Partisë Bolshevike. Vladimir Iliçi dhe bolshevikët e tjerë, me një luftë intensive revolucionare, brenda dhe jashtë Rusisë, në kushtet e kalbëzimit të carizmit e të ushtrisë së tij, përgatitën dhe shpërthyen Revolucionin e Madh proletar Socialist.

Plani gjenial i Leninit për triumfin e revolucionit u realizua. Pasi u kurorëzua me sukses Revolucionin i madh, që tronditi botën e vjetër dhe hapi një epokë të re në historinë e njerëzimit, epokën e zhdukjes së shfrytëzimit e të shtypjes, Lenini vazhdoi luftën për ngritjen e shtetit të parë socialist. Tok me Leninin luftoi e punoi edhe bashkëpunëtori i tij i devotshëm, Josif Visarionoviç Scalini.

Është e kuptueshme se pse kundër ideve të Marksit, të Engelsit e të Leninit, kundër veprimeve të drejta, të vendosura e të palëkundshme të tyre, në dobi të klasës punëtore dhe të popujve, nuk mund të rrinte pa u ngritur borgjëzia, e cila, pa ngurrim, me egërsi dhe me vazhdimësi, pa u ndalur asnjëherë, drejtoi armët e ndryshme të saj.

Kësaj armiqësie të madhe e të organizuar të kapitalizmit dhe të borgjezisë reaksionare botërore, iu vu përballë forca e madhe e organizuar dhe e pamposhtshme e proletariatit rus në unitet me proletariatin botëror. Ky ballafaqim ishte shprehje e një lufte të ashpër klasash brenda dhe jashtë Rusisë, që u duk gjatë gjithë kësaj kohe në ndeshjet me forcat e intervencionit dhe me mbeturinat e carizmit e të reaksionit rus. Këta armiq duheshin luftuar pa mëshirë.

Në këtë proces lufte klasore duhej kalitur Partia Bolshevike, duhej ndërtuar shteti i diktaturës së proletariatit si çështje kryesore e revolucionit dhe duheshin hedhur themelet e ekonomisë socialiste. Pra, duheshin zhvilluar reforma rrënjësore në të gjithë sektorët e jetës, por në një rrugë të re, me një frymë të re, me një qëllim të ri; duhej zbatuar në mënyrë krijuese dhe në kushtet konkrete të Rusisë cariste teoria e Marksit mbi filozofinë, ekonominë politike dhe socializmin shkencor.

Të gjitha këto synime do të realizoheshin nën udhëheqjen e proletariatit, si klasa më e përparuar dhe më revolucionare, duke u mbështetur në aleancën me fshatarësinë e varfër e të mesme. Pas krijimit të pushtetit të ri duhej bërë një luftë e madhe, heroike, për të përmirësuar jetën ekonomike dhe kulturore të popujve të çliruar nga zgjedha e carizmit dhe e kapitaleve të huaja evropiane. Në këtë luftë vigane Stalini qëndroi i patundur përkrah Leninit, ai ishte luftëtar i radhës së parë.

Sa më shumë konsolidohej politikisht pushteti i ri sovjetik, sa më shumë zhvillohej industria në të gjitha degët e saj, sa më shumë zhvillohej bujqësia kolkoziane, sa më tepër zhvillohej kultura e re socialiste në Bashkimin Sovjetik, aq më e ashpër bëhej rezistenca e armiqve të jashtëm dhe e reaksionit të brendshëm. Kjo luftë e armiqve u shtua veçanërisht pas vdekjes së Vladimir Iliç Leninit.

Stalini u betua para trupit të Leninit, se do të ndiqte me besnikëri mësimet e tij, do të zbatonte porositë e tij për të ruajtur të pastër emrin e lartë të komunistit, për të ruajtur e për të forcuar unitetin e Partisë Bolshevike, për të ruajtur e për të çelikosur pa pushim diktaturën e proletariatit, për të forcuar vazhdimisht aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë, për t'u qëndruar besnik deri në fund parimeve të internacionalizmit proletar, për ta mbrojtur shtetin e parë socialist nga synimet e armiqve të brendshëm borgjezë e çifligarë dhe të armiqve të jashtëm imperialistë për shkatërrimin e tij, për të çuar deri në fund ndërtimin e socializmit në një të gjashtë të botës.

Josif Stalini e mbajti fjalën. Në krye të Partisë Bolshevike, ai diti të udhëhiqte ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe ta bënte atdheun e madh të proletariatit rus dhe të të gjithë popujve të Bashkimit Sovjetik një mbështetje kolosale për revolucionin botëror. Ai u tregua vazhdues i dënjë i veprës së Marksit, të Engelsit e të Leninit dhe dha prova të shkëlqyera se ishte marksist-leninist i madh, i qartë e i vendosur.

Armiqtë e brendshëm në Bashkimin Sovjetik. trockistët, buharinistët, zinovievistët e të tjerë ishin të lidhur ngushtë me kapitalistët e jashtëm, sepse ishin bërë vegla të tyre. Disa nga ata qëndronin brenda radhëve të Partisë Bolshevike, që ta merrnin kalanë nga brenda, të çoroditnin vijën e drejtë marksiste-leniniste të kësaj partie, me Stalinin në krye, kurse disa të tjerë rrinin jashtë radhëve të partisë, por brenda shtetit, dhe komplotonin e sabotonin në mënyrë të maskuar e të hapur ndërtimin e socializmit. Në këto situata Stalini zbatoi me këmbëngulje një ndër porosinë kryesore të Leninit për spastrimin pa ngurrim të partisë nga të gjithë elementët oportunistë, nga çdo kapitullues përpara presionit të borgjezisë e të imperializmit dhe përpara çdo pikëpamjeje të huaj për marksizëm-leninizmin. Lufta që ka bërë Stalini në krye të Partisë Bolshevike kundër trockistëve e buharinistëve, është vazhdim i drejtpërdrejtë i luftës së Leninit, luftë kjo thellësisht parimore, shpëtimtare, pa të cilën s'do të kishte as ndërtim të socializmit, as mundësi për mbrojtjen e tij.

Josif Stalini e dinte se fitoret mund të arriheshin e të mbroheshin me përpjekje, me sakrifica, me djersë dhe me luftë. Ai asnjëherë nuk u tregua optimist pa baza për fitoret që arriheshin dhe asnjëherë nuk ra në pesimizëm për vështirësitë që dilnin. Përkundrazi, Stalini u tregua një personalitet jashtëzakonisht i pjekur dhe i matur në mendime, në vendime, në veprime. Ai, si njeri i madh që ishte, mundi të fitonte zemrën e partisë e të popullit, të mobilizonte energjitë e tyre, të kaliste militantët në beteja dhe t'i ngrinte ata politikisht e ideologjikisht për të realizuar një vepër të madhe, të paparë ndonjëherë.

Planet pesëvjeçare staliniane për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës ishin ato që e shndërruan vendin e parë socialist në botë në një fuqi të madhe socialiste. Duke u udhëhequr nga mësimi i Leninit mbi përparësinë e industrisë së rëndë në industrializimin socialist, Partia Bolshevike me Stalinin në krye, e pajisi vendin me një industri shumë të fuqishme të prodhimit të mjeteve të prodhimit, me një industri vigane makinaprodhuese, të aftë për të siguruar një zhvillim të shpejtë të të gjithë ekonomisë popullore, të gjitha mjetet e nevojshme, si dhe për të siguruar një mbrojtje të pathyeshme. Industria e rëndë socialiste u ngrit, sig thoshte Stalini, «me forcat e brendshme, pa kredi dhe hua skllavëruese nga jashtë». Stalini e kishte bërë të qartë se shteti sovjetik, në ngritjen e industrisë së rëndë s'mund të ndiqte rrugën që ndjekin vendet kapitaliste, duke marrë hua të jashme ose dulce grabitur vendet e tjera.

Pas kolektivizimit të bujqësisë në Bashkimin Sovietik u ndërtua një bujqësi socialiste moderne, e mbështetur në një mekanikë të fuqishme bujqësore e, prodhim i industrisë së rëndë socialiste, dhe u zgjidh kështu problemi i drithit e i produkteve të tjera kryesore bujqësore e blegtorale. Ishte Stalini ai që e përpunoi më thellë planin kooperativist të Leninit, që e udhëhoqi zbatimin e këtij plani në luftë të ashpër me armiqtë e socializmit, me kulakët, me tradhtarët buharinistë, me vështirësitë e pengesat e panumërta, që rridhnin jo vetëm nga veprimtaria armiqësore, por edhe nga mungesa e përvojës, edhe nga ndjenja e pronës private që kishte rrënjë të thella në ndërgjegjen e fshatarëve.

Forcimi ekonomik e kulturor i dha dorë konsolidimit të shtetit të diktaturës së proletariatit në Bashkimin Sovjetik. Në krye të Partisë Bolshevike Stalini diti ta organizojë dhe ta drejtojë me mjeshtëri shtetin sovjetik, ta përsosë më tej funksionimin e tij dhe të zhvillojë kurdoherë në rrugën marksiste-leniniste strukturën dhe superstrukturën e shoqërisë në bazë të situatave politike dhe të zhvillimit ekonomik të brendshëm, pa harruar as situatat e jashtme, domethënë synimet grabitqare dhe intrigat e urryera që ndërmerrnin shtetet borgjezo-kapitaliste për t'i vënë gurë në rrota ndërtimit të shtetit të ri të proletarëve.

Kapitalizmi botëror e shikonte Bashkimin Sovjetik si armikun e tij të rrezikshëm, prandaj u përpoq ta izolonte nga jashtë, kurse nga brenda inkurajoi dhe organizoi komplotet e renegatëve, spiunëve, tradhtarëve e djathtistëve. Kundër këtyre armiqtë të rrezikshëm diktatura e proletariatit goditi pa mëshirë. Të gjithë tradhtarët u gjykuan publikisht. Fajësia e tyre në atë kohë u vërtetua me prova të

pakundërshtueshme dhe në mënyrën më bindëse. Për gjyqet që u zhvilluan në Bashkimin Sovjetik, në bazë të legjislacionit revolucionar kundër trockistëve, buharinistëve, radekëve, zinovievëve, kamenievëve, piatakovskëve dhe tukaçevskëve, u bë një zhurmë e madhe nga propaganda borgjeze, e cila e shtoi më tepër dhe e ngriti në sistem zhurmën e saj shpifëse e denigruese kundër luftës së drejtë të pushtetit sovjetik, të Partisë Bolshvike dhe të Stalinit, që mbronin jetën e popujve të tyre, mbronin sistemin e ri socialist të ngritur me djersën dhe me gjakun e punëtorëve e të fshatarëve, mbronin Revolucionin e Madh të Tetorit dhe pastërtinë e marksizëm-leninizmit.

Ç'nuk shpifën armiqtë e jashtëm, veçanërisht për Josif Stalinin, vazhduesin e veprës së Marksit dhe të Leninit, udhëheqësin e talentuar të Bashkimit Sovjetik, të cilin e akuzuan si «tiran», si «vrasës» dhe «gjakatar». Të gjitha këto shpifje shquheshin për cinizmin e tyre. Jo, Stalini nuk ishte tiran, nuk ishte despot. Ai ishte njeri parimor, i drejtë, i thjeshtë, i dashur e shumë i vëmendshëm ndaj njerëzve, ndaj kuadrove, ndaj bashkëpunëtorëve të tij. Kjo është arsyeja që atë e donin aq shumë Partia e tij, popujt e Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, gjithë proletariati botëror. Kështu e kanë njohur atë miliona komunistë dhe personalitete të shquara, revolucionarë e përparimtarë në botë. Duke shkruar për figurën e Stalinit, Anri Barbysi, në librin e tij «Stalini», ndër të tjera, thotë: «Ai u vu dhe qëndron në kontakt me popullin punëtor, fshatar a'he intelektual të BRSS, si dhe me revolucionarët e hotës. që kanë në zemër atdheun e tyre - pra me shumë më tepër se 200 milionë veta». Dhe shtonte: «Ky njeri i qartë dhe mendjendritur është njeri i thjeshtë. . . Ai qesh si fëmija . . . Nga shumë anë, Stalini i ngjet të jashtëzakonshmit V. Iliç: i njëjti zotërim i teorisë, i njëjti sens i praktikës, e njëjta vendosmëri. . . Te Stalini, më shumë se kudo gjatë, gjenden mendimi dhe fjala e Leninit. Ai është Lenini i sotëm».

Të gjitha mendimet dhe veprat e Stalinit, të shkruara dhe të zbatuara në jetë, përshkohen si fill i kuq nga idetë konsekuente revolucionare marksiste-leniniste. Asnjë gabim parimor nuk mund të gjendet në veprat e këtij marksist-leninisti të shquar. Vepra e tij ishte e peshuar në interes të proletariatit, të masave punonjëse, në interes të revolucionit, të socializmit e të komunizmit, në interes të luftërave nacionalçlirimtare dhe antiimperialiste. Ai nuk ishte eklektik në mendimet teorike e politike dhe as i lëkundshëm në veprimet praktike. Kush mbështetej në miqësinë e singertë të Josif Stalinit, ishte i sigurt në ecjen përpara, drejt një të ardhmeje të lumtur për popullin e vet. Kush dredhonte, nuk mund t'i shpëtonte vigjilencës dhe gjykimit të mprehtë të Josif Stalinit. Ky gjykim e kishte burimin tek idetë e mëdha të teorisë marksiste-leniniste, që ishin kristalizuar në mendjen e tij të zgjuar dhe në shpirtin e tij të pastër. Ai gjithë jetën diti ta mbante fort e ta orientonte drejt timonin e socializmit, edhe midis dallgëve e stuhive të armiqve.

Stalini dinte kur dhe në ç'masë duheshin bërë kompromise, me kusht që këto të mos cenonin ideologjinë marksiste-leniniste, por, përkundrazi, t'u silinin dobi revolucionit, socializmit, Bashkimit Sovjetik dhe miqve të Bashkimit Sovjetik.

Proletariati, partitë marksiste-leniniste, komunistët e vërtetë dhe të gjithë njerëzit përparimtarë në botë i gjenin të drejta, të arsyeshme dhe të domosdoshme veprimet shpëtimtare të Partisë Bolshvike dhe të Stalinit në mbrojtje të shtetit dhe të rendit të ri ekonomik-shoqëror socialist. Vepra e Stalinit aprovohej nga proletariati dhe nga popujt e botës, sepse e shikonin që ai luftonte kundër shtypjes e shfrytëzimit, të cilat ata i ndienin në kurrizin e tyre. Popujt dëgjonin të shpifej kundër Stalinit pikërisht nga ata përbindsha që organizonin torturat dhe vrasjet në masë në shoqërinë kapitaliste, nga ata që ishin shkaktarë të urisë, të varfërisë, të papunësisë e të sa e sa mjerimeve, prandaj nuk u besonin shpifjeve.

Kundër këtyre armiqve milionat e proletarëve në botë ngriheshin në greva të mëdha e në demonstrata të fuqishme nëpër rrugët e qyteteve, ku sulmonin fabrikat dhe uzinat e kapitalistëve. Popujt ngriheshin në luftë kundër kolonizatorëve për të fituar të drejtat dhe liritë demokratike. Në të njëjtën kohë kjo ishte një përkrahje ndërkombëtare e gjithanshme që i bëhej Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit, e cila ndikoi për fuqizimin e shtetit të ri të sovjetëve, për rritjen e autoritetit të tij të madh në botë.

Të gjithë komunistët, nga të katër anët e botës, që luftonin kundër kapitalizmit botëror, u quajtën nga borgjezia dhe nga renegatët e marksizëm-leninizmit «agentë» të Bashkimit Sovjetik e të

Stalinit. Por komunistët ishin njerëz të ndershëm, ata nuk qenë agjuntura të kurrkujt, ishin vetëm përkrahës besnikë të doktrinës së Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Ata e përkrahnin Bashkimin Sovjetik, sepse në politikën e tij shihnin mbështetjen e tyre të madhe për triumfin e ideve komuniste, shihnin shembullin e qartë se si duhej t'i zhvillonin luftën dhe përpjekjet për të fituar betejat njëri pas tjetrit, për të mposhtur armiqtë, për të hequr qafe zgjedhën e pushtetit të kapitalit dhe për të ngritur rendin e ri shoqëror socialist.

Ndërsa kapitalizmi botëror, si rend i vjetër në kalbëzim, po dobësohej, socializmi në Bashkimin Sovjetik, si rend i ri i së ardhmes, po triumfoje dhe po bëhej gjithnjë e më shumë një mbështetje e fortë për revolucionin botëror. Në këto rrethana kapitalizmit i duhej absolutisht të përdorte të gjitha mjetet për ta goditur për vdekje shtetin e madh socialist të proletarëve, i cili i tregonte botës rrugën e shpëtimit nga shfrytëzimi, prandaj kapitalistët përgatitën dhe shpërthyen Luftën e Dytë Botërore. Ata mëkëmbën, mbështetën, nxitën dhe i armatosën hitlerianët për «luftën kundër bolshevizmit», kundër Bashkimit Sovjetik dhe për të realizuar ëndrrën e tyre të «hapësirës jetike» drejt Lindjes. Bashkimi Sovjetik e kuptoi rrezikun që e kërcënoje. Stalini ishte vigjilent, ai e dinte mirë se shpifjet e kurdisura nga borgjezia kapitaliste ndërkombëtare kundër tij, se gjoja ai nuk po e luftonte nazizmin dhe fashizmin që po ngrihej, ishte një slogan i natyrshëm i kësaj borgjezie dhe i kolonës së pestë hitleriane për të mashtruar opinionin publik e për të realizuar planet e tyre të sulmit kundër Bashkimit Sovjetik.

Fashizmi ishte cilësuar me të drejtë nga Kongresi i 7-të i Kominternit, më 1935, si armiku më i madh i popujve në rrethanat konkrete të asaj kohe. Ky Kongres, me iniciativën e drejtpërdrejtë të Stalinit, kishte hedhur parullën e frontit të përbashkët popullor antifashist, që duhej të krijohej në edo vend, me qëllim që të demaskoheshin planet dhe veprimtaria agresive e grabitqare e shteteve fashiste, që të ngriheshin popujt kundër këtyre planeve e kësaj veprimtarie për të mënjeluar një luftë të re imperialiste që po rrezikonte botën.

Kurrë, në asnjë moment, Stalini nuk e harroi rrezikun që i kërcënohej t'i turrej Bashkimit Sovjetik. Në çdo kohë ai luftoi me vendosmëri dhe udhëzoi shumë qartë që partia të kaltej për luftëra të ardhshme, që popujt sovjetikë të bashkoheshin në një unitet të çeliktë marksist-leninist, që ekonomia sovjetike të forcohej në rrugën socialiste, që mbrojtja e Bashkimit Sovjetik të fuqizohej me mjete materiale e me kuadro dhe të kishte një strategji revolucionare me taktika revolucionare. Stalini ishte ai që tregonte e vërtetonte me fakte nga vetë jeta se imperialistët janë luftënxitës dhe se imperializmi është bartës i luftërave grabitqare, prandaj këshillonte që njerëzit të ishin vazhdimisht vigjilentë dhe kurdoherë të përgatitur kundër çdo veprimi të nazistëve hitlerianë, fashistëve italianë dhe militaristëve japonezë bashkë me fuqitë e tjera kapitaliste botërore. Fjala e Stalinit çmohej si floriri, ajo u bë udhërrëfyese për proletarët dhe për popujt e botës.

Stalini u propozoi qeverive të vendeve të mëdha kapitaliste të Evropës, Perëndimore që të krijohej një aleancë kundër murtajes hitleriane, por këto qeveri e refuzuan një propozim të tillë, bile ato shkelën edhe aleancat e nënshkruara më përpara me Bashkimin Sovjetik, sepse kishin shpresë që hitlerianët ta zhduknin «farën e bolshevizmit», kurse atyre t'ua nxirrnin gështenjat nga zjarri.

Përpara kësaj situatë serioze tepër të rrezikshme dhe në pamundësi që t'i bindte qeveritarët e të ashtuquajturave demokraci perëndimore për të lidhur një aleancë të përbashkët antifashiste, Stalini e gjeti të përshtatshme të punonte për ta shtyrë luftën kundër Bashkimit Sovjetik, që të fitonte kohë për forcimin e mëtejshëm të mbrojtjes. Për këtë qëllim ai nënshkroi Paktin e mosulmimit me Gjermaninë. Ky pakt do të shërbente si një modus vivendi për ta larguar rrezikun përkohësisht, se Stalini e shikonte agresivitetin hitlerian, ai ishte përgatitur dhe po përgatitej kundër tij.

Shumë politikanë e historianë borgjezë e revizionistë thonë e shkruajnë sikur agresioni hitlerian e gjeti Bashkimin Sovjetik të papërgatitur dhe për këtë ia hedhin fajin Stalinit! Mirëpo faktet e rrëzojnë poshtë këtë shpifje. Dihet se Gjermania hitleriane, si shtet agresiv, duke shkelur Paktin e mosulmimit, në mënyrë krejt të pabesë e pirateske, përfitoi nga befasia strategjike dhe nga epërsia numerike e një force shumë të madhe prej afër 200 divizionesh, të vetat dhe të aleatëve të sai, duke i hedhur ato në një «luftë-rrufe», me anën e së cilës, sipas planeve të Hitlerit, Bashkimi Sovjetik do të mposhtej e do të rrëzohej brenda jo më shumë se dy muajsh!

Por dihet se ç'ndodhi në të vërtetë. «Lufta-rrufe» që kishte pasur sukses gjithkund në Evropën Perëndimore, në Lindje dështoi. Ushtria e Kuqe, duke pasur një prapavijë shumë të fortë, me mbështetjen e gjithë popujve sovjetikë, në tërheqje i rraskapiti forcat e armikut derisa i gozhdoi, pastai i kundërsulmoi dhe me goditje të njëpasnjëshme i dërrmoi, sa më në fund e detyroi Gjermaninë hitleriane të kapitullonte pa kushte. Historia tashmë e ka fiksuar përjetë rolin vendimtar të Bashkimit Sovjetik për shkatërrimin e Gjermanisë hitleriane, për asgjësimin e fashizmit në përgjithësi në Luftën e Dytë Botërore.

Si mund të ndodhte që të dështonte plani i «luftës-rrufe» të Hitlerit kundër Bashkimit Sovjetik e që ky të luante një rol kaq të madh në shpëtimin e njerëzimit nga skllavëria fashiste pa një përgatitje paraprake të gjithanshme për rmbrojtje, pa një forcë e pa një vitalitet të çeliktë të sistemit socialist, që kaloi provën më të rëndë e më të madhe në Luftën e Dytë Botërore? Si mund të ndahen këto fitore nga roli i jashtëzakonshëm që ka luajtur Stalini si në përgatitjen e vendit për t'i bërë ballë agresionit imperialist, ashtu edhe në shkatërrimin e Gjermanisë hitleriane dhe në fitoren historike mbi fashizmin? Çdo përpjekje djallëzore e revizionistëve hrushovianë, për të ndarë Stalinin nga Partia e nga populli sovjetik në lidhje me rolin vendimtar të shtetit socialist në këtë fitore, bëhet copë e thërrime përpara realitetit historik, që s'ka forcë ta kundërshtojë ose ta zbehë, jo më ta fshijë. Lufta e popujve sovjetikë, me Stalinin në krye, çoi në çlirimin e një vargu të tërë vendesh e popujsh nga robëria naziste, bëri që të vendo se demokracia popullore në mjaft vende të Evropës Lindore, u dha nxitje të madhe luftërave nacionalçlirimtare, antiimperialiste e antikolonialiste, bëri kështu që të shthuret e të shembet sistemi kolonial, që të krijohet në botë një raport i ri forcash në dobi të socializmit e të revolucionit.

Hrushovi, me paturpësi, e akuzoi Stalinin si njeri «të mbyllur», që gjoja nuk i njihte situatën në Bashkimin Sovjetik dhe situatat në botë, që nuk paska ditur ku i kishte armatat e Ushtrisë së Kuqe dhe se i paska drejtuar ato duke u mbështetur në një glob shkollor!

Meritat e pakundërshtueshme të Stalinit kanë qenë detyruar t'i njohin edhe krerë të tillë të kapitalizmit botëror si Çerçilli, Ruzvelti, Trumani, Ideni, Montgomeri, Hopkinsi e të tjerë, pavarësisht se në të njëjtën kohë këta nuk e kanë mbajtur fshehur armiqtësinë për politikën dhe ideologjinë marksiste-leniniste e për vetë Stalinin. Unë kam lexuar kujtimet e tyre dhe kam parë se këta krerë të kapitalizmit flasin me respekt për Stalinin si burrë shteti dhe strateg ushtarak, e quajnë atë një njeri të madh «të pajisur me një sens strategjik të çuditshëm», «me një zgjuarsiri të paparë në kapjen shpejt të problemeve». Çerçilli për Stalinin ka thënë: «. . . Unë e respektoj këtë njeri të madh e të shkëlqyer. . . Shumë pak njerëz në botë mund t'i kuptonin kështu, në kaq pak minuta, çështjet nëpër të cilat ne humbim prej shumë muajve. Ai kishte kapur gjithçka brenda një sekonde».

Hrushovianët deshën të krijojnë iluzionin sikur jo Stalini, por ata e paskan udhëhequr Luftën e Madhe Patriotike të Bashkimit Sovjetik kundër nazizmit! Por njihet botërisht se ata, gjatë kësaj kohe, ishin struktur nën hijen e Stalinit, të cilit i këndonin himne hipokrite, duke thënë: «Gjithë fitoret dhe sukseset tona ia detyrojmë të madhit Stalin» etj., etj., në një kohe kur përgatiteshin për t'i hedhur në erë këto fitore. Himnet e vërteta, që diçin nga zemra, këndoheshin nga ushtarët e lavdishëm sovjetikë, që, me emrin e Stalinit në gojë, kishin vënë gjoksin në betejat historike.

Komunistët dhe populli shqiptar e kanë ndjerë shumë fort dhe nga afër (ndonëse ndodhegim shumë larg nga Bashkimi Sovjetik) rolin e madh të Stalinit në momentet më të rënda që kalonte vendi ynë gjatë pushtimit fashist italian e gjerman, kur vendosej fati i atdheut tonë, - të qëndronte në skllavëri apo të dilte në liri e në dritë.

Në ditët më të vështira të luftës, Stalini ndodhej kurdoherë pranë nesh. Ai na forconte shpresat, na ndriçonte perspektivën, na çelikeste zemrat dhe vullnetin, na shtonte besimin në fitore. Shumë herë, fjalët e fundit të komunistëve, të patriotëve, të partizanëve shqiptarë që jepnin jetën në fushën e betejës, përpara litarit, mitralozit ose automatikut të armikut, ishin «Rroftë Partia Komuniste!», «Rroftë Stalini!». Jo një herë ka ndo dhur që plumbat e armikut, duke shpuar zemrat e bijve dhe bijave të popullit tonë shponin njëkohësisht veprat e Stalinit, të cilat i mbanin si një thesar të shtrenjtë në gji.

Me gjithë përpjekjet e fshehta e të hapur a të a:miqve të brendshëm e të jashtëm të Bashkimit Sovjetik për të sabotuar socializmin pas Luftës së Dytë Botërore, drejtësia e politikës staliniane ishte ajo që jepte tonin në problemet e mëdha ndërkombëtare. Vendi i sovjetëve, i zhuritur nga lufta, që la në fushat e betejës 20 milionë veta, u rindërtua me një shpejtësi të habitshme. Kjo punë e madhe u bë nga populli sovjetik, nga klasa punëtore e fshatarësia kolkoziane, të udhëhequra nga Partia Bolshevike dhe nga Stalini i madh.

Në vitet e Luftës së Dytë Botërore, revizionizmi u duk me tradhtinë e Brauderit, ish-sekretar i përgjithshëm i PK të SHBA, i cili bashkë me shokët e tij revizionistë e shpërndanë partinë dhe u vunë në shërbim të imperializmit amerikan. Brauderi ishte për zhdukjen e çdo kufiri midis borgjezisë e proletariatit, midis kapitalizmit e socializmit, për sh'krirjen e tyre në një botë të vetme, ishte kundër revolucionit e luftës civile, për bashkëjetesën paqësore të klasave në shoqëri. Brauderi me këtë «vijë të bardhë», me politikën e tij kapitulluese, mund të themi se i parapriu Titos, i cili për shkak të pikëpamjeve e të qëndrimeve të tij antimarksiste dhe antileniniste hyri në konflikt ideologjik e politik me Bashkimin Sovjetik që në kohën e luftës, por ky konflikt shpërtheu hapur pas luftës. Pas shumë përpjekjesh me durim për ta sjellë në rrugë renegatin Tito, Stalini, Partia Bolshevike dhe të gjitha partitë e vërteta komuniste të botës, kur u bindën se ai ishte' i pandreqshëm, e dënuan njëzëri. U duk qartë se vepra e Titos ishte në shërbim të imperializmit botëror, prandaj u mbështet dhe u përkrah nga imperializmi amerikan dhe nga shtetet e tjera kapitaliste. Duke u bashkuar me korin e propagandës borgjeze dhe për t'i merituar kreditë që merrte nga imperialistët, Titoja, përveç të tjerave, shpifi se gjoja Stalini përgatiste sulmin kundër Jugosllavisë. Koha provoi që Titoja gënjente.

Në bisedat e ndryshme që kam pasur nderin e madh të kisha me Stalinin, ai më ka thënë që asnjëherë nuk është menduar dhe nuk mund' të mendohet që Bashkimi Sovjetik të sulmojë Jugosllavinë. Ne, thoshte Stalini, jemi komunistë' dhe kurrë nuk do të sulmojmë asnjë vend të huaj, pra as Jugosllavinë, por Titon dhe titistët do t'i demaskojmë, se kjo është detyra jonë si marksistë. Nëse e mbajnë në fuqi ose e rrëzojnë Titon në Jugosllavi, kjo është një çështje e brendshme, që' u takon ta zgjidhin popujt e Jugosllavisë, neve' nuk na përket të ndërhyjmë në këtë punë, thoshte ai.

Banda e Nikita Hrushovit u inkurajua dhe' u përkrah në shpifjet kundër Stalinit nga renegati Josip Broz Tito, që kishte dalë hapur që më përpara, si dhe më pas nga Mao Ce Duni me shokë e revizionistë të tjerë të kallëpeve të ndryshme. Të gjithë këta, në të vërtetë, ishin shërbëtorë të kapitalizmit për të shkatërruar nga brenda socializmin në Bashkimin Sovjetik, për të mos lejuar të ndërtohej socializmi në Jugosllavi dhe për të penguar ndërtimin e socializmit në Kinë dhe në gjithë botën, prandaj iu kundërvunë Stalinit, tek i cili shihnin njeriun e fortë, që sa ishte gjallë nuk mundën Via shkonin ujin nën rrogoz.

Këta tradhtarë ishin pasuesit e renegatëve socialdemokratë, revizionistë, oportunistë të Internacionales së Dytë, vazhduesit e veprës së tyre të palavdishme, në rrethana e në kushte të tjera. Ata pretenduan se po bënin organizime «të përshtatshme» luftime në përputhje me situatat dhe po :sajonin ide gjoja të reja për të «korrigjuar» dhe për të «plotësuar» marksizëm-leninizmin sipas «frymës së kohës» etj. Të gjithë këta fundërrina, pavarësisht nga ndonjë ndryshim formal që manifestonin në mendimet dhe në qëndrimet e tyre, synonin një objektivi: të luftonin marksizëm-leninizmin, të varrosnin ideologjinë mbi domQsdoshmërinë e revolucionit proletar, të shkatërronin socializmin, të shuanin luftën e klasave dhe të pengonin përmbysjen nga themelet të shoqërisë së vjetër kapitaliste.

Stalini ishte internacionalist i vërtetë. Ai mbante mirë parasysh veçorinë se shteti sovjetik u krijua nga bashkimi i shumë republikave, që përbëheshin nga shumë popuj, me shumë kombësi, prandaj organizimin shtetëror të këtyre republikave, ai e përsosi duke respektuar barazinë e të, drejtave në mes tyre. Me politikën e drejtë marksiste-leniniste, që ndoqi për çështjen nacionale, Stalini arriti të brumoste dhe të kaliste unitetin luftarak të popujve të ndryshëm të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike. Duke qenë në krye të Partisë e të shtetit sovjetik, ai kontribuoi që burgu i popujve, siç ishte Rusia e vjetër cariste, të kthehej në një vend të lirë, të pavarur e sovran, ku popujt dhe republikat të rronin në harmoni, në miqësi, në unitet dhe me të drejta të barabarta. Stalini i

njihte kombet dhe fermimin e tyre historik, njëhte karakteristikat e ndryshme të kulturës dhe të psikologjisë se çdo populli dhe i trajtonte ata në rrugën marksiste-leniniste.

Internacionalizmi i Josif Stalinit duket qartë edhe në marrëdhëniet që ishin ndërtuar në mes vendeve të demokracisë popullore, të cilat ai i konsideronte shtete të lira, të pavarura, sovraane, aleate të ngushta me Bashkimin Sovjetik. Ai asnjëherë nuk i përfytyroi këto shtete si të sunduara nga Bashkimi Sovjetik, qoftë politikisht, qoftë ekonomikisht. Kjo ishte një politikë e drejtë marksiste-leniniste që ndiqte Stalini.

Në kujtimet e mia kam shkruar për kërkesën që i kisha bërë Josif Stalinit më 1947 lidhur me krijimin e disa shoqërive të përbashkëta shqiptaro-sovietike, të cilat do të shfrytëzonin pasuritë e nëntokës sonë. Ai më tha se nuk bëjmë shoqëri të përbashkëta me vendet vëllezër të demokracisë popullore, më shpjegoi se edhe ndonjë hap që ishte bërë në fillim, në këtë drejtim, me ndonjë nga vendet e demokracisë popullore, e kishin konsideruar gabim dhe kishin hequr dorë. Ne, vazhdoi Stalini, e kemi për detyrë t'u japim vendeve të demokracisë popullore teknologjinë që disponojmë, ndihmën ekonomike që kemi mundësi të japim dhe do të jemi kurdoherë gati t'i përkrahim. Kështu mendonte dhe kështu veproi Stalini.

Përkundrazi, hrushovianët nuk ndoqën një rrugë të tillë, ata u futën në rrugën e bashkëpunimit djallëzor kapitalist, duke krijuar me vendet e ish-demokracisë popullore një «unitet» ushtarak, politik dhe ekonomik -në interes të tyre dhe në dëm të tjerëve.

Traktatin e Varshavës ata e kthyen në një instrument për të mbajtur nën zgjedhë kolonitë e reja të tyre, me forma dhe me mënyra gjoja socialiste. Ata KNER-in e kthyen nga një organizatë ndihme ekonomike reciproke që ishte në kohën e Stalinit, në një mjet kontrolli e shfrytëzimi të vendeve që bëjnë pjesë në të.

Pra, tjetër ishte politika e Josif Stalinit për të gjitha problemet e mëdha politike, ideologjike dhe ekonomike dhe krejt tjetër është politika e revizionistëve modernë hrushovianë e të tjerë. Politika e Stalinit ishte parimore dhe internacionaliste, kurse ajo e revizionistëve sovjetikë është një politikë kapitaliste, skllavëruese për popujt e tjerë, që ranë ose që po bien në kurthin e tyre.

Stalini u akuzua nga imperialistët, nga Titoja, nga hrushovianët dhe nga të gjithë armiqtë e tjerë, se gjoja pas Luftës së Dytë Botërore ai -paska ndarë zonat e influencës, duke rënë në marrëveshje me ish-aleatët antifashistë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britaninë e Madhe. Këtë akuzë, ashtu si të tjerat, koha e ka hedhur në shportën e plehrave. Stalini me një drejtësi shembullore, pas Luftës së Dytë Botërore, mbrojti popujt, luftën e tyre nacionalçlirimtare dhe të drejtat kombëtare e shoqërore nga lakmitë e ish-aleatëve në luftën antifashiste.

Armiqtë e komunizmit, që nga reaksioni borgjez ndërkombëtar e deri te hrushovianët e gjithë revizionistët e tjerë, u përpoqën me çdo mjet që të gjitha virtytet e këtij marksist-leninisti të madh, të gjitha mendimet e kthjellta e veprimet e drejta të tij Vi errësonin, Vi shtremberonin dhe të diskreditonin shtetin e parë socialist që ngritën Lenini e Stalini.

Hrushovianët, këta trockistë, buharinistë, zinovievistë dhe tukaçevskë të rinj, me dinakëri, nxitën ndjenjën e fodullëkut e të epërsisë të njerëzve që kishin bërë luftën. Ata nxitën privilegjet për elitën, i hapën rrugën e gjerë burokratizmit e liberalizmit në parti e në shtet, shkelën normat e vërteta revolucionare dhe, dalngadalë, arritën të futnin në popull frymën disfatiste. Të gjitha të zezat e veprimtarisë së tyre ata i paraqitën sikur i kishte sjellë «qëndrimi i ashpër e sektar, rraetoda dhe stili i punës» së Stalinit. Kjo veprë djallëzore e atyre që hidhnin gurin e fshihnin dorën, shërbente për të gënjyer klasën punëtore, fshatarësinë kolkoziane, intelektualët dhe për të vënë në lëvizje gjithë elementët disidentë të fshehur gjer në atë kohë. Elementëve disidentë, karrieristë e të degjeneruar u thuhej se tani kishte ardhur për ta «liria e vërtetë» dhe këtë «liri» ua sollti Nikita Hrushovi dhe grupi i tij. Kjo ishte përgatitja e terrenit për shkatërrimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik, për shembjen e diktaturës së proletariatit dhe vendosjen e një shteti për «gjithë popullin», që, në fakt, nuk do të ishte tjetër, veçse një shtet diktatorial i tipit fashist, sic është tani.

Këto poshtërsi u dukën shpejt pas vdekjes, ose më saktë pas vrasjes së Stalinit. Them pas vrasjes së Stalinit, pse vetë Mikojaçi na ka thënë mua dhe shokut Mehmet Shehu se ata, bashkë me Hrushovin dhe shokët e tyre kishin pasë vendosur të bënin «pokushenie», me atentat ta vrisnin Stalinin, por më

pas, siç na tha Mikojani, hoqën dorë nga ky plan. Është fakt i njohur që hrushovianët mezi e kanë pritur vdekjen e Stalinit. Rrethanat e vdekjes së tij nuk janë të qarta.

Në këtë drejtim një enigmë e pazgjidhur është edhe çështja e «bluzave të bardha», procesi i zhvilluar kundër mjekëve të Kremlinit, të cilët, sa ishte gjallë Stalini, i akuzuan se kishin tentuar të kryenin vrasjen e shumë udhëheqësve të Bashkimit Sovjetik. Pas vdekjes së Stalinit këta rrjekë u rehabilituan dhe kjo çështje u mbyll me kaq! Po pse vallë u mbyll kjo çështje?! Ishte provuar veprimtaria kriminale e këtyre mjekëve në kohën kur u gjykuan, apo jo? Çështja e mjekëve u mbyll, se po të ishte hetuar më pas, po të ishte gërmuar thellë, do të nxirrte shumë të palara në shesh, shumë krime dhe shumë komplete që po kryenin revizionistët e maskuar me Hrushovin dhe Mikojanin në krye. Kështu, do të mund të shpjegoheshin edhe vdekjet e papritura brenda një kohe të shkurtër nga sëmundje të shërueshme të Gotvaldit, Bjerutit, Forsterit, Dimitrovit e të disa të tjerëve, për të cilët kam shkruar në kujtimet e mia të pabotuara «Hrushovianët dhe ne». Kështu mund të vërtetohej edhe arsyeja e vërtetë e vdekjes së papritur të Stalinit.

Hrushovi dhe grupi i tij, për t'ua arritur qëllimeve të ulëta dhe për të realizuar planet e luftës kundër marksizëm-leninizmit e kundër socializmit, likuiduan njërin pas tjetrit pa zhurmë e në mënyrë misterioze mjaft udhëheqës kryesorë të Kominternit. Kështu, përveç të tjerëve, ata sulmuan, diskredituan, shkarkuan nga detyra dhe internuan, në thellësi të stepave të Rusisë edhe Rakoshin.

Nikita Hrushovi dhe shokët e tij, në raportin «sekret» që mbajtën në Kongresin e tyre të 20-të, i hodhën baltë Josif Visarionoviç Stalinit dhe u përpoqën ta poshtërojnë atë në mënyrën, më të ndyrë, me metodat më cinike trockiste. Pasi komprometuan një pjesë të kuadrove të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, hrushovianët i shfrytëzuan ata mirë e mirë dhe pastaj u dhanë shqelmin, i likuiduan si elementë, antiparti. Hrushovianët me Hrushovin në krye, që dënuan kultin e Stalinit, për të mbuluar krimet e tyre të mëvonshme kundër Bashkimit Sovjetik dhe socializmit, e ngritën në qiell kultin e -Hrushovit.

Egërsinë, dinakërinë, pabesinë, poshtërsinë .e karakterit, burgosjet dhe vrasjet, që vetë ata funksionarë të lartë të partisë dhe të shtetit sovjetik praktikonin e i kishin në gjak, ia hodhën Stalinit. Sa që gjallë Stalini ishin pikërisht këta njerëz që i këndonin atij ditirambe të mëdha për të mbuluar karrierizmin e tyre, qëllimet e veprimet e tyre të mbrapshta. Hrushovi e quante Stalinin më 1949 «prijësi dhe mësuesi gjenial», thoshte se «emri i shokut Stalin është flamuri i të gjitha fitoreve të popullit sovjetik, flamuri i luftës së punonjësve të mbarë botës». Mikojani i vlerësonte veprat e Stalinit si një «shkallë e re historike më e lartë e leninizmit». Kosigini thoshte se «gjithë fitoret e sukseset tona ia detyrojmë të madhit Stalin» e të tjera, e të tjera. Kurse pas vdekjes së tij ata u sollën ndryshe. Ishin hrushovianët ata që e mbytën zërin e partisë, mbytën zërin e klasës punëtore dhe mbushën kampet e përqendri mit me patriotë; ishin ata që liruan nga burgjet llumin e tradhtisë, trockistët dhe të gjithë armiqtë që koha dhe faktet kishin vërtetuar, dhe vërtetuan përsëri edhe tani me luftën e tyre si disidentë, se janë kundërshtarë të socializmit dhe agjentë në shërbim të armiqve të huaj kapitalistë.

Hrushovianët janë ata që, në mënyrë konspirative dhe misterioze, «gjykuan» dhe dënuan jo vetëm revolucionarët sovjetikë, por edhe shumë persona nga vende të tjera. Në shënimet e mia kam shkruar për një mbledhje me udhëheqësit sovjetikë, ku asistonin Hrushovi, Mikojani, Molotovi dhe disa të tjerë. Meqenëse Mikojani do të shkonte në Austri, Molotovi, si me shaka, iu drejtua atij dhe i tha: «Ki kujdes të mos bësh ndonjë «çorbë» në Austri ashtu siç bëre edhe në Hungari». Unë, përnjëherë, e pyeta Molotovin: «Pse, Mikojani e bëri «çorbën» në Hungari?». Ai m'u përgjigj : «Po», dhe vazhdoi të thoshte se «po të shkojë Mikojani prapë atje, do ta varin». Mikojani, ky kozmopolit antimarksist i fshehur, u përgjigj «Po të më varin mua, do të varin edhe Kadarin». Por edhe sikur të vareshin ata të dy, intrigat dhe poshtërsitë kundër një vendi tjetër prapë mbeten amorale.

Hrushovi, Mikojani dhe Suslovi e mbrojtën në fillim komplotistin Imre Nagi dhe pasta e dënuan dhe e ekzekutuan fshehurazi diku në Rumani! Me ç'të drejtë vepruan ata kështu me një shtetas të huaj ? Ai, edhe pse ishte komplotist, duhej t'i shtrohej vetëm gjykimit të shtetit të vet dhe asnjë ligji, asnjë gjy'kate apo ndëshkimi të huaj. Stalini nuk bënte kurrë të tilla veprime.

Jo, Stalini nuk vepronte kurrë kështu. Gjyqet kundër tradhtarëve të partisë e të shtetit sovjetik ai i bëri të hapura. Partisë, popullit sovjetik iu treguan hapur krimet që ata kishin bërë. S'gjen kurrë te veprimet e Stalinit metoda të tilla mafioze, siç gjen te krerët revizionistë sovjetikë.

Të tilla metoda kanë përdorur dhe i përdorin revizionistët sovjetikë edhe kundër njëri-tjetrit në luftën që bëjnë për pushtet, ashtu siç veprohet në çdo vend kapitalist. Me puç e rrëmbeu pushtetin Hrushovi, po me puç e rrëzoi atë nga fronti Brezhnjevi.

Brezhnjevi me shokë e hoqi qafe Hrushovin për të mbrojtur politikën dhe ideologjinë revizioniste nga diskreditimi dhe demaskimi që vinin nga sjelljet dhe veprimet e çmendura, nga marrëzitë pa anë e pa vend të tij. Ai nuk i hodhi poshtë aspak hrushovizmin, raportet dhe vendimet e Kongresit të 20-të dhe të 22-të, ku është mishëruar hrushovizmi. Por aq shumë mosmirënjohës u tregua Brezhnjevi kundërshtuesit Hrushovit, të cilin më përpara e kishte ngritur aq shumë lart, sa që edhe një vrimë muri në Kremlin nuk i gjeti për të vënë hirin e kufomës së tij, kur vdiq! Ndërkaq, kurrë nuk u informuan popujt sovjetikë, as opinioni botëror për shkaqet e vërteta të rrëzimit të Hrushovit. Edhe sol, e kësaj dite në dokumentet zyrtare revizioniste, si «shkak kryesor» jepet gjithnjë «mosha e kaluar dhe keqësimi i gjendjes shën detësore»!!

Stalini nuk ishte aspak ashtu siç e akuzuan dhe e akuzojnë armiqtë e komunizmit. Përkundrazi ai ishte parimor dhe i drejtë. Ai, sipas rastit, dinte të ndihmonte dhe të luftonte ata që gabonin, dinte të përkrahte, të inkurajonte dhe të vinte në dukje meritat e veganta të atyre që i shërbenin me besnikëri marksizëm-leninizmit. 2shtë e njohur çështja e Rokosovskit dhe ajo e Zhukovit. Kur Rokosovski e Zhukovi gabuan, ata u kritikuan dhe u shkarkuan nga detyrat. Por këta nuk u hodhën poshtë si të pandreqshëm, përkundrazi u ndihmuan me ngritje dhe në momentet kur u gjykua se këta quadro qenë ndrequr, Stalini i ngriti ata në përgjegjësi, u dha gradën e mareshalit dhe, në kohën e Luftës së Madhe Patriotike, i ngarkoi me detyra jashtëzakonisht të rëndësishme në frontet kryesore të luftës kundër pushtuesve hitlerianë. Kështu si veproi Stalini nuk mund të vepronte veqse një udhëheqës, që e kishte të qartë dhe që zbatonte konceptin e drejtësisë marksiste-leniniste për vlerësimin e punës së njerëzve, me të mirat e me gabimet që kishin.

Pas vdekjes së Stalinit. mareshali Zhukov u bë vegël e Nikita Hrushovit dhe e grupit të tij: ai e mbështeti veprimtarinë tradhtarë të Hrushovit ndaj Bashkimit Sovjetik. Partisë Bolshevike dhe Stalinit. Më në fund, Nikita Hrushovi, e hodhi Zhukovin tej si një limon të shtrydhur. Të njëjtin veprim bëri ai edhe ndaj Rokosovskit dhe shumë kadrove të tjerë kryesorë.

Mjaft komunistë sovjetikë u gënjyen nga demagogjia e grupit revizionist hrushovian dhe kujtuan se, pas vdekjes së Stalinit, Bashkimi Sovjetik do të bëhej me të vërtetë një parajsë, siç filluan të trumbetonin tradhtarët revizionistë. Ata deklaruan me pompozitet se më 1980 do të vendosej në Bashkimin Sovjetik komunizmi!! Por ç'ngjau? Ngjau e kundërta dhe nuk mund të ndodhte ndryshe. Revizionistët e morën fuqinë në dorë jo për të lulëzuar Bashkimin Sovjetik, por për ta kthyer prapa në një vend kapitalist, siç e kthyen, për ta nënshtruar atë ekonomikisht ndaj kapitalit botëror, për të lidhur marrëveshje të fshehta dhe të hapëta me imperializmin amerikan, për të nënshtruar popujt e vendeve të demokracisë popullore nën maskën e traktateve ushtarake dhe ekonomike, për t'i mbajtur këto shtete nën zgjedhë dhe për të krijuar tregje e zona influence në botë. Këta ishin hrushovianët, që shfrytëzuan ndërtimin me sukses të socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe këto suksese i kthyen në rrugë aq të mbrapshtë, sa krijuan një klasë të re të borgjezisë socialimperialiste për ta bërë Bashkimin Sovjetik një fuqi imperialiste botërore që, tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të sundojnë botën. Stalini e kishte paralajmëruar partinë për këtë rrezik.

Vetë Hrushovi na ka pohuar neve se Stalini u kishte thënë atyre që ju do ta shisni Bashkimin Sovjetik tek imperializmi. Dhe, në fakt, ashtu ndodhi, ajo që tha ai, u vërtetua.

Popujt e botës, proletariati botëror, njerëzit me logjikë dhe me zemër të pastër, në situatat e krijuara, mund të gjykojnë vetë drejtësinë e qëndrimeve të Stalinit. Vetëm në panoramë të gjerë politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake njerëzit mund të gjykojnë për drejtësinë e vijës së tij marksiste-leniniste.

Deri dje borgjezia dhe revizionistët me propagandën e tyre, duke falsifikuar historinë, u kanë errësuar mendjet njerëzve për veprimtarinë e Stalinit, por tash që këta e kanë të qartë ç'janë

hrushovianët, titistët, maoistët, «eurokomunistët» etj. dhe ç'kanë qenë hitlerianët, ç'janë imperialistët amerikanë e kapitalizmi botëror, e dinë përse luftonte Stalini, përse luftonin bolshevikët, përse luftojnë proletarët dhe marksistë-leninistët e vërtetë dhe përse luftojnë armiqtë e tyre, rrymat dhe korentet në shërbim të kapitalizmit, përse luftojnë revizionistët. Ata që mendojnë se komunizmi «ka dështuar», gjithmonë janë zhgënjyer e me siguri gjithmonë do të zhgënjehen. Koha vërteton çdo ditë se doktrina jonë jeton dhe është e gjithëfuqishme.

Duke çmuar në tërësi veprën e Stalinit, secili mund të kuptojë gjénialitetin dhe shpirtin komunist të këtij personaliteti të shquar që rrallë ka njohur bota moderne.

Kauza e madhe e Marksit, e Engelsit, e Leninit dhe e Stalinit, çështja e socializmit dhe e komunizmit janë e ardhmja e botës.

Ne, komunistët shqiptarë, kemi zbatuar me sukses mësimet e Stalinit, në radhë të parë, për të pasur një Parti të fortë, të çeliktë, kurdoherë besnike të marksizëm-leninizmit, të ashpër kundër armiqtë të klasës, jemi treguar të vëmendshëm për ruajtjen e unitetit të mendimit e të veprimit në Parti dhe për forcimin e unitetit të Partisë me popullin. Ne kemi ndjekur mësimet e Stalinit për ndërtimin e industrisë socialiste, për kolektivizimin e bujqësisë dhe kemi korrur suksese të mëdha. Partia dhe populli ynë do të luftojnë për forcimin e vazhdueshëm të aleancës së ngushtë në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë nën udhëheqjen e klasës punëtore. Ne nuk do të gënjëmi kurrë nga lajkat dhe nga dredhitë e armiqtë, qofshin këta të jashtëm ose të brendshëm, por do ta vazhdojmë luftën e klasave si brenda, edhe jashtë dhe do të jemi kurdoherë vigjilentë ndaj veprimtarisë keqbërëse të tyre. Ndryshe, në rast se nuk do të tregoheshim vigjilentë, në rast se nuk do të zbatonim me besnikëri mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, Shqipëria do të kishte rënë në llumin e revizionizmit modern, ajo nuk do të ishte më e pavarur e socialiste, këtu nuk do të ekzistonte më diktatura e proletariatit, por skllavëria e fuqive imperialisto-revizioniste.

Partia dhe populli ynë do të vazhdojnë rrugën e Karl Marksit, të Frederik Engelsit, të Vladimir Ulianov Leninit e të Josif Stalinit. Brezat e ardhshëm të Shqipërisë socialiste do ta ndjekin me besnikëri vijën e Partisë së tyre të shtrenjtë.

Shqiptarët, komunistë e patriotë pa parti, përulen me respekt përpara kujtimit të mësuesit të lavdishëm, Josif Stalinit. Me rastin e njëqindvjetorit të lindjes së tij ne kujtojmë me devocion atë që na ndihmoi, që na dha mundësi për të shumëfishuar forcat e popullit tonë, të cilin Partia e bëri zot të plotfuqishëm të fateve të veta. Vepra e çlirimit dhe e ndërtimit të socializmit në vendin tonë i detyrohet edhe përkrahjes internacionaliste të Stalinit. Eksperiencia e tij e pasur dhe me shumë vlerë, ne na ka udhëhequr në rrugën e në veprimtarinë tonë.

Partia jonë po zhvillon në këtë vit jubilar një punë të gjerë, të vazhdueshme për ta bërë akoma më të njohur jetën dhe veprën e lavdishme të marksist-leninistit të madh, Josif Stalinit. Gjithë veprimtaria e Partisë sonë, që nga themelimi i saj e gjer në ditët e sotme, tregon për dashurinë, respektin dhe besnikërinë e saj ndaj doktrinës së pavdekshme të klasikëve tanë të mëdhenj, pra edhe ndaj ideve të Josif Stalinit. Kështu do të jetë te ne brez pas brezi.

Unë si militant i Partisë, si një nga udhëheqësit e saj, që Partia më ka nderuar disa herë duke më dërguar të takohem meshokun Stalin për të biseduar me të lidhur me hallat tona, për gjendjen e për situatën tonë dhe për t'i kërkuar këshilla dhe ndihmën e tij, jam përpjekur që kujtimet e këtyre takimeve t'i shkruaj në kohën e duhur, ashtu siç e kam ndier dhe siç e kam parë sjelljen e Stalinit me përfaqësuesin e një partie dhe të një populli të vogël si yni. Duke dhënë për botim këto kujtime të thjeshta, u nisa nga dëshira të ndihmoj sadopak komunistët, punonjësit, rininë tonë, që të njihen me figurën e këtij njeriu të madh e të pavdekshëm.

Në këtë përvjetor të lavdishëm unë përulen me devocion, me besnikëri përpara Partisë dhe popullit që më lindën, më rritën e më kalitën dhe përpara Josif Stalinit që më ka dhënë këshilla aq të vlefshme për lumturinë e popullit tim, që më ka lënë kujtime aq të pashlyeshme në zemrën dhe në mendjen time.

Ky njëqindvjetor për ne, marksistë-leninistët dhe për simpatizuesit e panumërt në botë ndaj idealeve të larta të klasës punëtore, duhet të shërbejë për të forcuar unitetin luftarak të radhëve tona.

Tani në 'përkujtimin e këtij jubileu të madh të lindjes së Stalinit është koha e reflektimeve të thella të njerëzve të ndershëm kudo në botë për të gjetur rrugën e drejtë, për të shpërndarë nga mendja mjegullën e krijuar nga borgjezia kapitaliste, nga borgjezia revizioniste me qëllim që të mpijnë hovin revolucionar, mendimet revolucionare të masave. Mendimi dhe aksioni revolucionar do t'i çojnë njerëzit me vullnet të mirë, njerëzit e drejtë, njerëzit e popullit në rrugën e shpëtimit të tyre nga zgjedha e kapitalit.

Dulke përkujtuar Stalinin dhe veprën e tij në njëqindvjetorin e lindjes, ne, marksistë-leninistët, nu mund të mos u drejtohem drejtpërsëdrejti popujve të Bashkimit Sovjetik për t'u thënë në mënyrën inë të hapur e më të sqartë:

Ju, që me emrin e Stalinit në gojë sulmuat dhe fituat mbi armiqtë më të rrezikshëm të njerëzimit, ç'do të bëni, do të heshtni me rastin e këtij jubileu të madh?

Wevizionistët hrushovianë, që nuk lanë gjë pa thënë kundër Stalinit, meqenëse nuk kanë si e fshehin emrin dhe veprën e shkëlqyer të tij, mund të shkruajnë ndonjë fjalë të zbehtë për të. Por ju përket juve, që bëtë Revolucionin e Madh të Tetorit, ta kujtoni me respekt të thellë udhëheqësin tuaj të ndritur. Ju duhet ta shkatërroni regjimin diktatorial fashist, që fshihet me slogane mashtruese. Ju duhet të dini se ata që ju drejtojnë janë fashistë, shovinistë dhe imperialistë. Ata ju përgatisin si mish për top për një luftë të ashpër imperialiste, për të vlarë popujt dhe për të djegur e shkatërruar vende, që shpresonin shumë tek atdheu i Leninit dhe i Stalinit. Popujt e botës nuk duan që ju të jeni të tillë. Po të vazhdoni të qëndroni kUShtu, ata nuk mund t'ju respektojnë më, ata do t'ju urrejnë.

Popujt e botës i urrejnë sundimtarët tuaj aktualë kundërrevolucionarë, pse armët atomike që ata po prodhojnë, paradat në Sheshin e Kuq dhe manovrat ushtarake që organizojnë, janë bërë kërcënuese për popujt dhe lirinë e tyre, sig janë dhe ato të imperializmit amerikan dhe të kapitalizmit botëror. Armatimet dhe ushtria në Bashkimin Sovjetik s'janë më në duart e popujve sovjetikë dhe nuk shërbejnë për çlirimin e proletarietit botëror, por përkundrazi, ato janë destinuar për të shtypur popujt sovjetikë dhe popujt e tjerë.

Ju duhet të kuptoni dhe të realizoni se ka kohë që armiqtë ju kanë larguar nga rruga e revolucionit. Revizionistët hrushovianë luftojnë të ngjallin te ju ndjenjën e prepotencës dhe të zotërimit mbi të tjerët. Forcën tuaj të madhe, ata pretendojnë se gjoja e përdorin për të luftuar imperializmin amerikan dhe kapitalizmin botëror, por ky pretendim është i rremë. Sundimtarët tuaj janë në kontradikta dhe në aleancë me imperializmin amerikan dhe me kapitalizmin botëror jo për interesat e revolucionit, por për shkak të ambicieve dhe lakmive imperialiste për ndarjen e sferave të influencës dhe për sundimin e popujve.

Popujt e botës janë të shqetësuar nëse ju, djemtë, nipërit dhe stërnipërit e atyre luftëtarëve të lavdishëm që bënë Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit, ju, proletarët, kolkozianët, ushtarët dhe intelektualët sovjetikë do të vazhdoni në këtë rrugë armiqësore për popujt, ku ju kanë futur ata që ju shtypin, apo, me emrin e Leninit e të Stalinit në gojë, do të ngriheni dhe do të sulmoni në rrugën e revolucionit? Bota dëshiron dhe uron që ju të ecni në rrugën e revolucionit dhe të marshoni përpara duke thirrur si të parët tuaj : «za Lenina!», «za Stalina!», për socializmin e vërtetë dhe kundër imperializmit, socialimperializmit dhe revizionizmit.

Udhëheqja tradhtarë ju nuk ju informon drejt për vuajtjet e popujve të tjerë që po vriten nëpër rrugë në demonstratat kundër imperialistëve e kapitalistëve gjakpirës. Juve nuk jua thotë të vërtetën se përse në Iran populli i etur për liri dhe pavarësi ngrihet në këmbë dhe rrëzon shahun tiran, veglën e imperialistëve amerikanë. Klika revizioniste hrushoviane ju ju mban në errësirë për vuajtjet e popujve arabë, të popujve të kontinentit amerikan dhe të të gjitha kontinenteve të botës, sepse këto vuajtje atyre ua shkaktojnë imperializmi dhe udhëheqësit tuaj tradhtarë. Juve nuk ju thonë asgjë se si shtypen popujt e Afrikës nga njerëzit tuaj dhe vasalët e tyre, ju nuk i njihni intrigat që zhvillojnë në botë carët e rinj të Kremlinit, juve nuk ju thonë se miqtë e hrushovianëve, miqtë e udhëheqjes suaj, të cilëve Nikita Hrushovi dhe pasuesit e tij me Brezhnjevën në krye u hapën rrugën e tradhtisë, po bëjnë kauzë të përbashkët me kapitalistët në dëm të klasës punëtore e të interesave të popujve të tyre. Ju nuk dini shumë gjëra as për vuajtjet dhe marrjen nëpër këmbë të njerëzve të ndershëm në vendin tuaj, sepse për këto hesht banda e sotme që ju shtyp.

Ju duhet të dini se popujt janë ngritur në revolucion, se ata po luftojnë me heroizëm, kurse ju, që përbëni një fuqi të madhe, ju shtypin, ju nanurisin dhe ju kanë vënë në gjumë.

Një bandë sundimtarësh e ka kthyer vendin tuaj në një fuqi socialimperialiste. Rruga e shpëtimit është ajo e revolucionit që na kanë mësuar Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Brezhnevët, Kosiginët, Ustinovët dhe Jakubovskët, ashtu si edhe Solzhenicinët e Saharovët janë kundërrevolucionarë dhe si të tillë ata duhen përmbysur e likuiduar.

Ju jeni një fuqi e madhe, por duhet të rifitoni besimin e proletariatit botëror, besimin e popujve të botës, atë besim të madh që krijuan me punë e me luftë Lenini dhe Stalini. Ju nuk duhet të vonoheni për të reflektuar thellë për të ardhmen tuaj dhe për atë të njerëzimit. Ka ardhur koha të bëheni ashtu sig keni qenë kur jetonin Lenini e Stalini - pjesëtarë të lavdishëm të revolucionit proletar, prandaj nuk duhet të qëndroni nën zgjedhën e armiqve të revolucionit dhe të popujve, të armiqve të lirisë e të pavarësisë së shteteve. Ju kurrë nuk duhet të bëheni veglat e një imperializmi, që kërkon të robërojë popujt, duke përdorur si maskë leninizmin.

Po të ndiqni rrugën e revolucionit e të marksizëm-leninizmit, po të lidheni ngushtë me proletariatin botëror, atëherë imperializmi amerikan dhe përgjithësisht kapitalizmi në kalbëzim do të tronditen nga themelet, bota do të ndryshojë faqen, socializmi do të fitojë.

Ju, popuj sovjetikë, punëtorë, kolkozianë, ushtarë sovjetikë keni përgjegjësi dhe detyra të mëdha përpara njerëzimit. Këto detyra mund t'i kryeni me nder duke mos e duruar thundrën e klikës barbare, që sundon aktualisht mbi ish-Partinë e lavdishme Bolshevike të Lenin-Stalinit dhe mbi ju.

Partia e ju nuk është më një parti marksiste-leniniste. Ju duhet të ndërtoni me luftë një parti të re të tipit Lenin-Stalin. Ju duhet të kuptoni se Bashkimi Sovjetik nuk është më një unitet i popujve për liri, në harmoni të plotë me njëri-tjetrin. Bolshevizmi ishte ai që mundi të krijonte bashkimin vëllazëror të popujve të Bashkimit Sovjetik. Revizionizmi ka bërë të kundërtën, ai i ka përçarë popujt e vendit tuaj, ka ngjallur shovinizmin në çdo republikë, ka nxitur armiqësinë në mes tyre, ka futur urrejtjen të popujt e tjerë kundër popullit rus, i cili priu në revolucion nën udhëheqjen e Leninit e të Stalinit.

Do të lejoni akoma ju që të merreni nëpër këmbë? Do të lejoni akoma që në vendin tuaj të thellohet procesi i borgjezimit në të gjitha fushat e jetës, siç po bëjnë revizionistët? Do të pranoni ju zgjedhën e një kapitali të ri, të maskuar nën petkun e një socializmi fals?

Ne, komunistët dhe populli shqiptar, si të gjithë komunistët dhe popujt liridashës të botës, e tremi dashur Bashkimin e vërtetë socialist Sovjetik të kohës së Lenin-Stalinit. Ne ndjekim me vendosmëri rrugën e Leninit e të Stalinit dhe tremi besim të forcat e mëdha revolucionare të popujve sovjetikë, të proletariatit sovjetik, prandaj kemi bindjen se kjo forcë do të manifestohet gradualisht, me luftë, me sakrificë, do të ngrihet në lartësinë e kërkesave të kohës dhe do ta shkatërrojë nga themelet socialimperializmin sovjetik.

Revolucioni dhe sakrificat që ju do të bëni, nuk do ta dobësojnë vendin tuaj, por do të ringjallin Bashkimin Sovjetik socialist të vërtetë. Ata do të rrëzojnë diktaturën socialimperialiste dhe, prej këtej, Bashkimi Sovjetik do të dalë më i fortë se kurrë. Në këtë vepër të lavdishme, ju do të keni mbështetjen e gjithë popujve të botës, të proletariatit botëror. Te kjo përmbysje revolucionare qëndron forca e ideve të socializmit e të komunizmit dhe jo në fjalët boshe e në veprimet e mbrapshta të klikës që ju sundon. Vetëm kështu, duke ecur nëpër këtë rrugë, komunistët e vërtetë, marksistë-leninistët kudo në botë do të jenë në gjendje të mposhtin imperializmin dhe kapitalizmin botëror. Ata do t'i ndihmojnë popujt e botës që të çlirohen njëri pas tjetrit, do të ndihmojnë Kinën e madhe të vijë në rrugën e vërtetë të socializmit dhe të mos bëhet një superfuqi për të sunduar edhe ajo botën, duke u shndërruar në një partnere e tretë në luftërat grabitqare që përgatisin imperializmi amerikan, socialimperializmi sovjetik dhe klika e Hua Kuo Fenit dhe e Ten Hsiao Pinit, që sundon aktualisht në Kinë.

Ne, komunistët shqiptarë, si nxënës besnikë të Leninit e të Stalinit e si ushtarë të revolucionit, në këtë jubile të lavdishëm, ju kujtojmë të mendoheni për këto probleme jetike tuajat dhe të botës, se jemi vëllezërit tuaj, shokët tuaj për çështjen e revolucionit proletar dhe të çlirimit të popujve. Në rast se ju ndiqni rrugën e luftës grabitqare, imperialiste, ku ju çojnë udhëheqësit tuaj renegatë, ne, pa

dyshim, do të mbetemi armiq të sistemit tuaj dhe të veprimeve tuaja kundërrevolucionare. Kjo është e qartë si drita e diellit. Ndryshe nuk mund të jetë.

Ne, komunistët shqiptarë, të lidhur me popullin tonë si mishi me kockën, kur jemi të bindur se veprojmë drejt, nuk ndalemi përpara çdo furtune, sado e egër qoftë ajo. Dhe jemi të bindur se furtunat do t'i kapërcejmë, ashtu siç i kapërcenin Partia e bolshevikëve dhe pushteti i sovjetëve, ashtu siç i kapërcenin Kapedanët e mëdhenj të revolucionit, Lenini dhe Stalini.

KUJTIME

Nga takimet me Stalinin

TAKIMI I PARIE

Korrik 1947

Situata e jashtme e RPSH. Marrëdhëniet me shtetet fqinje dhe anglo-amerikanët. Incidenti i kanalit të Korfuzit - Gjyqi i Hagës. Gjendja politike, ekonomike e socialklasore në Shqipëri. Interesim i gjithanshëm dhe vlerësim i lartë për vendin, popullin e Partinë tonë nga Stalinin. «Nuk ka kuptim që një parti të jetë në pushtet dhe të qëndrojë ilegale». «Partia juaj Komuniste mund të quhet Parti e Punës».

Më 14 korrik 1947 arrita në Moskë në krye të delegacionit të parë zyr tar të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Partisë Komuniste të Shqipërisë për një vizitë miqësore në Bashkimin Sovjetik.

Gëzimi im dhe i shokëve që u caktuam nga Komiteti Qendror i Partisë për të shkuar në Moskë, ku do të takoheshim me Stalinin e madh, ishte i papërshkrueshëm. Takimin me Stalinin e ki shim ëndërruar vazhdimisht, ditë dhe natë, që në kohën kur ne u njohëm me teorinë marksiste-leniniste. Kjo dëshirë na ishte shtuar më tepër gjatë periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pas figurave të shquara të Marksit, Engelsit e Leninit, shoku Stalin ishte për ne jashtëzakonisht i shtrenjtë e i respektuar sepse mësimet e tij na udhëhoqën për themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë si një Parti e tipit leninist, na frymëzuan gjatë Luftës Nacionalçlirimtare e po na shërbenin për ndërtimin e socializmit.

Bisedat me Stalinin dhe këshillat e tij do të ishin udhërrëfyese në punën tonë të madhe dhe të vështirë që po bënim për konsolidimin e fitoreve të arritura.

Për këto arsye vizita jonë e parë në Bashkimin Sovjetik ishte një gëzim i papërshkrueshëm dhe një kënaqësi e madhe jo vetëm për komunistët dhe për ne, anëtarët e delegacionit, por për tërë popullin shqiptar, i cili e priste me padurim këtë vizitë dhe e brohoriti me entuziazëm të madh.

Stalini dhe Qeveria Sovjetike, siç e pamë me sytë tanë dhe e ndjemë në zemrat tona, e pritën delegacionin tonë në mënyrë shumë të përzemërt e të ngrohtë, me një dashuri të sinqertë. Gjatë 12 ditëve që qëndruam në Moskë, ne u takuam disa herë me shokun Stalin dhe bisedat që zhvilluam me të, këshillat dhe porositë e tij të sinqerta e shoqërore, na kanë mbetur e do të na mbeten përjetë të shtrenjta.

E paharruar do të më mbetet dita e parë e takimit me Josif Visarionoviç Stalinin. Kjo ndodhi më 16 korrik 1947, ditën e tretë të qëndrimit tonë në Moskë. Ajo nisi si një ditë e jashtëzakonshme: Qysh në mëngjes shkuam në Mauzoleun e Leninit të madh, ulëm kokën me nderim të thellë para trupit të udhëheqësit gjenial të revolucionit, para atij njeriu, emri dhe vepra kolosale e të cilit ishin gdhendur thellë në mendjet dhe në zemrat tona, na kishin ndriçuar e na ndriçonin rrugën e lavdishme të luftës për liri, të revolucionit e të socializmit. Me këtë rast në emër të popullit shqiptar, të Partisë sonë Komuniste dhe në emrin tim, vendosa para Mauzoleut të të pavdekshmit Lenin një kurorë me lule shumëngjyrëshe. Prej këndej, pasi vizituam varret e luftëtarëve trima të Revolucionit Socialist të Tetorit, të militantëve të shquar të Partisë Bolshevike dhe të shtetit sovjetik, të vendosura në muret e Kremlinit, shkuam në Muzeun Qendror të Vladimir Iliç Leninit. Mbi dy orë e ca ne kaluam nga njëra sallë në tjetrën, duke u njohur nga afër me dokumente e ekspozate që pasqyronin me hollësi jetën dhe Veprën e shquar të Leninit të madh. Para se të dilnim, në Librin e Vizitorëve të Muzeut, ndër të tjera shkrova edhe këto fjalë: «Kauza e Leninit do të rrojë e pavdekshme në brezat e ardhshëm. Kujtimi i tij do të jetë tOjë gjithnjë në zemrat e popullit shqiptar». Tamam këtë ditë, të mbushur plot përshtypje e exnacione të pashlyeshme, na priti e bisedoi gjatë me ne nxënësi dhe vazhduesi besnik i veprës së Leninit, Josif Visarionoviç Stalini.

Ai që në fillim na krijoi një atmosferë të ti llë shoqërore sa shumë shpejt u çliruam nga ai emocion i natyrshëm që ndjemë kur u futëm në zyrën e tij, një sallë e madhe, me një tryezë të gjatë për mbledhje, pranë tryezës së tij të punës, Pak minuta pas shkëmbimit të fjalëve të para ne e ndjemë veten jo sikur ishim duke biseduar me Stalinin e madh, por sikur po rrinim me një shok, që e kishim njohur më parë, me të cilin kishim biseduar shumë herë. Unë isha akoma i ri atëherë dhe përfaqësues i një partie dhe i një vendi të vogël, prandaj, që të më krijonte një atmosferë sa më të ngrohtë e shoqërore, Stalini bënte shaka dhe filloi të fliste me dashuri dhe me respekt të madh për popullin tonë, për traditat e tij luftarake në të kaluarën dhe për heroizmin e tij në Luftën Nacionalçlirimtare. Fliste qetë, shtruar e me një ngrohtësi karakteristike që të bënte për vete.

Ndër të tjera shoku Stalin na tha se ndiente simpati të thellë për popullin tonë si një popull shumë i vjetër i zonës së Ballkanit dhe me një histori të gjatë trimërie.

- Jam njohur veçanërisht me heroizmin e treguar nga populli shqiptar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare - vazhdoi ai - por, kuptohet, këto njohuri të miat s'mund të jenë në gjerësinë dhe thellësinë e duhur, prandaj do të dëshiroja të na flisnit pak për vendin, për popullin tuaj si dhe për problemet që ju preokupojnë sot.

Pas kësaj fjalën e mora unë dhe i bëra shokut Stalin një përshkrim për rrugën e gjatë e të lavdishme historike të popullit tonë, për luftërat e tij të pareshtura për ligë e pavarësi. Në mënyrë të veçantë u ndala në periudhën e viteve të Luftës sonë Nacionalçlirimtare, fola për themelimin e Partisë sonë Komuniste, si një parti e tipit leninist, për rolin vendimtar që luajti e luan ajo si forca e vetme udhëheqëse në luftën e në përpjekjet e popullit shqiptar për të fituar lirinë e pavarësinë e atdheut, për të përmbysur pushtetin e vjetër feudo-borgjez, për të ngritur pushtetin e ri popullor e për ta çuar vendin me sukses drejt shndërrimeve të thella socialiste. Me këtë rast unë edhe në herë e falënderova shokun Stalin dhe i shpreha atij mirënjohjen e thellë të komunistëve e të mbarë popullit shqiptar për përkrahjen e zjarrtë që Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, Qeveria Sovjetike dhe ai vetë u kishin dhënë e u jepnin popullit e Partisë sonë si gjatë viteve të luftës ashtu edhe pas Çlirimit të atdheut.

Në vazhdim i përshkrova shokut Stalin ndryshimet e thella politike, ekonomike e sociale që ishin realizuar e po konsolidoheshin hap pas hapi në Shqipëri në vitet e para të pushtetit popullor. Gjendja e brendshme politike dhe ekonomike e Shqipërisë, i thashë ndër të tjera, ka përmirësime të dukshme. Këto përmirësime e kanë bazën te kuptimi i drejtë i nevojës për kapërcimin e vështirësive dhe te përpjekjet e mëdha nga ana e popullit dhe e Partisë për t'i kapërcyer këto vështirësi me punë, me djersë. Populli ynë është i bindur në rrugën e tij dhe ka besim të patundur te Partia Komuniste, te Qeveria e Republikës sonë Popullore, te forcat e tij ndërtimore, te miqtë e tij të sinqertë dhe ditaditës me mobilizim, vetëmohim e entuziazëm të lartë po realizon detyrat që i vihen përpara.

Shoku Stalin shprehu gëzimin e tij për sukseset e popullit e të Partisë sonë në punën ndërtimore dhe u interesua të dinte diçka më tepër për gjendjen e klasave në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë u interesua për klasën punëtore dhe për fshatarësinë tonë. Për këto dy klasa të shoqërisë sonë ai bëri një tok pyetjesh, rreth të cilave ne shkëmbyem shumë mendime që do të na shërbenin më vonë për ndërtimin e një pune të shëndoshë në gjirin e klasës punëtore dhe të fshatarësisë së varfër e të mesme, do të na shërbenin edhe në përcaktimin e qëndrimeve që duheshin mbajtur ndaj elementit të pasur të qytetit e kulakut të fshatit.

- Shumica dërrmuese e popullit tonë - i thashë ndër të tjera shokut Stalin, në përgjigje të pyetjeve të tij - përbëhet nga fshatarë të varfër, pastaj nga fshatarë të mesëm. Klasën punëtore e kemi të vogël në numër, kemi mandej një numër jo të vogël zanatçinjsh, qytetarë që merr en me tregti të vogël dhe një pakicë intelektualësh. Gjithë këto masa punonjësish iu përgjigjën thirrjes së Partisë sonë Komuniste, u mobilizuan në luftën për Çlirimin e atdheut dhe tanfi janë të lidhura ngushtë me Partinë e pushtetin popullor.

- A ka tradita në luftën klasore klasa punëtore e Shqipërisë? - më pyeti shoku Stalin.

- Para Çlirimit të vendit, kjo klasë, i thashë, ishte shumë e vogël, e sapokrijuar dhe përbëhej nga një numër punëtorësh me mëditje, çirakësh ose zanatçinjsh të shpërndarë në ndërmarrje e në punishte të vogla. Në disa qytete të vendit në të kaluarën, punëtorët janë ngritur në greva, por edhe ato kanë qenë të vogla e të palidhura me njëra-tjetrën, si për arsye të numrit të paktë të punëtorëve, ashtu edhe të mungesës së organizimit në sindikata. Pavarësisht nga kjo, i thashë shokut Stalin, Partia jonë Komuniste u themelua si parti e klasës punëtore që do të udhëhiqej nga ideologjia marksiste-leniniste dhe do të shprehte e do të mbronte interesat e proletariatit e të masave të gjera punonjëse, në radhë të parë, të fshatarësisë shqiptare, e cila përbënte edhe shumicën e popullsisë sonë.

Shoku Stalin na pyeti me hollësi për gjendjen e fshatarëve të mesëm e të varfër në vendin tonë.

Në përgjigje të pyetjeve të tij i fola shokut Stalin për politikën që kishte ndjekur dhe për punën e madhe e të gjithanshme që kishte bërë Partia jonë që në themelimin e saj për t'u mbështetur te fshatarësia e për ta bërë atë për vete.

- Vepruam kështu, i thashë, jo vetëm të nisur nera parimi marksist-leninist se fshatarësia është aleati më i afërt e më i natyrshëm i proletariatit në revolucion, por edhe për faktin se në Shqipëri fshatarësia për'onte shumicën dërrmuese të popullsisë dhe në shekuj ishte karakterizuar nga tradita të mëdha patriotike e revolucionare. Në vazhdim të bisedës u përpoqa të karakterizoja si gjendjen ekonomike të këtyre fshatarëve pas Çlirimit të vendit, ashtu edhe nivelin kulturor e teknik të tyre. Krahas afirmimit të virtyteve të lqarta të fshatarësisë sonë si fshatarësi patriote, punëtore, e lidhur ngushtë me tokën e atdheut, e etur për liri, zhvillim e përparim, i fola edhe për mbeturinat e theksuara të sé kaluarës dhe prapambetjen ekonomike e kulturore të fshatarësisë sonë si dhe për mentalitetin mikroborgjez të kultivuar në ndërgjegjen e saj. Kundër kësaj gjendjeje, theksova, Partisë sonë i është dashur të luftojë me të gjitha forcat dhe suksese kemi arritur, por ne jemi të vetëdijshëm se duhet të luftojmë më shumë e me këmbëngulje më të madhe për ta bërë fshatarësinë të ndërgjegjshme që të përqafojë e të zbatojë në çdo hap vijën e Partisë.

Duke marrë fjalën shoku Stalin tha se fshatarët, në përgjithësi, në fillim kanë frikë nga komunizmi, se ata kujtojnë që komunistët do t'u marrin tokën e gjithë ç'kanë. Armiqtë, vazhdoi ai, u flasin fshatarëve shumë në këtë drejtim, me qëllim që t'i shkëputin nga aleanca me klasën punëtore, t'i largojnë nga politika e Partisë dhe nga rruga e socializmit. Prandaj, ka një rëndësi shumë të madhe puna e kujdesshme dhe largpamëse e Partisë Komuniste me qëllim që, sikundër thatë edhe ju, fshatarësia të lidhet në mënyrë të pazgjidhshme me Partinë dhe me klasën punëtore.

Me këtë rast unë e njoha shokun Stalin në vija të përgjithshme edhe me strukturën socialklasore të Partisë sonë dhe i shpjegoja se kjo strukturë përfaqëson besnikërisht vetë strukturën sociale të popullit tonë. Këtu qëndron edhe arsyeja, i thashë, se pse aktualisht në radhët e Partisë sonë numrin më të madh e përbëjnë komunistët me gjendje shoqërore fshatare. Politika e Partisë sonë në këtë drejtim është që hap pas hapi, krahas rritjes së klasës punëtore, të rritet respektivisht edhe numri i komunistëve punëtorë.

Duke vlerësuar politikën e drejtë që kishte ndjekur Partia jonë me masat në përgjithësi e me fshatarësinë në veçanti, shoku Stalin na dha një sërë këshillash të vlefshme e shoqërore për punën tonë në të ardhmen. Veç të tjerash ai shfaqti edhe mendimin që Partia jonë Komuniste, ineqë përqindja e komunistëve fshatarë në radhët e saj është më e madhe, të quhet «Partia e Punës e Shqipërisë». - Sidoqoftë, theksoi, ky është një mendim imi, sepse jeni ju, është Partia juaj, ajo që vendos.

Pasi e falënderova shokun Stalin për këtë mendim të vyer i thashë:

- Ne do ta shtrojmë propozimin tuaj në Kongresin e 1-rë të Partisë që jemi duke përgatitur dhe kam bindjen se si baza e Partisë ashtu edhe udhëheqja e saj do ta gjejnë me vend e do ta aprovojnë. Në vazhdim të fjalës sime i parashtrova gjithashtu shokut Stalin mendimin tonë për legalizimin e plotë të Partisë në Kongresin që po përgatitnim.

- Në realitet - i thashë ndër të tjera Partia jonë Komuniste ka qenë dhe është e vetmja forcë që luan rolin drejtues në gjithë jetën e vendit. por formalisht, ajo akoma ruan gjendjen gjysmilege. Neve s'na duket e drejtë të vazhdojmë më kjo gjendje*. *(Plenumi i 11-të i KQ të PKSH i mbajtur më 13-24 shtator 1948 dhe Kongresi i 1-rë i PKSH vendosën legalizimin e plotë e të menjëhershëm të PKSH. Mbajtja e gjeratëhershme e Partisë në gjendje gjysmailegale si në Plenum ashtu edhe në Kongres u quajt një gabim që kishte ardhur si pasojë e presioneve dhe e influencës së udhëheqjes trockiste jugosllave, e cila, për qëllime të caktuara, duke konsideruar Frontin si forcën kryesore drejtuese të vendit, kërkonte që Partia të shkrihej me Frontin, pra të nënvleftësohej e të mohohej vetë Partia Komuniste dhe ioli i saj udhëheqës si në Front ashtu edhe në gjithë jetën e vendit.)

- Shumë drejt, shumë drejt - u përgjigj shoku Stalin. - Nuk ka kuptim që një parti të jetë në pushtet dhe të qëndrojë ilegale, ose ta konsiderojë veten ilegale.

Duke kaluar në çështje të tjera, lidhur me Forcat tona të Armatosura, i shpjegova shokut Stalin se ushtria jonë, e dalë nga lufta, në shumicën dërrmuese të saj është e përbërë nga fshatarë të varfër, nga të rinj punëtorë dhe nga intelektualë të qytetit. Kuadrot e ushtrisë, oficerët që komandojnë, kanë dalë nga lufta dhe në luftë e sipër kanë fituar eksperiencën e drejtimit.

I fola, gjithashtu, për instruktorët sovjetikë të vjetër dhe i kërkova të na jepnin edhe disa të tjerë. Ne, i thashë, duke mos pasur një eksperiencë të mjaftueshme, bëjmë një punë politike të dobët në radhët e ushtrisë, prandaj iu luta ta shikonin këtë çështje që të na ndihmonin për ta ngritur më lart nivelin e punës politike në ushtri. Ne kemi vërtet edhe instruktorët jugosllavë, i thashë, dhe nuk mund të them se ata s'kanë fare eksperiencë, por, është e vërteta, eksperiencia e tyre është e kufizuar. Edhe ata kanë dalë nga një luftë e madhe nacionalçlirimtare, megjithëkëtë nuk mund të barazohen me oficerët sovjetikë.

Pasi i fola për moralin e lartë të ushtrisë sonë, për disiplinën, si dhe për një varg problemesh të tjera, i kërkova shokut Stalin që për diskutimin më me hollësi të problemeve të ushtrisë sonë dhe të nevojave të saj për të ardhmen, të më caktonte një shok sovjetik me të cilin mund të bisedoja më gjatë.

Shtrova pastaj me të problemin e forcimit të bregdetit tonë.

- Në mënyrë të veçantë, i thashë, na duhet të forcojmë ishullin e Sazanit, bregdetin e Vlorës dhe të Durrësit, pse këto pozita janë shumë delikate. Dy herë armiku andej na ka sulmuar. F.dhe më vonë andej mund të na vijë një sulm nga anglo-amerikanët ose nga italianët.

- Për forcimin e bregdetit tuaj - na tha shoku Stalin ndër të tjera - jam i të njëjtit mendim me ato që thoni ju. Ne, nga ana jonë, do t'ju ndihmojmë, por armët dhe mjetet e tjera, të mbrojtjes duhet të përdoren prej shqiptarëve e jo prej sovjetikëve. Mekanizmi i disave prej tyre vërtet është pak i ndërlikuar, por duhet të dërgoni njerëzit tuaj te ne që të mësojnë si t'i përdorin.

Lidhur me kërkesën time për dërgimin në Shqipëri të instruktorëve politikë për ushtrinë, shoku Stalin tha se nuk mund të na dërgonin më, për arsye se, që të punonin mirë ata, duhet të zotëronin gjuhën shqipe, të njihnin gjithashtu mirë situatën dhe jetën e popullit shqiptar. Prandaj, na këshilloi se do të ishte më mirë që ne të dërgonim në Bashkimin Sovjetik njerëz që të mësojnë nga eksperiencia sovjetike dhe këtë eksperiencë ata vetë ta zbatojnë në radhët e ushtrisë popullore shqiptare.

Pastaj shoku Stalin më pyeti për përpjekjet e reaksionit të brendshëm në Shqipëri dhe për qëndrimin tonë ndaj tij.

- Reaksionin e brendshëm, i thashë unë, e kemi goditur dhe vazhdojmë ta godasim rëndë. Në luftën për demaskimin dhe për shpartallimin e tij, kemi pasur suksese. Për sa i përket likuidimit fizik të armiqve, ky është bërë ose në përpjekjet e forcave tona ballë për ballë me bandat kriminale të armatosura, ose sipas vendimeve të gjyqeve të popullit, të zhvilluara kundër tradhtarëve dhe bashkëpunëtorëve më të ngushtë të pushtesve. Me gjithë sukseset e arritura, nuk mund të themi akoma se reaksioni i brendshëm tani po rri pa vepruar. Ai nuk është në gjendje të organizohet për të na goditur në mënyrë të rrezikshme, por prapëseprapë propagandon kundër nesh.

Armikun e brendshëm e mbështet ai i jashtëm për qëllimet e tij. Reaksioni i jashtëm përpiqet t'i ndihmojë, t'i inkurajojë dhe t'i organizojë armiqtë e brendshëm me anë agjentësh, që i ka futur nga toka dhe nga ajri. Përballë orvatjeve të armikut ne kemi ngritur vigjilencën revolucionare të masave punonjëse. Populli i ka kapur këta agjentë dhe janë zhvilluar një sërë procesesh gjyqësore kundër tyre. Gjykimet dhe dënimet publike kanë bërë një efekt të madh edukativ në popull dhe kanë ngjallur besimin e tij për forcën e pushtetit tonë popullor, respektin për drejtësinë e tij. Këto gjykime, në të njëjtën kohë, kanë demaskuar dhe kanë demoralizuar forcat reaksionare të brendshme e të jashtme.

Në vazhdim të bisedave me shokun Stalin një vend të rëndësishëm u kushtuam problemeve të situatës së jashtme, veçanërisht marrëdhëniet e shtetit tonë me vendet fqinje. Fillimisht une parashtrova gjendjen rreth kufijve tanë, fola për marrëdhëniet e mira që kishim me Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë, kurse u ndala veçanërisht në marrëdhëniet tona me Greqinë, për të sqaruar gjendjen në kufirin tonë të jugut. Theksova se monarko-fashistët grekë, që nuk arritën të realizonin dot ëndrrën e tyre të megaliidhesë, domethënë të grabitjes së Shqipërisë së Jugut, vazhdojnë provokacionet e panumërta kufitare. Qëllimi i tyre, i thashë shokut Stalin, është që të krijohet një konflagracion në kufirin tonë, dhe, akoma pa mbaruar mirë lufta, të krijohet një gjendje e acaruar në marrëdhëniet e Greqisë me ne. Shpjegova se ne po përpiqeni, me sa na është e mundur, që t'u shmangemi provokacioneve të monarko-fashistëve grekë, të mos u përgjigjemi. Vetëm kur ata e teprojnë herë pas here dhe na vrasin njerëz, ne marrim masa dhe u kundërpërgjigjemi që monarko-fashistët të kuptojnë se Shqipëria dhe kufijtë e saj janë të paprekshëm. Në rast se ata mendojnë të ndërmarin vepra të rrezikshme kundër pavarësisë së Shqipërisë, atëherë duhet ta dine se ne jemi në gjendje ta mbrojmë atdheun tonë.

Të gjitha qëllimet e monarko-fashistëve dhe përpjekjet që bëjnë ata për të bërë përgjegjëse Shqipërinë për luftën civile që ka shpërthyer në Greqi; për të diskredituar pushtetin tonë popullor në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit dhe në të gjitha mbledhjet ndërkombëtare, nxiten dhe përkrahen nga fuqitë imperialiste. Pasi shpjegova gjerë e gjatë këto situata i fola shokut Stalin në përgjithësi, se gfarë qëndrimesh mbanim ne në komisionin hetimor dhe në nënkomisionet që ishin krijuar për sqarimin e marrëdhëniet të acaruar në mes Shqipërisë dhe Greqisë.

Unë i thashë shokut Stalin të gjitha sa dinim ne mbi gjendjen e demokratëve grekë, i fola edhe për mbështetjen që i jepnim ne luftës së tyre të drejtë. Nuk mungova ta njoftoja haptazi edhe për mendimin tonë lidhur me një sere pikëpamjesh të shokëve të Partisë Komuniste Greke që neve na dukeshin të padrejta. Po ashtu i shpreha atij edhe mendimin tim për perspektivat e luftës së demokratëve grekë.

Megjithëse shoku Stalin duhet të ishte vënë në dijeni patjetër nga shokët Molotov, Vishinski e të tjerë, unë ia përmenda atij qëndrimet e egra dhe të poshtra të imperialistëve anglezë dhe amerikanë kundër Shqipërisë, duke vënë në dukje qëndrimet e ashpra, dinake e armiqësore që mbanin ata ndaj nesh në Konferencën e Parisit. I theksova, gjithashtu, se situata në mes nesh dhe anglo-amerikanëve nuk kishte ndryshuar asnjë grimë, se ne e konsideronim qëndrimin e tyre gjithnjë kërcënues. Ata vazhdonin të bënin jo vetëm një propagandë shumë armiqësore kundër Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, por, nëpërmjet Italisë e Greqisë, anglo-amerikanët na provokonin nga toka dhe nga ajri me elementë diversionistë shqiptarë, me zogistë, ballistë e fashistë të arratisur, të cilët i kishin

grumbulluar, organizuar e stërvitur kundër nesh në kampet e përqendrimit që kishin ngritur në Itali e gjetkë.

Po ashtu fola për ngritjen nga imperialistët anglezë në Këshillin e Sigurimit të OKB-ë të të ashtuquajturit incident i kanalit të Korfuzit dhe gjykimin e tij nga Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës. Incidenti i Korfuzit, i thashë shokut Stalin, u krijua kokë e këmbë nga anglezët për të provokuar vendin tonë dhe për të gjetur pretekstin e ndërhyrjes ushtarake në qytetin e Sarandës. Ne nuk kemi pasë vendosur kurrë mina në Detin Jon. Ato që shpërthyen, ose kishin qenë vendosur nga gjermanët që në kohën e luftës, ose qenë vënë qëllimisht më vonë prej anglezëve që t'i shpërthenin në kohën kur disa anije të tyre të ndodheshin në ujërat zona territoriale, në drejtim të Sarandës. Nuk kishin asnjë arsye këto anije që të lundronin në bregdetin tonë, ata nuk kishin lajmëruar për një udhëtim të tillë. Pas shpërthimit të minave anglezët pretenduan se patën dëmtime materiale dhe të vrarë. Ata dëshironin ta zgjeronin incidentin. Ne nuk dimë dhe nuk besojmë që anglezët të kenë pasur dëmet që pretenduan, por dhe në qoftë se vërtet kishin pasur dëme, faji nuk munti të bjerë aspak mbi ne.

Të drejtën tonë ne po e mbrojmë në Gjyqin Ndërkombëtar të Hagës, por ky gjyq, po manipulohet nga imperialistët anglo-amerikanë, të cilët trillojnë akuza nga më të ndryshmet për të mbuluar provokacionin e tyre e për të na detyruar që ne të zhdëmtojmë në favor të anglezëve.

Unë i fola shokut Stalin edhe për Konferencën e Moskës*, *(Nga 10 marsi deri më 24 prill 1947 u mbledh në Moskë Konferenca e ministrave të Jashtëm të Bashkimit Sovjetik, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Anglisë e të Francës. Kjo Konferencë diskutoi çështjet që kishin të bënin me Traktatin e Paqes me Gjermaninë. Përfaqësuesit e Bashkimit Sovjetik në këtë Konferencë, Molotovi dhe Vishinski, mbrojtën të drejtën e Shqipërisë për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes me Gjermaninë. Ky qëndrim u përkrah dhe nga përfaqësuesi francez, por u kundërshtua nga përfaqësuesit e Anglisë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.) argumentova mendimin tonë për doktrinën e Trumanit në lidhje me Greqinë dhe ndërhyrjet e anglo-amerikanëve në punët e brendshme të Republikës Popullore të Shqipërisë, sqarova qëndrimin tonë ndaj planit «Marshall», duke thënë se ne nuk do ta prananim «ndihmën» sipas këtij plani famëkeq.

Diskutova me shokun Stalin edhe problemin e dorëzimit të kriminelëve të luftës, që ishin arratisur riga vendi ynë. Ne, me shumë të drejtë, u kërkonim qeverive të vendeve që i strehonin të ria i dorëzonin kriminelët e luftës për t'i dhënë llogari popullit, megjithëse e dinim se nuk do të ria i jepnin, sepse qenë kontingjente të anglo-amerikanëve e të fashizmit në përgjithësi.

Shokut Stalin i parashtrova edhe mendimin e Partisë sonë për marrëdhëniet me Italinë. Italia ria ka sulmuar dy herë. Ajo ria ka djegur e ria ka vrarë, por ne jemi marksistë, internacionalistë dhe dëshirojmë të kemi marrëdhënie miqësore me popullin italian. Qeveria aktuale e Italisë, i thashë shokut Stalin, mban ndaj nesh qëndrimë reaksionare; qëllimet e saj ndaj vendit tonë nuk ndryshojnë riga ato të qeverive italiane të mëparshme. Kjo qeveri, nën ndikimin e anglo-amerikanëve, dëshiron që Shqipëria, në një mënyrë ose në një tjetër, të jetë e varur prej saj, gjë që nuk do të ndodhë kurrë. Për këtë qëllim, vazhdova më tej, anglo-amerikanët bashkë me qeverinë e Romës mbajnë dhe ushtrojnë në tokën italiane kontingjente të arratisurish, që i hedhin si diversantë në Shqipëri. Ata, duke hedhur gurin dhe dulce fshehur dorën, bëjnë shumë përpjekje kundër vendit tonë, por ne i kuptojmë të gjitha qëllimet e tyre. Ne dëshirojmë të kemi marrëdhënie diplomatike me të, por në këtë drejtim mentaliteti i qeveritarëve të Italisë është negativ.

Stalini, pasi më dëgjoi me vëmendje, më tha se almerikanët dhe anglezët, me gjithë vështirësitë dhe pengesat që ju krijojnë, në këto situata nuk mund t'ju sulmojnë. Ata, përballë qëndrimeve tuaja të vendosura, nuk mund të zbarkojnë në tokën tuaj, prandaj mos u shqetësoni. Megjithëkëtë atdheun duhet ta mbron, të merrni të gjitha masat për të forcuar ushtrinë dhe kufijtë, sepse rreziku i luftës riga imperialistët ekziston.

Monarko-fashistët grekë, vazhdoi Stalini, të nxitur e të përkrahur riga imperialistët amerikanë dhe anglezë, do të vazhdojnë t'ju provokojnë sa për t'ju shkaktuar kokëgarje dhe për të mos ju lënë të qetë. Qeveritarët e sotëm të Athinës e kanë të keqen riga brenda, tha ai, sepse lufta civile, që ka shpërthyer atje, drejtohet kundër tyre dhe padronëve të tyre, anglezë dhe amerikanë.

Për sa i përket Italisë, vazhdoi shoku Stalin, çështja qëndron ashtu sikurse mendoni ju. Atje anglo-amenikanët do të përpiqen të krijojnë baza, të organizojnë reaksionin dhe të fuqizojnë qeverinë e De Gasperit. Ju, në këtë drejtim, duhet të jeni vigjilentë për të ditur se çfarë bën emigracioni

shqiptar atje. Gjersa nuk janë përfunduar traktatet, tha shoku Stalin. gjendja nuk mund të quhet e normalizuar. Unë mendoj se ju, tani për tanë, nuk mund të vendosni marrëdhënie me këtë vend, prandaj mos u nxitoni.

- Ne jemi dakord, i thashë shokut Stalin, që të mos ngutemi në marrëdhëniet tona me Italinë dhe në përgjithësi do të marrim masa që t'i forcojmë kufijtë tanë.

U kemi propozuar jugosllavëve, vazhdova t'i parashtroja s'hokut Stalin, që të vihemi në lidhje me njëri-tjetrin e të bashkëpunojmë për të parashikuar mbrojtjen e kufijve tanë nga ndonjë sulm eventual grek ose italian, por ata nuk i janë përgjigjur propozimit tonë, duke pretenduar se mund të bisedojnë me ne, pasi ta studiojnë çështjen. Bashkëpunimi që propozojmë ne, qëndron në këmbiurnin e informatave me jugosllavët mbi rreziqet që mund të na kanosen nga armiqtë e jashtëm, në mënyrë që secili, brenda kufijve të tij dhe me ushtritë e tij, të ketë mundësi të marrë masat e përshtatshme për të përballuar çdo eventualitet. Gjithashtu, e vura në dijeni shokun Stalin, se ne kishim dy divizione të ushtrisë sonë në kufirin e j gut.

Gjatë bisedës nënvizova faktin që disa aeroplanë jugosllavë kishin ardhur në Tiranë në kundërshtim me rregullat e njohura dhe të pranura në marrëdhëniet midis shteteve. Shokët jugosllavë herë pas here, pa na lajmëruar, bëjnë disa veprime të dënueshme, siç është edhe ky rast konkret. Nuk është e drejtë të fluturojnë aeroplanët jugosllavë mbi qiellin shqiptar pa ditur gjë Qeveria Shqiptare. Ne ua kemi vënë në dukje këtë shkelje shokëve jugosllavë dhe ata na janë përgjigjur se kanë bërë gabim. Pavarësisht se jemi miq, atyre ne nuk mund t'u lejojmë shkeljen e integritetit tonë. Ne jemi shtete të pavarura dhe secili, pa prishur marrëdhëniet miqësore, duhet të ruajë sovranitetin dhe të drejtat e veta, duke respektuar në të njëjtën kohë sovranitetin dhe të drejtat e tjetrit.

- Nuk është i kënaqur populli juaj nga marrëdhëniet me Jugosllavinë? - më pyeti në këtë rast shoku Stalin dhe vazhdoi: - Është një gjë shumë e mirë që ju keni Jugosllavinë mike në kufi, se Shqipëria është një vend i vogël dhe, si

i tillë, ka nevojë edhe për një mbështetje të fortë nga miqtë e saj.

Unë iu përgjigja se është e vërtetë që çdo

vend, i vogël apo i madh qoftë ka nevojë për miq dhe aleatë dhe se ne e konsiderojmë Jugosllavinë një vend mik.

Me shokun Stalin dhe me shokun Molotov ne biseduam me hollësi për problemet e rindërtimit të vendit nga shkatërrimet e luftës dhe të

ndërtimit të Shqipërisë së re. Bëra një përshkrim të gjendjes së ekonomisë sonë, të transformimeve të para socialiste në ekonomi e të perspektivave të mëdha që na hapeshin, të sukseseve që kishim arritur, të problemeve e të vështirësive të mëdha që kishim përpara.

Stalini shprehte kënaqësinë që ndiente për fitoret që kishim arritur dhe herë pas here më drejtonte pyetje nga më të ndryshmet. Në mënyrë të veçantë ai u interesua për gjendjen e bujqësisë sonë, për kushtet klimaterike në Shqipëri, për kulturat bujqësore tradicionale të popullit tonë etj.

- Cilat janë drithërat që mbillni më te për? - më pyeti ai ndër të tjera.

- Në radhë të parë misri, i thashë, pas taj vijnë gruri, thekra. . .

- Nuk ka frikë misri nga thatësira?

- Është e vërtetë, i thashë, se thatësira shpesh na dëmton s'humë rëndë, por për vetë gjendjen e prapambetur të bujqësisë sonë dhe për nevojat e mëdha që kemi për bukë, fshatari ynë është mësuar të marrë nga misri diçka më tepër se nga gruri. Ndërkaq po marrim masa për krijimin e rrjetit kullues e ujitës, për tharjen e kënetave e të moçaleve.

Ai dëgjonte përgjigjet që i jepja, pyeste më hollësisht dhe shpesh merrte fjalën duke na dhënë këshilla shumë të vyera. Kështu më kujtohet që në ato biseda Stalini u interesua të dinte mbi ç'baza është bërë Reforma Agrare në Shqipëri, cilat qenë përqindjet e shpërndarjes së tokave në fshatarët e varfër e të mesëm, nëse qenë prekur nga kjo Reformë institucionet fetare etj., etj.

Duke folur për ndihmën që shteti i demokracisë popullore i jepte fshatarësisë dhe për lidhjet e klasës punëtore me fshatarësinë, Stalini na pyeti për traktorët, desh të dinte nëse kishim Stacione të

Makinave e të Traktorëve në Shqipëri dhe si i kishim organizuar ato. Pasi dëgjoji përgjigjen time, ai nisi të flasë lidhur me këtë çështje dhe na dha një tok këshillash të vlefshme.

- SMT-të - na tha ndër të tjera - duhet t'i krijoni e t'i forconi dhe ato të punojnë mirë si tokat e shtetit e të kooperativave ashtu edhe ato të fshatarëve. Traktoristët të jenë vazhdimisht në shërbim të fshatarësisë, ta njohin bujqësinë, kulturat, tokat dhe këto njohuri t'i zbatojnë në prak tikë me qëllim që të rritet patjetër prodhimi. Kjo ka rëndësi të madhe, vazhdoi ai, se ndryshe dëmet janë të gjithanshme. Kur ne krijuam stacionet e para të makinave e të traktorëve, në shumë raste na ndodhte që ua punonim tokën fshatarëve, por prodhimi nuk rritej. Ndodhte kjo për arsye se një traktorist nuk mjafton vetëm të dijë të ngasë traktorin, por të jetë edhe një bujk i mirë, të dijë kur duhet punuar e si duhet punuar toka.

Traktoristët, vazhdoi Stalini, janë elementë të klasës punëtore që punojnë duke qenë në kontakt të vazhdueshëm, të përditshëm e të drej t'përdrejtë me fshatarësinë. Prandaj ata duhet të punojnë me një ndërgjegje të tillë që të kalitin aleancën në mes klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse.

Vëmendja me të cilën ai ndiqte shpjegimet për ekonominë tonë të re dhe rrugët e zhvillimit të saj na bënë përshtypje shumë të thellë. Si gjalë bisedës për këto probleme, ashtu edhe në të gjitha bisedat e tjera me të, më ka mbetur në mendje, veç të tjerash, një tipar i tij i mrekullueshëm: asnjëherë nuk jepte urdhra e as të impononte mendimin e tij. Ai fliste, këshillonte, bënte edhe propozime të ndryshme, por gjithnjë shtonte: «ky është mendimi im», «kështu mendojmë ne. Ju, shokë, shikoni e vendosni vetë, sipas situatës konkrete, në bazë të kushteve tuaja». Interesimi i tij shtrihej në çdo problem.

Ndërsa po flisja për gjendjen e transportit dhe për vështirësitë e mëdha që na duhej të përballonim, Stalini më pyeti:

- Ndërtoni vaporë të vegjël në Shqipëri?

- Jo, i thashë. .

- Po pisha keni?

- Kemi, u përgjigja, pyje të tëra.

- Atëherë ju keni një bazë të mirë, tha ai, për të ndërtuar në të ardhmen mjete të thjeshta për transportin detar.

Në vazhdim të bisedës ai më pyeti se si paraqitet në Shqipëri komunikacioni hekurudhor, çfarë monedhe kemi, çfarë minierash kemi dhe nëse janë shfrytëzuar minierat e Shqipërisë nga italianët etj.

Unë iu përgjigja pyetjeve që bëri shoku Stalin, i cili, dulce përfunduar bisedimin, tha:

- Ekonomia shqiptare, aktualisht, është në gjendje të prapambetur. Ju, shokë, çdo gjë po e nisni nga e para. Prandaj, krahas luftës e përpjekjeve tuaja, edhe ne, nga ana jonë, do t'ju ndihmojmë, sipas mundësive që kemi për mëkëmbjen e ekonomisë dhe për forcimin e ushtrisë suaj. Ne i studiuam, më tha shoku Stalin, kërkesat tuaja për ndihmë dhe ramë dakord t'ju plotësojmë të gjitha. Do t'ju ndihmojmë për pajisjen e industrisë dhe të bujqësisë me makineritë e nevojshme, për forcimin e ushtrisë, për zhvillimin e arsimit e të kulturës. Fabrikat e makineritë e tjera do t'ju japim me kredi dhe do t'i paguani kur të keni inundësi, kurse armatimet u jepen falas, nuk do të paguhen kurrë. E dimë se ju duhen edhe më shumë, por tani për tanfi këto janë mundësitë tana, sepse vetë jemi akoma të varfër ngaqë na shkatërroi lufta.

Në të njëjtën kohë, vazhdoi shoku Stalin, ne do t'ju ndihmojmë me specialistë për të shpejtuar procesin e zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës shqiptare. Për naftën mendoj t'ju dërgojmë specialistë azerbajxhanas, se këta janë mjeshtër shumë të mirë. Nga ana e saj, Shqipëria të dërgojë në Bashkimin Sovjetik bij të punëtorëve e të fshatarëve që të mësojnë e të zhvillohen për ta shpënë atdheun përpara.

Gjatë ditëve që qëndruam në Moskë, pas çdo takimi e bisede me shokun Stalin, akoma më shumë e më nga afër shihnim te ky revolucionar i shquar, te ky marksist i madh edhe njer iun e thjeshtë, të dashur, të urtë - njeriun e vërtetë. Ai e donte me gjithë zemër popullin sovjetik, atij ia kishte kushtuar tërë forcat dhe energjitë, për të, i punonte mendja e zemra. Dhe këto veti i dalloje në çdo bisedë me të, në çdo aktivitet që kryenie që nga ato më të rëndësishmet e gjer te më të zakonshmet.

Disa ditë pas mbërritjes sonë në Moskë asistova, bashkë me shokun Stalin dhe udhëheqës të tjerë të Partisë e të shtetit sovjetik, në një manifestim fizkulturor për gjithë Bashkimin Sovjetik në Stadiumin Qendror të Moskës. Me ç'pasion E ndoqi Stalini këtë aktivitet ! Mbi dy orë e ca qëndroi krejtësisht i përqendruar pas veprimeve të manifestuesve dhe, megjithëse nga fundi i manifestimit nisi të binte shi e disa herë me radhë Molotovi iu lut që të largohej, ai vazhonte të ndiqte gjer në fund me vëmendje veprimet, të bënte shaka, të përshëndeste me dorë. Mbaj mend, se në mbyllje të ushtrimeve u organizua një kros masiv. Vrapuesit i r anë disa herë rrotull stadiumit. Ndërsa. gara po mbaronte, para tribunës u duk një vrapues që kishte mbetur prapa, ishte shtatgjatë e tepër i hollë. Mezi i hidhte këmbët, duart i lëviznir para e mbrapa, e megjithatë përpiquej të vraponte. Ishte lagur e bërë qull nga shiu. Stalini po e shihte që nga larg këtë vrapues me një buzëqeshje që shprehte keqardhje e ngrohtësi prej ati:

- Millij moj* *(I dashuri im, i shtrenjti im.) - iu drejtua si duke folur me viete - shko në shtëpi, shko në shtëpi, çlodhu pakëz, ha bukë dhe eja prapë! Do të ketë përsëri vrapime. . .

Të pashlyeshme më kanë mbetur në kujtesë respekti dhe dashuria e madhe e Stalinit për popullin tonë, interesimi i tij për të mësuar sa më shumë rreth historisë e zakoneve të popullit shqiptar. Në një nga takimet që patëm ato ditë, gjatë darkës që Stalini shtroi për delegacionin tonë në Kremlin, me të ne zhvilluam një bisedë shumë interesante rreth origjinës dhe gjuhës së popullit shqiptar.

- Cila është origjina dhe gjuha e popullit tuaj - më pyeti, ndër të tjera - dhe a mos është i afërt populli juaj me baskët? Populli shqiptar -- vazhdoi pastaj Stalini - nuk besoj të ketë ardhur nga Azia e Largët, as me origjinë turke ai s'është, se shqiptarët janë më të vjetër nga turqit. Ndofta populli juaj mund të ketë rrënjë të përbashkëta me ata etruskë që kanë mbetur në malet tuaja, se të tjerët që shkuan në Itali një pjesë u asimiluan nga romakët dhe një pjesë kaluan në Gadishullin Iberik.

Unë iu përgjigja shokut Stalin se origjina e popullit tonë është shumë e lashtë, dhe gjuha e. tij është indoevropiane. Ka shumë teori për këtë, çështje, por e vërteta është se origjina jonë është ilire. Ne jemi një popull me prejardhje ilire. Ka gjithashtu një teori që shtron tezën se populli shqiptar është populli më i vjetër i Ballkanit dhe origjina e lashtë parahomerike e shqiptarëve janë pellazgët.

Teoria e pellazgëve, sqarova më tej, për një kohë është zhvilluar nga shumë shkencëtarë, veganërisht nga shkencëtarë gjermanë. Ka gjithashtu edhe ndonjë shkencëtar shqiptar, i njohur si specialist i Homerit, që arrin në këtë konkluzion, duke u mbështetur në disa fjalë të përdorura në Iliadën dhe në Odisenë dhe që fliten aktualisht nga populli shqiptar, si, për shembull, fjala gur, dcmethënë «kamjenj» rusisht. Homeri këtë fjalë e vë para fjalës greke e thotë «guri-petra». Pra, duke u mbështetur në disa fjalë të tilla, duke mari ë parasysh Orakullin e Dodonës, disa dokumentacione ose etiologji fjalësh, të cilat kanë pasur ndryshime sipas shumë shpjegimeve filologjike, shkencëtarët nxjerrin se paraardhësit tanë të lashtë kanë qenë pellazgët, të cilët kanë jetuar më përpara se grekët në Gadishullin Ballkanik.

Sidoqoftë unë nuk kam dëgjuar që shqiptarët të jenë të një origjine me baskët, i thashë shokut Stalin. Mundet të ekzistojë edhe një teori e tillë, ashtu sikurse teoria që thatë ju, se një pje së e etruskëve ka mbetur në Shqipëri, pjesa tjetër është shkëputur dhe është vendosur në Itali, kurse një pjesë tjetër që andej ka esndkousaur në Gadishullin Iberik, në Spanjë. Ka mundësi që edhe kjo teori të ketë përkrahësit e saj, por unë nuk kam dijeni për të.

- Kemi në Kaukaz një vend që quhet Albani - më tha në një rast Stalini - të ketë lidhje me Shqipërinë ?

- Nuk e di këtë gjë, i thashë, por fakt është

se shumë shqiptarë gjatë shekujve, të detyruar nga pushtimi i egër otoman, nga luftërat e nga kryqëzatat e egra të sulltanëve e të padishahëve osmanë,

shpesh janë detyruar të lënë vendlindjen e tyre e të ngulen në dhera të huaja ku kanë formuar edhe fshatra të tëra. Kështu ka ndodhur me mijëra shqiptarë që u ngulën në Italinë e Jugut që në shekullin e 15-të, pas vdekjes së Heroit tonë Kom

bëtar, Skënderbeut, dhe tanfi atje janë zona të tëra ku banojnë arbëreshët e Italisë, të cilët, megjithëse kanë 4-5 shekuj në vend të huaj, akoma ruajnë gjuhën dhe zakonet e vjetra të atdheut të të parëve. Po kështu - i thashë shokut Stalin - shumë shqiptarë u vendosën në Greqi, ku ka zona të tëra të banuara me arbëreshët e Greqisë, të tjerë u vendosën në Turqi, në Rumani, në Bullgari, në Amerikë e gjetkë... Por, për vendin tuaj që quhet «Albani», i thashë; nuk di asgjë konkrete.

Atëherë Stalini më pyeti për një varg fjalësh të gjuhës sonë. Deshi të dinte si i quanim ne veglat e punës, orenditë shtëpiake etj. Unë i përgjigjesha në shqip dhe ai, pasi i dëgjonte fjalët me kujdes, i përsëriste, bënte krahasimin midis emrit shqip të veglës së punës dhe ekuivalentit të saj në gjuhën e albancve të Kaukazit. Herë pas here u drejtohej Molotovit dhe Mikojanit se si mendonin ata. Doli se në rrënjën e fjalëve të krahasuara s'kishte ndonjë përngjasje.

Në këtë moment Stalini shtypi një buton e pas disa sekondash hyri gjenerali që shërbente pranë Stalinit, një ushtarak shtatlartë e shumë i kujdesshëm, i cili sillej me mjaft dashamirësi e simpati ndaj nesh.

- Me shokun Enver Hoxha po përpiqemi të zgjidhim një problem, por nuk mundemi i tha Stalini duke buzëqeshur gjeneralit. - Lidhu, të lutem me profesor (dhe përmendi një gjuhëtar e historian të shquar sovjetik, emri i të cilit nuk më kujtohet) dhe pyete nga ana ime nëse ka lidhje midis albancve të Kaukazit dhe Shqipërisë.

Pasi gjenerali doli, Stalini mori një kokërr portokall, e ngriti lart dhe më tha:

- Në rusisht i thonë «apjelsin». Po shqip?

- Portokall, u përgjigja unë.

Përsëri bëri krahasimin duke i shqiptuar fjalët e të dyja gjuhëve dhe mblodhi supet. S'kaluan as 10 minuta dhe hyri gjenerali.

- Mora përgjigjen e profesorit - na tha.

Ai thotë se nuk ka asnjë tërësi që të flasë për lidhje midis albancve të Kaukazit dhe Shqipërisë. Por, shtoi, se në Ukrainë në zonën e Odesës janë disa fshatra (rreth 7) të populluara prej shqiptarëve. Për këtë profesori :a të dhëna të sakta.

Nga ana ime aty për ty Porosita ambasadorin tonë në Moskë të intersohej që disa nga studentët tanë që përgatitesh~ për histori në Bashkimin Sovjetik do të qe mrë ta bënin praktikën në këto fshatra e të studio<In si e kur ishin ngulur në Odesë këta shqiptar, a i ruajnë gjuhën e zakonet e të parëve etj.

Stalini, si gjithmonë, tepër i vëmendshëm, na dëgjoi dhe më tha:

- Shumë mirë, shumë mirë do të jetë. Atje le ta bëjnë praktikën studentët tuaj, bile bashkë me ta edhe disa nga tanët.

- Shkencat albanolejike - i thashë në vazhdim të kësaj bisede të lirë shokut Stalin në të kaluarën nuk kanë në zhvilluar si duhej dhe më tepër me to janë ~rrë studiues të huaj. Kjo, veç të tjerash, ka bërë të lindin edhe lloj-lloj teorish mbi origjinën e °oPullit, të gjuhës sonë etj. Sidoqoftë një gjë është e Përbashkët thujse të gjitha - fakti që populli shqiptar dhe gjuha jonë janë me një origjinë shumë të lashtë. Por fjalën e saktë për këto)robleme do ta thonë albanologët tanë, të cilët jartia dhe shteti ynë do t'i përgatitin me kujde;e do t'u krijojnë të gjitha kushtet e nevojshme ër punë.

Shqipëria - më tha Stalini - duhet të ecë me këmbët e veta se i ka të gjitha mundësitë.

- Ne do të ecim patjetër përpara - iu përgjigja unë.

- Nga ana jonë ne do ta ndihmojmë me gjithë zemër popullin shqiptar - tha me dashamirësi shoku Stalin - se shqiptarët janë njerëz të mirë.

E gjithë darka që shtroi për nder të delegacionit tonë shoku Stalin kaloi në një atmosferë shumë të ngrohtë, të përzemërt, intime. Stalini dollinë e parë e ngriti për popullin tonë, për përparimin dhe për lulëzimin e mëtejshëm të vendit tonë, për Partinë Komuniste të Shqipërisë. Pastaj ai ngriti dollin për mua, për Hysniun* *(Shoku Hysni Kapo, në atë kohë zëvendësministër i Punëve të Jashtme të RPSH, ishte anëtar i delegacionit tonë që shkoi në Moskë në korrik 1947.) e për gjithë anëtarët e delegacionit shqiptar. Mbaj mend, se, më pas, kur unë i fola për qëndrueshmërinë e madhe të popullit tonë në shekuj ndaj invazioneve të huaja, shoku Stalin e cilësoi popullin tonë popull heroik dhe ngriti për të dytën herë dollin për të. Përveç bisedave të lira që bëmë së bashku, herë pas here ai u drejtohej edhe të tjerëve,

bënte shaka, uronte. Nuk hante shumë, por gotën me verë të kuqe e tubante afër dhe e trokiste buzëqeshur sa herë ngrihej dollia.

Pas darkës shoku Stalin na ftoi të shkonim në kinemanë e Kremlinit ku, përveç disa kinoditarëve, pamë filmin artistà sovjetik «Traktoristi». U ulëm të dy në një kanape dhe më bëri përshtypje kujdesi me të cilin Stalin: e ndoqi këtë film të ri të prodhimit sovjetik. Shpeshherë ngrinte zërin e tij të ngrohtë dhe na fuste për momente të ndryshme nga ngjarjet që trajtoheshin në film. Veçanërisht i pëlqeu shumë mënyra se si protagonist i filmit, një traktorist pararojë, për të fituar besimin e shokëve të tij dhe të bujqve. Luftonte që të njihnte mirë zakonet dhe sjelljet e njerëzve të fushës, mendimet dhe aspiratat e tyre. Duke punuar e jetuar me njerëzit, ky aktorist arriti të bëhej drejtues i nderuar e i respektuar nga fshatarët. Stalini në këtë moment za tha:

- Që të mundesh të drejtosh, duhet të njohësh masën dhe. që ta njohësh atë, duhet të zbresësh te masa.

Ora kishte kaluar nga 24 00 kur ne u ngritëm të iknim. Atë çast Stalin. na ftoi edhe një herë të merrnim gotat e verës dhe për të tretën herë ngriti dolli «për popullin zeroik shqiptar».

Pas kësaj na përshëndeti të gjithë me radhë dhe, kur më dha dorën mua, më porositi:

- Jepi të falat e ma të përzemërta popull i t heroik shqiptar. të cilit i uroj suksese !

Më 26 korrik 1947 delegacioni ynë, shumë i I:Ë naqur nga takimet dhe aga bisedat me shokun Stalin. mori rrugën e kthinit për në atdhe.

TAKIMI I DYTË

Mars-prill 1949

Qëndrimi yng ndaj udhëheqjes jugosllave qysh në vitet e luftës. Kongresi i Irrë i PKSH. Politikë terrori në Kosovë. Për divizionet jugosllave që do të dërgoheshin në Shqipëri. Titistët synonin të përmbysnin situatën në Shqipëri. Mbi luftën e popullit vëlla grek. Pikëpamje të gabuara ti; udhëheqjes si; PK ti; Greqisë. Anglezët si kusht për njohje duan ti; kenë baza ushtarake në portet tona. Rruga e zhvillimit ekonomik e kulturor të Shqipërisë. Mbi gjendjen e fshatarësisë sonë. Rreth historisë, kulturës, gjuhës, zakoneve të popullit shqiptar.

Shkova përsëri në Moskë, më 21 mars 1949, në krye të një delegacioni zyrtar të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qëndrova atje gjer më 11 prill të atij viti.

Në aero-dromin e Moskës kishin dalë për të na pritur Mikoiani, Vishinski, Meshnikovi* *(Në atë kohë ministër i Tregtisë së Jashtme të BRSS.) dhe të gjithë përfaqësuesit diplomatikë të vendeve të demokracisë popullore.

Takimin e parë zyrtar e bëmë me Vishinskin të nesërmen e mbërritjes sonë dhe më 23 mars në orën 22 e 5 minuta u pritja nga shoku Stalin në Kremlin në praninë e Vishinskit dhe të ambasadorit të BRSS në Shqipëri Çuvahin. Në këtë takim isha tok me Spiro Kolekën dhe me Mihal Priftin, që në atë kohë ishte ambasadori ynë në Moskë.

Shoku Stalin na priti në zyrën e tij me përzemërsi të madhe. gasi na takoi me radhë, u ndal para meje:

- Më dukesh i hequr në fytyrë - m'u drejtua - mos ke qenë sëmurë? Apo je i lodhur?

- Jam shumë i gëzuar dhe i lumtur që takohem përsëri me ju - iu përgjigja dhe, pasi u ulëm, i thashë se dëshiroja të -parashtroja disa çështje.

- Jeni i pakufizuar në kohë - më tha gjithë dashamirësi, me qëllim që unë të flisja për çdo gjë që do ta çmoja të nevojshme.

I bëra shokut Stalin një ekspozitë për një sërë problemesh. I folë përgjithësisht për situatën e Partisë dhe të vendit tonë, për ngjarjet e kohëve të fundit, për gabimet e vërtetuara, si dhe për qëndrimin tonë në lidhje me çështjen jugosllave. Përmenda se, si rezultat i ndikimit të udhëheqjes trockiste jugosllave mbi udhëheqjen e Partisë sonë dhe i besimit të tepruar të disa udhëheqësve tanë ndaj udhëheqjes tradhtarë jugosllave, janë vërtetuar gabime të mëdha, sidomos në vijën organizative të Partisë, ashtu siç i konstatoi Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, punimet e të cilit u zhvilluan nën dritën e Letrave të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe të Rezolutës së Byrosë Informative «Mbi gjendjen në Partinë Komuniste Jugosllave».

- Komiteti Qendror i Partisë sonë, i thashë shokut Stalin, e pranoi plotësisht Rezolutën e Byrosë Informative dhe me një komunikatë të posaçme ne dënuam rrugën tradhtarë, antishqiptarë dhe antisovjetike të udhëheqjes trockiste jugosllave. Udhëheqja e Partisë sonë, theksova, prej vitesh ishte ndeshur me veprimtarinë armiqësore e komplotiste të titistëve, me arrogancën e intrigat e të deleguarve të Titos, Vukmanoviç Tempo e Dushan Mugosha. Në prag të Qhrimit të Shqipërisë, përmenda ndër të tjera, Titoja, për të realizuar qëllimet e tij antishqiptarë e antimarksiste, dërgoi te ne një delegacion të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, të kryesuar nga delegati i saj i jashtëzakonshëm, Velimir Stojniç. Ky dhe bashkëpunëtorët e tij të fshehtë, tradhtarët Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe, Pandi Kristo e të tjerë përgatitën prapaskenën e dëmshme e të rrezikshme të Beratit, e cila në vetvete ishte një komplot i rëndë kundër vijës së drejtë që kishte ndjekur Partia gjatë gjithë kohës së luftës, kundër pavarësisë së Partisë e të vendit tonë, kundër personit të Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë etj. Pjesa e shëndoshë e udhëheqjes së Partisë sonë, megjithëse nuk diete gjë për komplotin e kurdisur, qysh aty iu kundërvu me forcë akuzave të ngritura kundër saj dhe vijës së ndjekur gjatë luftës. Më pas unë, i bindur se në Berat qenë bërë gabime të rënda në rrugë antimarksiste, veç të tjerash i paraqita Byrosë sonë Politike Tezat për rishikimin e Plenumit të Beratit, por, si pasojë e veprimtarisë së ethëshme diversioniste të udhëheqjes jugosllave e të agjentëve të saj në radhët tona, këto teza nuk u pranuan. Zhvillimi i mëtejshëm i ngjarjeve, Letrat e Komitetit Qendror të Partisë suaj si dhe Rezolucioni i Byrosë Informative, i thashë më tej shokut Stalin, na e sqaruan plotësisht gjendjen, u zbulua e u vërtetua veprimtaria armiqësore e udhëheqjes jugosllave me Titon në ikrye dhe komplotistët në radhët e Partisë sonë u demaskuan rëndë në Plenumin e 11-të të KQ të Partisë. Kongresi i 1-rë i PKSH aprovoi dhe thelloi më tej kthesën që s'hënoi Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror. Aie vlerësoi të drejtë vijën politike që kishte ndjekur Partia që prej themelimit të saj, ndërsa shtrembërimet e veçanta që u dukën pas Çlirimit, sidomos në vijën organizative të Partisë, ishin pasojë e ndërhyrjes jugosllave dhe e veprimta risë trockiste e tradhtarë të Koçi Xoxes, Pandi Kristos e Kristo Themelkos.

Përmenda se Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo kanë qenë të dy agjentë të rrezikshëm të trockistëve jugosllavë në gjirin e udhëheqjes së Partisë sonë, se ata me orientimin, me mbështetjen dhe me përkrahjen e titistëve jugosllavë kishin bërë të gjitha përpjekjet për të uzurpuar pozitat kyçe në Parti e në shtetin tonë të demokracisë popullore. Në gjithë veprimtarinë e tyre tradhtarë, ata qenë vënë në shërbim të politikës nacionalshoviniste e kolonialiste të udhëheqjes trockiste jugosllave kundërshtuar Republikës Popullore të Shqipërisë. Përmenda gjithashtu se Kristo Themelkoja ka qenë një nga më të ndikuarit prej udhëheqjes trockiste jugosllave dhe ka zbatuar pa rezerva direktivat e saj në sektorin e ushtrisë.

Ky, vazhdova më tej, pasi u zbulua plotësisht tradhtia e udhëheqjes jugosllave, i pranoi gabimet dhe bëri autokritikë përpara Partisë.

Stalini, që po dëgjonte me vëmendje, më pyeti:

- Kush janë këta të tre? Janë sllavë, shqiptarë apo çfarë?

- Kristo Themelko, i thashë, është me origjinë maqedonase, kurse Koçi Xoxe është me origjinë shqiptarë, por prindërit e tij kanë jetuar në Maqedoni.

Vazhdova t'i flisja për rëndësinë jashtëza

konishtë të madhe që patën për Partinë tonë Letrat e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste

të Bashkimit Sovjetik drejtuar udhëheqjes jugosllave dhe Rezolucioni i Informbyrosë. Në dritën e këtyre dokumenteve, që erdhën në momento shumë të mprehta për Partinë e popullin tonë, i thashë shokut Stalin, për Komitetin Qendror të Partisë sonë u bënë plotësisht të qarta karakteri dhe qëllimet e ndërhyrjes jugosllave në Shqipëri. Pasi i fola në vija të përgjithshme për masat e shumta e rrënjësore që mori Partia jonë për t'i dhënë fund kësaj veprimtarie të egër, agjenturore, antimarksiste e antishqiptare, i thashë, se për gjithë sa ndodhën, megjithëse qysh në vitet e luftës ne qemë ndeshur e u qemë kundërvënë veprimeve të tyre të shtrembra, prapëseprapë ne e ndiejmë përgjegjësinë se duhej të ishim treguar më vigjilentë.

Këtu shoku Stalin më ndërhyri me këto fjalë

- Në përmbajtjen e letrave tona drejtuar udhëheqjes jugosllave nuk përfshihen të tëra, sepse ka dhe shumë çështje që kanë dalë më vonë. Ne nuk e dinim se jugosllavët, nën pretekstin e «mbrojtjes» së vendit tuaj nga sulmi i fashistëve grekë, donin të sillnin njësi të ushtrisë së tyre në RPSH. Ata përpiqeshin ta bënin këtë në mënyrë shumë sekrete. Në të vërtetë qëllimi i tyre në këtë drejtim ishte krejtësisht armiqësor, sepse synonin të përmbysin situatën në Shqipëri. Njoftimi që na bëtë ju për këtë çështje, ishte me vlerë, ndryshe nuk do të dinim asgjë për këto divizione, që ata donin t'i futnin në tokën tuaj.

Ata kanë lënë të kuptohej sikur këtë veprim gjoja e ndërmerrnin me pëlqimin e Bashkimit Sovjetik! Sa për atë që thatë ju, se duhet të ishit treguar më vigjilentë, e vërteta është se në drejtim të marrëdhënieve me Jugosllavinë s'ka pasur mungesë vigjilence vetëm nga ju, por edhe nga të tjerë.

Në vazhdim të bisedës, i thashë shokut Stalin se momentet e vështira të krijuara nga titistët dhe nga monarko-fashistët që janë nën urdhrat e imperialistëve amerikanë dhe anglezë kundër vendit tonë, u kapërcyen me sukses në saje të vijës së drejtë të Partisë, të patriotizmit të popullit tonë dhe të ndihmës së PK të Bashkimit Sovjetik. Kjo ishte një provë e madhe nga e cila ne mësuam shumë për të korrigjuar të metat tona, për të konsoliduar fitoret e arritura deri tani dhe për të luftuar që Vi forcojmë dhe Vi zhvillojmë më tej. Ushtria jonë i përballoi detyrat e saj me guxim dhe me patriotizëm të lartë.

Gjatë periudhës së vështirë që kaluam, patriotizmi i masave ka qenë shumë i madh. Besimi në Partinë tonë, në vijën e saj të drejtë dhe ndaj Bashkimit Sovjetik ka qenë i palëkundur. Puna e armikut të brendshëm nuk pati jetë të gjatë. Ne, i thashë shokut Stalin, e neutralizuam punën armiqësore të njerëzve të vënë në shërbim të udhëheqjes trockiste jugosllave. Ndaj atyre që, në një mënyrë ose në një tjetër, janë implikuar në veprimtarinë antishqiptare të udhëheqjes trockiste jugosllave, kemi mbajtur e mbajmë qëndrime të diferencuara. Një pjesë bënë autokritikë se ishin gabuar në mirëbesim, kurse disa që ishin komprometuar rëndë tani po japin llogari para gjyqit të popullit.

- Mbrojeni atdheun dhe Partinë - tha shoku Stalin. - Armiku duhet demaskuar plotësisht dhe me argumente bindëse që ta shikojë populli se çfarë ka bërë dhe të bindet në rrezikshmërinë e këtij armi'ku. Një armik i tillë i diskredituar plotësisht në sytë e popullit, edhe sikur të mos pushkatohet, vetvetiu është moralisht dhe politikisht i pushkatuar, sepse pa popullin ai s'është në gjendje të bëjë dot gjë.

- Procesi gjyqësor që po zhvillohet tani në Tiranë - i thashë shokut Stalin - bëhet me dyer të hapëta dhe të gjitha ç'thuhet në sallën e gjyqit botohen në gazeta.

Në të njëjtën kohë, shtova më tej, ata që i kanë kuptuar thellë gabimet, që kanë bërë autokritikë të sinqertë e bindëse, ne i kemi trajtuar me kujdes e zemërgjerësi dhe u kemi krijuar mundësitë që t'i shlyejnë gabimet e fajet e bëra me punë, me besnikëri ndaj Partisë e popullit. Ndonjërin prej tyre bile, kemi menduar ta dërgojmë edhe për studime në Bashkimin Sovjetik, dhe i përmenda emrin e njërit.

- Si, si? - më pyeti Stalini e më pa drejt në sy. - Paskeni kërkuar që ai të vijë për studime te ne? Keni ju akoma besim politik tek ai?

- Po, i thashë, autokritika e tij ka ardhur vazhdimisht duke u thelluar dhe ne kemi shpresa se ai do të ndreqet.

- Po ai dëshiron të vijë këtu?

- Vetë ai ka shprehur dëshirën që të vijë, i thashë.

Në këtë kohë edhe Cuvahini dha disa sqarime në përkrahje të mendimit tim.

- Mirë atëherë, gjersa ju shoku Enver, e keni peshuar drejt këtë gjë, le të vijë. . .

Në vazhdim të bisedës i thashë shokut Stalin se gjatë po kësaj periudhe amerikanët nëpërmjet Italisë hodhën grupe diversantësh nga ajri në Jug dhe në Veri të Shqipërisë. Një pjesë të këtyre diversantëve ne i vramë, të tjerët i kapëm robër. Duke parashikuar vështirësitë në kufirin tonë jugor, e për të disponuar forcat për këtë qëllim, neve na duhej më parë të ndërmerim dhe ndërmorëm ,pastrimin e Veriut të Shqipërisë nga grupet e banditëve politikë dhe ordererë që vepronin brenda kufijve tanë nën drejtimin e agjentëve të dërguar nga Rankoviçi. Këto banda në shërbim të jugosllavëve, bënë një sërë atentatesh. Pastrimi ynë doli me sukses: Ne asgjësua disa prej tyre dhe gjithë të tjerët kaluan në territorin jugosllav ku gjenden edhe sot.

- Vazhdojnë të hedhin diversantë të tjerë? - pyeti Stalini.

- Mendojmë se ata s'kanë hequr dorë. Politika e Titos dhe e Rankoviçit për të tërhequr në territoret e tyre shqiptarë, për të organizuar me ta grupe sabotatorësh dhe diversantësh pësoi disfatë dhe, aktualisht, ka shumë pak arratisje. Qeveria jonë ka marrë masa ekonomike dhe puna politike e organizative e Partisë është forcuar. Imperialistët përgatitin nga jashtë grupe diversantësh, monarko-fashistët nga ana e tyre dhe titistët nga ana tjetër. Italianët nuk mbeten prapa. Plani ynë i tanishëm është të shpartallojmë mbeturinat e banditëve që bredhin në malet tona dhe që ne tashmë u kemi shkaktuar shumë vështirësi, të shkatërrojmë bazat e tyre që janë sidomos kulakët. Pjesa më e madhe e grupimeve reaksionare nëpër qytete është goditur nga Sigurimi i Shtetit tonë që ka korrur shumë suksese. Partia jonë e rregulloi gjendjen në Ministrinë e Brendshme, ish-vatër e titistëve, dhe Sigurimi i Shtetit është bërë një armë shumë e fortë dhe e dashur e Partisë dhe e popullit tonë. Gjeneral Mehmet Shehu është një udhëheqës i lavdishëm dhe në detyrën e tij të vështirë dhe delikate ka ndihmën e vazhdueshme të Partisë e të popullit. Partia i ka vënë vetes si detyrë që çdo ditë të na gjejë me pozita shumë më të forta për t'u bërë ballë dhe për t'i shpartalluar goditjet dhe tentativat që mund të bëjnë armiqtë tanë të shumtë.

Partia jonë forcohet nga dita në ditë - i thashë në vazhdim shokut Stalin - në radhët e Partisë sonë të re ka shumë guxim dhe shumë vullnet. Niveli ideologjik dhe kulturor i punëto rëve të Partisë sonë është i ulët, por ka shumë vullnet për të mësuar. Ne punojmë në këtë drejtim për ta përmirësuar këtë gjendje. Kemi ende shumë të meta në punën tonë të Partisë, por me punë këmbëngulëse, me besim tek e ardhmja dhe me eksperiencën e Partisë Bolshevike do t'i korrigojmë këto të meta.

Në vijim të bisedës, i bëra shokut Stalin një paraqitje të përgjithshme të gjendjes ekonomike në Shqipëri, të rezultateve të arritura dhe të luftës së madhe që kishin bërë e bënë Partia dhe populli për të përballuar vështirësitë e krijuara në ekonomi nga puna armiqësore e trockistëve jugosllavë dhe e agjentëve të tyre. Populli ynë, i thashë, është një popull i thjeshtë e punëtor. Nën udhëheqjen e Partisë ai është mobilizuar për të kapërcyer prapambetjen, vështirësitë e krijuara e për të vënë në jetë detyrat që shtroi Kongresi i 1-rë i Partisë.

Tregova se Kongresi i 1-rë i Partisë, krahas industrializimit socialist, ka orientuar për forcimin e sektorit socialist në bujqësi me anë të shtimit të ndërmarrjeve shtetërore dhe të kolektivizimit gradual në formën e kooperativave bujqësore, të cilat shteti do t'i përkrahë politikisht, ekonomikisht dhe organizativisht.

- Keni krijuar shumë kooperativa të tilla? Ç'kriterë ndiqni? - më pyeti shoku Stalin.

Unë sqarova me këtë rast se Kongresi orientoi që kolektivizimi i bujqësisë të bëhet gradual, i matur dhe në baza vullnetare. Në këtë rrugë ne as do të shpejtohemi, as nuk do të qëndrojmë në vend.

- Sipas mendimit tim - tha shoku Stalin - për sa i përket kolektivizimit të bujqësisë ju nuk duhet të shpejtoheni. Vendi juaj është malor dhe me relief që ndryshon nga zona në zonë. Edhe te ne në zonat malore, të ngjashme me ato të vendit tuaj, i kemi ngritur shumë vonë kolkozet.

Në vazhdim fola rreth punës që bëhet te ne për forcimin e aleancës së klasës punëtore me fshatarësinë punonjëse, për ndihmën që i jep shteti fshatarit individual, për rritjen e prodhimit bujqësor dhe për politikën e grumbullimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale.

- Kjo ka rëndësi shumë të madhe - na tha shoku Stalin - dhe mirë bëni që i kushtoni kujdes. Po të kenë nevojë fshatarët shqiptarë për traktorë, për makina të tjera bujqësore, për kafshë pune, farëra e për çdo gjë, i ndihmoni. Jo vetëm kaq, vazhdoi ai, por edhe kanale të bëni për fshatarësinë dhe do të shihni pastaj se ç'do të bëjë ajo. Detyrimet që ka fshatari ndaj shtetit për ndihmat e mësipërme, sipas mendimit tim, është mirë t'i japë në natyrë.

Shteti - vazhdoi shoku Stalin - duhet të ngrejë stacione makinash dhe traktorësh. Traktorët nuk duhet t'ua jepni kooperativave, por shteti t'i ndihmojë edhe fshatarët individualë për të punuar tokën, në rast se ata do ta kërkojnë këtë ndihmë. Kështu fshatarët e varfër do të fillojnë ta ndiejnë pak nga pak nevojën e kolektivizimit.

Për sa u përket tepricave të prodhimeve bujqësore - vazhdoi më tej shoku Stalin - këto bujqit mund t'i disponojnë si të dëshirojnë, pse, po të veprohet ndryshe, fshatarët nuk do të bashkëpunojnë me qeverinë. Po nuk e pa fshatarësia konkretë~sht ndihmën e shtetit, as ajo nuk e ndihmon shtetin.

Nuk e njoh historinë e karakteristikat e borgjezisë në vendin tuaj - tha pastaj shoku Stalin dhe pyeti :

- Keni pasur ju borgjezi tregtare?

- Kemi pasur një borgjezi tregtare në formim e sipër, i thashë, por tani ajo s'ka gjë në dorë.

- I keni shpronësuar krejt? - më pyeti.

Në përgjigje të pyetjes unë i fola shokut Stalin mbi politikën që kishte ndjekur Partia që gjatë luftës në lidhje me klasat e pasura, për diferencimin e madh që kishte ndodhur nga qëndrimi i elementëve të këtyre klasave ndaj pushtuesit të huaj, për faktin që shumica e tyre qenë bërë bashkëpunëtorë të fashizmit dhe, gasi kishin lyer duart me gjakun e popullit, këta ose u arratisën bashkë me pushtuesit, ose, ata që s'arritën të largoheshin, populli i kapi dhe ia dha gjyqit. Për sa u përket atyre elementëve, kryesisht të borgjezisë së mesme e të vogël patriotike, që u lidhën me popullin në luftë dhe iu kundërvunë pushtuesit të huaj, vazhdova më tej, Partia i përkrahu, i mbajti afër dhe u tregoi rrugën e vërtetë për t'i shërbyer zhvillimit të vendit dhe forcimit të pavarësisë së atdheut. Ndaj një pjese të këtyre elementëve si dhe ndaj disa intelektualëve patriotë, vitet e fundit - i thashë shokut Stalin, - si rezultat i veprimtarisë armiqësore të Koçi Xoxës me shokë, janë mbajtur qëndrime jo të drejta e janë marrë masa të ashpra, por këto gabime Partia tani i ka goditur me forcë dhe s'do të lejojë të përsëriten më.

Duke marrë fjalën, shoku Stalin tha se si për çdo problem tjetër edhe për këtë, gjithçka varet nga kushtet konkrete e situata konkrete e çdo vendi. - Por mendoj, theksoi ai, se në fazën e parë të revolucionit ndaj borgjezisë patriote që e do me të vërtetë pavarësinë e vendit, ndiqet një politikë e tillë, që ajo të ndihmojë në këtë fazë me mjetet e pasuritë që disponon.

Lenini na mëson - vazhdoi ai - se në periudhën e parë të revolucionit, atje ku ky revolucion ka karakter antiimperialist, komunistët mund të shfrytëzojnë ndihmën e borgjezisë patriote. Natyrisht, kjo varet nga kushtet konkrete, nga qëndrimi i vetë kësaj borgjezie ndaj problemeve më të mprehta që kalon vendi etj.

Në vendet e demokracisë popullore, për me pushtuesit gjermanë dhe i ka ndihmuar këta. Kur ushtria sovjetike i çliroi këto vende, borgjezia e shitur mori rrugën e mërgimit.

Në këtë çast ai u mendua pak dhe tha:

- Më duket ushtria sovjetike nuk erdhi për ndihmë në Shqipëri, po ushtria jugosllave ka ardhur për ndihmë te ju gjatë kohës së Luftës Nacionalçlirimtare?

- Jo - iu përgjigja unë. - Ushtria jonë Nacionalçlirimtare me dy divizione partizane vajti e luftoi në tokat jugosllave në ndihmë për glirimin e popujve të Jugosllavisë.

Në vazhdim të fjalës së tij shoku Stalin theksoi se nga ana e çdo partie komuniste dhe shteti socialist një kujdes i veçantë duhet treguar, gjithashtu, në marrëdhëniet me intelektualët. Me ta duhet punuar shumë, me kujdes e largpamësi, me qëllim që intelektualët e ndershëm e patriotë të afrohen sa më tepër me pushtetin popullor.

Shoku Stalin, dulce përmendur disa tipare të veganta të revolucionit rus, theksoi se aso kohe Rusia nuk ndodhej nën zgjedhën e ndonjë fuqie të huaj imperialiste, prandaj ne ishim ngritur vetëm kundër shfrytëzuesve brenda vendit dhe borgjezia nacionale ruse, si shfrytëzuese që ishte, nuk u pajtua me revolucionin tonë. Te ne u zhvillua një luftë e ashpër prej disa vjetësh dhe borgjezia ruse kërkoi ndihmën e ndërhyrjen e imperialistëve.

Kështu, pra, shihet quartë se ka një ndryshim midis revolucionit rus dhe luftës që zhvillidhet në ato vende, të cilat janë bërë viktimë e agre'sorëve imperialistë.

- Unë i them këto, vazhdoi Stalini, për të treguar se sa rëndësi ka mbajtja parasysh E kushteve konkrete të secilit vend, pse kushtet e një vendi nuk janë kurdoherë të barabarta rne ato të vendeve të tjera. Pikërisht për këtë askush nuk duhet të kopjojë eksperiencën tonë ose të të tjerëve, por vetëm ta studiojë e të përfitojë riga kjo eksperiencë, duke e zbatuar sipas kushteve konkrete të vendit të vet.

Deri në këtë kohë në takimin me Stalinin kishte kaluar, pa u ndier mbi një orë. Fjalën e mora përsëri unë dhe fillova të shtroja problemet e planit për forcimin e mbrojtjes e zhvillimin e ekonomisë e të kulturës në RPSH.

- Shefi i shtatmadhorisë suaj, - më tea shoku Stalin, - na ka drejtuar disa kërkesa per ushtrinë. Dhamë urdhër t'ju plotësohen të gjitha. I keni marrë ato që kërkuat?

- Akoma nuk kemi marrë ndonjë laim për këtë gjë - i thashë unë.

Në këtë moment Stalini thërret një gjeneral dhe e ngarkon të marrë informata të sakta nfi këtë çështje. Pas pak minutash u dëgjua zilja e telefonit. Stalini ngriti receptorin dhe, pasi dëgjoji çfarë iu tha, më njoftoi se mallrat janë në udhëtim.

- Po shinat i morët? - më pyeti. - Mbaroi hekurudha?

- I kemi marrë, i thashë, dhe hekurudhën e inauguroam - e vazhdova t'i parashtroj në përgjithësi detyrat kryesore të planit të zhvillimit ekonomik, kulturor e të mbrojtjes së vendit. Me këtë rast parashtrova edhe kërkesat tona për ndihmë nga Bashkimi Sovjetik.

Si edhe më parë, shoku Stalin kërkesat tona për ndihma i priti me simpati dhe na foli fare hapur:

- Shokë, na tha, ne jemi një vend i madh, por ju e dini se akoma s'i kemi zhdukur të gjitha pasojat e rënda të luftës. Sidoqoftë ne do t'ju ndihmojmë sot e në të ardhmen, mbase jo dhe aq shumë, por me ato mundësi që kemi. Ne e kuptojmë se ju duhet të krijoni e të zhvilloni sektorin e industrisë socialiste dhe në këtë drejtim ne jemi dakord t'ju plotësojmë të gjitha kërkesat që na keni paraqitur, ashtu si edhe ato për bujqësinë.

Pastaj, duke qeshur, vazhdoi:

- Po vetë shqiptarët do të punojnë vallë?

E kuptova pse ma bëri këtë pyetje. Ishte rezultat i informimit keqdashës të tregtarit armen Mikojan. i cili në një takim që pata pasur e të, më foli me një gjuhë që jo vetëm ishte larg nga aio e Stalinit, por përdori terma të ashp.á në vërejtjet e tij mbi realizimin e planeve në vendin tonë, se gjoja populli nuk punon etj.

Qëllimi i tij ishte të ulte ritmet e sasinë e ndihmave. Ky ka qenë kurdoherë qëndrimi i Mikojanit. Por Stalini na i akordoi të gjitha sa kërkoni.

- Ne, tha ai, do t'ju dërgojmë edhe kuadrot që na keni kërkuar dhe ata nuk do të kursehen t'ju ndihmojnë me të gjitha forcat, por, dihet, ata nuk do të rrinë përgjithnjë në Shqipëri. Prandaj, shokë, ju duhet të përgatitni kuadrot tuaj, specialistët tuaj që t'i zëvendësojnë tanët. Kjo çështje është e rëndësishme. Sado kuadro të huaj t'ju vijnë, ju prapëseprapë do të keni nevojë të keni kuadrot tuaj. Prandaj, shokë - na këshilloi ai - ju duhet të hapni universitetin tuaj, i cili do të jetë një qendër e madhe për përgatitjen e kuadrove të ardhshëm.

- Kemi hapur institutet e para - i thashë shokut Stalin - dhe në to puna po ecën, por jemi akoma në fillim. Veç përvojës e teksteve, na mungojnë edhe kuadrot e nevojshëm për hapjen e universitetit.

- Kryesorja është të niset puna - na tha ai - mandej hap pas hapi gjithçka do të plotësohet. Ne, nga ana jonë, do t'ju ndihmojmë edhe me literaturë edhe me specialistë, me qëllim që të shtohet numri i instituteve të larta, të cilat janë baza për krijimin në të ardhmen të universitetit.

Specialistët sovjetikë - na tha më tej shoku Stalin - do të paguhen nga Qeveria Shqiptare njëlloj si edhe specialistët shqiptarë. Asnjë favor më shumë se specialistëve tuaj mos u bëni atyre.

- Specialistët sovjetikë vijnë nga larg iu përgjigja unë - dhe ne nuk mund t'i trajtojmë njëlloj si tanët. Shoku Stalin menjëherë më kundërshtoi:

- Jo, jo, le të vijnë nga Azerbajxhani ose nga çdo anë tjetër e Bashkimit Sovjetik. Ne kemi rregullat tona për trajtimin e specialistëve që dërgojmë në ndihmë të popujve vëllezër. Ata e kanë për detyrë të punojnë me të gjitha forcat, si revolucionarë internacianalistë, të punojnë për të mirën e Shqipërisë njëlloj si për të mirën e Bashkimit Sovjetik. Diferencën e nevojshme të pagës merr përsipër t'ua paguajë Qeveria Sovjetike.

Pasi e falënderova shokun Stalin, unë ngrita çështjen e ekipeve që na nevojiteshin për studimet gjeologjike, hidroeletrike, për ndërtimin e hekurudhave dhe për një sërë problemesh të perspektivës së zhvillimit tonë industrial. Ai, pasi iu përgjigj pozitivisht çështjeve që ngrita unë, më drejtoi një tok pyetjesh: A keni shumë lumenj masivë për ndërtim hidrocentralesh? Ka shumë qymyr në Shqipëri? etj.

Iu përgjigja shokut Stalin dhe pastaj e pyeta nëse mund të dërgojmë në Bashkimin Sovjetik një numër kuadros që të specializohen për disa nevoja të domosdoshme e urgjente të vendit. Në pamundësi, i thashë, atëherë të na dërgohen në Shqipëri disa specialistë nga Bashkimi Sovjetik që të na i përgatitin kuadrot tanë në vend.

Shoku Stalin më tha:

- Në këtë drejtim është më mirë të dërgojmë ne disa instruktorë në Shqipëri, pse po të vijnë njerëzit tuaj në Bashkimin Sovjetik, do të nevojitet një kohë më e gjatë për përgatitjen e tyre, mbasi duhet të mësojnë gjuhën ruse etj.

Për këtë kërkesë shoku Stalin na rekomandoi t'i drejtohem Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bashkimit Sovjetik dhe shtoi:

- Nga ana jonë është ngarkuar shoku Vislinski që të drejtojë të gjitha bisedimet, prandaj gdo kërkesë ia paraqitni atij.

I thashë shokut Stalin se në vija të përgjithshme këto qenë gështjet, që desha të diskutoja rreth të lidhje me gjendjen e brendshme në Shqipëri dhe i shpreha dëshirën që t'i bëj shkurtimisht një ekspozitë mbi pozitat politike të Shqipërisë në lidhje me gjendjen ndërkombëtare. Ai shikoi orën dhe më pyeti:

- Ju mjaftojnë njëzet minuta?

- Diçka më gjatë shoku Stalin, po pati mundësi - iu përgjigja dhe vura re se kishin kaluar një orë e gjysmë në bisedim me të.

Si shpjegova gjendjen e nderë të marrëdhënieve tona me Jugosllavinë, veprimtarinë armiqësore të tradhtarëve jugosllavë, organizimin prej tyre të bandave kriminale dhe futjen e këtyre banda ve në tokën shqiptare për veprimtari diversioniste e sabotuese kundër vendit tonë, i foli shokut Stalin për politikën e terrorit të egër që ndjek klika e Titos ndaj shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë e Malit të Zi.

- Jetojnë shumë shqiptarë në Jugosllavi? më pyeti Stalini. - Çfzirë besimi fetar kanë?

- Më tepër se një milion shqiptarë - i thashë. (Vishinski në këtë çast shprehu habinë e tij për këtë numër kaq të madh, që, me sa duket, nuk e kishte dëgjuar më parë), dhe vazhdova: Thuajse të gjithë janë të fesë myslimane.

- Si nuk janë ahyimiluar nga sllavët dhe ç'lidhje mbajnë shqiptarët me banim në Jugosllavi me ata në Shqipëri? -- pyeti përsëri Stalini.

- Shqiptarët që banojnë në Jugosllavi i thashë shokut Stalin bë përgjigje të pyetjes së tij - në të gjitha kohërat janë shquar për patriotizmin e zjarrtë dhe lidhjet e fuqishme me atdheun dhe me bashkatdhetarët e tvre. Ata kur doherë u janë kundërvënë me forcë përpjekjeve të ethshme ekspansionis, le e asimiluese të reaksionarëve serbomëdhenj e sllavomëdhenj dhe kanë ruajtur me fanatizëm identitetin e tvre shqiptar në çdo pikëpamje.

Aktualisht, klika e Titos ndjek në Kosovë dhe në viset me popullsi shqiptare në Mal të Zi e Maqedoni të njëjtën vjër, dhe të njëjtat metoda që kanë përdorur të ngjashmit e tyre, car Aleksandri e të tjerët në kohën e kaluar. Për klikën e Beogradit, Kosova është një pikë shumë e dobët, prandaj ajo ushtron në Kosovë një terror të madh, largime në masë, arrestime dhe punë të detyruar, rekrutime në ushtri me forcë si dhe shpronësime të rëndësishme të madh njerëzish. Elementi shqiptar goditet posaçërisht në Jugosllavinë titiste, sepse udhëheqësit e tanishëm jugosllavë i njohin mirë tiparet patriotike e revolucionare të popullsisë shqiptare të atjeshme, e dinë mirë se për këtë popullsi problemi nacional gjithmonë ka qenë dhe mbetet një plagë e hapët që kërkon shërim. Përveç kësaj, Kosova dhe viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi janë bërë prej titistëve qendra të rëndësishme grumbullimi të kuislingëve shqiptarë, të banditëve, të spiunëve që, të instruktuar nga njerëzit e UDB-së, përgatitin kundër vendit tonë akte terroriste, diversioniste, sabotuese dhe sulme të armatosura. Klika e Beogradit ka vënë në lëvizje agjentë të vjetër serbë, anglezë dhe amerikanë si dhe agjentë italianë dhe gjermanë, për të móbilizuar reaksionin shqiptar të Kosovës dhe për të organizuar me këtë reaksion detashmente, të cilat, së bashku me banditët e tjerë shqiptarë, të hyjnë në territorin tonë dhe të shkaktojnë turbullira.

Pastaj, në mënyrë të përmbledhur i fola shokut Stalin për luftën e popullit grek kundër monarko-fashistëve dhe anglo-amerikanëve, për përkrahjen politike që i jepnim në kësaj lufte të drejtë të popullit vëlla grek dhe, midis të tjerash, vura në dukje se Ushtria Demokratike Greke qëndron larg popullit.

Shoku Stalin u habit kur i dëgjoi këto fjalë dhe më pyeti:

- Si, si the?!

Unë dhashë sqarime të plota si për këtë problem ashtu edhe për pikëpamjet e gabuara të Niko Zahariadhisit me shokë mbi rolin e partisë e të komisarit në ushtri, në qeveri etj.

- Ne mendojmë - i thashë ndër të tjera shokut Stalin - se udhëheqja e Partisë Komuniste Greke qysh gjatë kohës së luftës kundër hitlerianëve ka gabuar rëndë në lindhje me forcimin dhe me zgjerimin e Partisë në fshat e në qytet, dhe se këto gabime u rishfaqën edhe gjatë luftës kundër reaksionit të brendshëm e ndërhyrjes anglo-amerikane.

Duke menduar gabim se qyteti do të luante rolin vendimtar në fitoren rube hitlerianët dhe rube reaksionin e brendshëm, udhëheqja e Siantosit* *(Ish-sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste Greke, oportunist e kapitullues para reaksionit anglo-amerikan.) në vitet e luftës antifashiste urdhëroi që proletariati grek të qëndronte në qytete. Kjo bëri që pjesa më revolucionare e popullit grek të mbetej e ekspozuar para goditjes së egër të hitlerianëve të brendshëm, ndërsa Ushtria Partizane Nacionalçlirimtare Greke u privua nga proletariati, i cili duhej të ishte motori dhe udhëheqja e revolucionit popullor grek. Më poshtë theksova se me gjithë terrorin e madh dhe goditjet e rënda që hitlerianët dhe reaksioni i brendshëm bënë kundër proletariatit dhe elementit revolucionar në qytet, këta të fundit, në përgjithësi, vazhduan të qëndronin në qytete, ku u vranë, u torturuan, u kapën dhe u internuan në ishuj, dhe nuk morën në masë rrugën e malit, pse direktiva e Partisë Komuniste Greke e tillë ka qenë. Sigurisht, ndër qytete ka pasur edhe atëherë aksione të rëndësishme dhe luftë, si sabotazhe, atentate etj., por këto veprime, në kuadrin e përgjithshëm të luftës së popullit grek, kishin një rëndësi të dorës së dytë.

Dobësi të tilla, theksova më tej, u vërejtën edhe në fshat ku shtrirja e partisë ka qenë e paktë, dhe organizimi i organizatave të partisë ka qenë i dobët dhe i shthurur, shpesh janë konfunduar organizatat e partisë me organizatat e EAM-it, ka pasur oportunitet si në organizimin, ashtu edhe në vijën politike të këshillave nacionalçlirimtarë të fshatit, dualiteti pushtet dhe bashkëjetesë me organizatat reaksionare zerviste etj.. në zonat e çliruara e gjetkë. Ne u kemi thënë shokëve grekë se vënia prej tyre e komandës së Ushtrisë Nacionalçlirimtare nën urdhrat e Shtabit të Mesdheut. bisedimet e marrëveshjet me karakter oportunist e kapitullues me Zervën e me qeverinë reaksionare greke në mërgim, dominimi në udhëheqjen e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Greke i elementit fshatar dhe i oficerëve të vjetër të karrierës. e të tjera, qenë gabime të rënda që do ta çonin luftën heroike të popullit grek drejt disfatës. Varkiza ka qenë konkluzioni logjik i gjithë këtyre veprimeve e

pikëpamjeve jo të drejta, ajo solli kapitullimin përpara reaksionit anglez dhe reaksionit të brendshëm.

Por edhe pas marrëveshjes kapitulluese të Varkizës e periudhës së «legalitetit» të Partisë Komuniste Greke, i thashë shokut Stalin, ne mendojmë se udhëheqja e Partisë Komuniste Greke nuk u thellua sa duhet e si duhet për t'i ndrequr gabimet e mëparshme rrënjësisht. Forcimi i Partisë në qytet dhe në fshat, lidhjet e shëndosha me masat e gjera të popullit duhej të ishin preokupacioni i parë i udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke, sepse në të kaluarën këto qenë ndër gabimet e saj më të mëdha. Këtë gjë ajo nuk e bëri, sepse nuk e vlerësoi drejt gjendjen e re të krijuar pas disfatës së fashizmit, nënvleftësoi armikun e brendshëm dhe reaksionin anglo-amerikan dhe nuk mundi të parashikonte ashtu si duhet rrezikun e madh që do të vinte nga këto forca të reaksionit. Ajo shpreste shumë te puna «legale» dhe parlamentarizmi. Si rezultat, partia u çarmatosi përpara armikut, humbi lidhjet e shëndosha me popullin, revolucioni popullor në Greqi kalonte nga një krizë e madhe, iu dha popullit përshtypja se revolucioni do të fitonte në rrugën e parlamentarizmit dhe të votimeve dhe ai para grushtit të reaksionit u gjend i dizorientuar, i habitur, i dëshpëruar. Populli grek luftoi me heroizëm kundër hitlerianëve për të fituar lirinë, po fitorja i shpëtoi nga duart për shkak të gabirneve të udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke.

Të gjitha këto gabime patën konsekuenca të rënda në zhvillimin e mëpastajmë të ngjarjeve, kur mbaroi gdo iluzion për fitoren në rrugë legale dhe partia u hodh në ilegalitet e vendosi të rifillonte luftën.

Fakti është - i thashë më tej shokut Stalin - se para hedhjes në ilegalitet partia mundi të rigrupojë një pjesë të forcave partizane, t'i nxjerrë në mal dhe të rifillojë luftën. Kjo ishte një gjë shumë e mirë. Por ne mendojmë se pikërisht këtu rifillojnë pikëpamjet e gabuara të shokëve udhëheqës grekë për sa u përket strategjisë dhe taktikës që duhej të përdornin, organizimit të partisë në qytet dhe në fshat, organizimit të partisë në ushtri e, në radhë të parë, lidhjeve me masat dhe rolin udhëheqës të partisë.

Shokët e udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke i nënvleftësuan forcat e armikut dhe menduan se do ta merrnin lehtë në dorë pushtetin, se do ta qlironin Greqinë lehtë nga anglo-amerikanët dhe monarko-fashistët. Kjo pikëpamje e gabuar bëri që ata të mos përgatiteshin për një luftë të gjatë e të zorshme, ta nënvleftësonin luftën dhe, rigrupmin e forcave partizathyente dhe t'i asgjësonte me superioritetin e tij në njerëz dhe në armatime.

Duke përfutur nga ky gabim i rëndë i udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke, monarko-fashistët ia rrëmbyen popullin Ushtrisë Demokratike Greke, ia shkëputën bazën mëmë Partisë Komuniste Greke. Monarko-fashizmi me terror e me vrasje shpërnguli banorët nga të gjitha zonat ku ishte vendosur pjesa më e madhe dhe më e gjallë e Ushtrisë Demokratike Greke jo për të sulmuar, por për t'u mbrojtur. Ne këtë e quajmë një gabim fatal. Fashizmi edhe te ne, në Luftën Nacionalçlirimtare, i thashë shokut Stalin, vrau, masakroi popullatën, dogji krahina të tëra, por populli nuk shkoi në kampe me tela me gjemba, por u hodh në mal, luftoi, u rikthye në kasollen e tij dhe qëndroi atje me vendosmëri, pse Partia jonë i thoshte të luftonte dhe të qëndronte. Ushtria jonë Nacionalçlirimtare kurrë nuk u nda nga populli pse vetë Partia jonë bazat e saj të shëndosha i kishte në popull. Ne mendojmë se, nga shkakun që Partia Komuniste Greke nuk kishte baza të shëndosha në popull, u arrit që armiku t'i lërë partizanët grekë në vetmi në malet e thata. Për këtë unë thashë se udhëheqja e Partisë Komuniste Greke e privoi veten dhe Ushtrinë Demokratike nga baza mëmë e saj, nga populli.

Më në fund, i përmenda shokut Stalin kërcënimet që i bëhen Shqipërisë nga armiqtë e jashtëm.

Ai më dëgjoi me vëmendje dhe shfaqti mendimin e tij lidhur me sa ngrita unë:

- Për luftën e popullit grek - tha ndër të tjera ai - edhe ne gjithmonë e kemi quajtur një luftë të drejtë, e kemi përkrahur dhe e kemi mbështetur me gjithë zemër. Çdo luftë popullore nuk bëhet vetëm nga komunistët, por nga populli dhe rëndësi ka që komunistët të jenë në krye të saj. Caldarisi, nuk i ka punët mirë dhe përpiqet të shpëtojë me anën e anglo-amerikanëve.

Për sa u përket britmave që bëjnë armiqtë e jashtëm për ndarjen e Shqipërisë, vazhdoi ai, ato bëhen sa për t'ju futur frikën, se në këtë drejtim unë mendoj se, aktualisht, nuk ka ndonjë rrezik. Kjo nuk

ndodh nga «dashmirësia» e armiqve, por për një sërë arsyesh. Në radhë të parë, Shqipëria është një vend i lirë, i pavarur, populli atje ka marrë fuqinë dhe do të dijë ta mbrojë pavarësinë e vet, ashtu siç edhe diti ta fitonte. Së dyti, vetë armiqtë e jashtëm kanë kontradikta me njëri-tjetrin në lidhje me Shqipërinë. Asnjëri nga armiqtë nuk do që Shqipëria të jetë vetëm e njërit ose e tjetrit. Në rast se është Greqia ajo që dëshiron ta ketë Shqipërinë të vetën, kjo gjë nuk u leverdis Italisë e Jugosllavisë, që bëhen pengesë e kështu me radhë. Nga ana tjetër, theksoi shoku Stalin, pavarësia e Shqipërisë është njohur dhe është konfirmuar nga deklaratat e tre të mëdhenjve - Bashkimit Sovjetik, Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Mund të shkelet kjo deklaratë, por nuk është kaq lehtë. Pra, sidoqoftë, Shqipëria e ka të mbrojtur pavarësinë e vet.

Shoku Stalin përsëriti disa herë që po që se Qeveria Shqiptare do të bëjë një politikë të matur, të zgjuar, largpamëse, atëherë punët e saj do të shkojnë mirë.

Në vazhdim shoku Stalin më këshilloi:

- Ju duhet të shihni mundësitë për të hyrë në marrëdhënie edhe me Italinë, se e keni shtet fqinj, por më përpara të merrni masa për t'u rribrojtur riga veprimtaria e fashistëve italianë.

Duke folur për rëndësinë që ka njohja e vendit tonë në arenën ndërkombëtare më pyeti:

- Cili shtet tjetër troket në portat tuaja për të lidhur marrëdhënie diplomatike? Si i keni marrëdhëniet me francezët?

- Me francezët, sqarova, kemi marrëdhënie diplomatike. Ata kanë përfaqësinë e tyre në Tiranë dhe ne kemi tonën në Paris.

- Po me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Anglinë?

- Nuk kemi marrëdhënie diplomatike - iu përgjigja. - Shtetet e Bashkuara të Amerikës qysh në vitin 1945 ria kanë vënë si kusht për lidhjen e këtyre marrëdhënieve njohjen si të vlefshme të të gjitha marrëveshjeve që ata kanë pasur me qeverinë antipopullore të Zogut. Këto marrëveshje ne nuk mund t'i pranojmë si të ligjshme, sepse kanë karakter skllavërues, dhe këtë gjë e ka ndaluar shprehimisht Kongresi i Përmetit. Anglezët, riga aria e tyre, vazhdova, duan të kenë baza ushtarake në portet tona, pa të ria njohin. Për realizimin e këtyre synimeve ata janë përpjekur prej kohësh.

Në kohën kur ne i kishim asgjësuar forcat naziste dhe kishim çliruar pothuajse gjithë vendin, anglezët nëpërmjet disa misioneve ushtarake që kishin te ne dhe nën maskën e aleatëve të lizftës antifashiste, kërkuan me insistim që, së toku, si «aleatë», të asgjësonim me një komando të tyre një garnizon gjerman që qëndronte në Sarandë, porti ynë në Jug. Ne e pranuan kërkesën e tyre me kusht që, me të mbaruar operacioni, të ktheheshin menjëherë andej riga vinin, riga deti. Operacioni mbaroi dhe anglezët jo vetëm donin të qëndronin aty, por synonin të futeshin edhe në thellësi të vendit.

Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u dha ultimatum që ata të largoheshin menjëherë, se përndryshe do t'i hidhnim në det me luftë. Pas ultimatumit tonë anglezët hipën në anijet e tyre dhe u kthyen në Greqi. Por riga synimet e tyre ata nuk kanë hequr dorë.

- Shikoni si të jetë më mirë në interes të vendit tuaj - tha Stalini dhe vazhdoi:

- Sa për bazat, që kërkohen të kenë anglezët në portet tuaja, në asnjë mënyrë mos granoni. T'i ruani mirë portet tuaja.

- Ne nuk do t'i lëshojmë kurrë dhe askujt!

i thashë unë. - Po të vijë puna ne do të vdesim e ato s'i lëshojmë.

- T'i ruani dhe të mos vdisni - tha shoku Stalin duke qeshur. - Këtu duhet diplomaci.

Pas kësaj u ngrit, na përshëndeti me radhë dhe u largua. Ora ishte 00.15'.

U takuam përsëri pas dica ditësh në një darkë që u shtrua në Kremlin për nder të delegacionit tonë. Shoku Stalin, unë dhe të tjerët ishim ulur rreth tryezës. Edhe në këtë darkë, si në të gjitha takimet e tjera me të, na bënë përshtypje dhe na emocionuan dashuria e madhe e Stalinit për vendin e për popullin tonë, interesimi i tij për të mësuar sa më shumë rreth historisë, kulturës, gjuhës, zakoneve të popullit tonë.

Ai e nisi bisedën duke më pyetur për disa fjalë të gjuhës shqipe:

- Dua të dëgjoj, më tha, si tingëllojnë shqip fjalët: popull, njeri, bukë, dhuratë, grua, burrë, tokë?!

Unë nisa t'i shqiptoja në gjuhën shqipe këta fjalë dhe ai më dëgjonte krejtësisht i përqendruar. Mbaj mend, se për njëri nga fjalët u krijua një situatë humori. Më kishte pyetur se si i thonë-- shqip fjalës ruse «dar».

- Peshqesh! - i thashë unë aty për aty.

- Jo, tha, jo! Peshqesh nuk është shqip, por turqisht - dhe qeshi. Kishte një të qeshur shumë të çiltër, të sinqertë, e qeshur që i dilte nga zemra.

Duke dëgjuar shqiptimin e fjalëve të mia në gjuhën shqipe, shoku Stalin më tha:

- Gjuha juaj është mjaft e vjetër, ajo me anë të të folurit është trashëguar nga njëri brez te tjetri. Edhe ky është një fakt që tregon qëndrueshmërinë e popullit tuaj, forcën e tij të madhe për t° mos u asimiluar me gjithë rrebeshet që ka kaluar.

Lidhur me këto probleme, ai më pyeti:

- Cila është përbëria nacionale e popullit shqiptar? Ka pakica kombëtare serbe e kroate në Shqipëri?

- Shumica dërrmuese e popullit tonë, i thashë, përbëhet nga shqiptarët, por ka dhe një pakicë të kombësisë greke, (afërsisht 28 mijë veta) dhe fare pak maqedonas, (gjithsej pesë fshatra të ;o!zla), kurse serbë e kroatë nuk ka.

- Sa besime fetare ka në Shqipëri - pyeti .më te-shoku Stalin - dhe ç'gjuhë flitet?

- Në Shqipëri, u përgjigja unë, ka tri besime fetare: mysliman. ortodoks dhe katolik. Popullsia që kultivon këto tri besime është e të njëjtit komb, shqiptare, prandaj edhe gjuha që përdoret është vetëm shqipja, me përjashtim të pakicës kombëtare greke që flet gjuhën e saj amtare.

Gjatë kohës që flisja, Stalini herë pas here nxirrte llullën e tij dhe e mbushte me duhan. Vura re se nuk përdorte ndonjë duhan të veçantë, por mente cigare «Kazbek», i shkoqte, e hiqte letrën, ndërsa duhanin e hidhte në llullë. Pasi dëgjoi përgjigjen time, më tha:

- Ju jeni një popull i veçantë, sikurse janë edhe persianët e arabët, që kanë të njëjtën fe me turqit. Par aardhësit tuaj kanë ekzistuar para romakëve dhe turqve. Çështja e fesë s'ka të bëjë me kombësinë dhe shtetësinë.

Dhe ndërsa vazhdonim të bisedonim, më pyeti

- Ju, shoku Enver, e hani mishin e derrit?

- Po ! - i thashë.

- Feja myslimane ua ndalon këtë gjë besimtarëve të saj - tha ai - zakoni i vjetër që i ka ikur koha. Sidoqoftë, vazhdoi, çështja e besimeve fetare duhet pasur mirë parasysh, duhet vepruar me shumë kujdes, se nuk mund të merren nëpër këmbë ndjenjat fetare të popullit. Këto ndjenja janë kultivuar prej shekujsh në njerëzit dhe duhet vepruar me shumë maturi se ky qëndrim ka vlerë për kampaktësinë dhe unitetin e popullit.

Gjithë darka kaloi në një atmosferë shumë të ngrohtë, shumë shoqërore. Shoku Stalin, pasi ngriti një dollë për ushtrinë shqiptare dhe ushtrinë sovjetike më hapi përsëri çështjen e luftës së popullit grek. Fliste me simpati të thellë për popullin trim e liridashës grek, për heroizmat, për sakrificat dhe për gjakun që derdhte në luftën e tij të drejtë.

- Edhe ne, edhe ju, gjithë revolucionarët dhe popujt jemi me luftën e drejtë të popullit grek, me kërkesat e tij për liri e demokraci. Mbështetja dhe përkrahja jonë ideologjike dhe politike atyre s'do t'u mungojnë kurrë - tha midis të tjerash shoku Stalin. - Ju, vazhdoi ai, që jeni në kufi me Greqinë, në mënyrë të veçantë duhet të keni kujdes e të jeni vigjilentë për të përballuar çdo provokacion të monarko-fashistëve kundër vendit tuaj.

Gjatë darkës u ngritën dollë për të gjithë shokët me radhë. U ngrit dollë edhe për Omer Nishanin*. *(Në atë kohë President i Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH.)

Molotovi, duke ngritur herë pas here gotën më nxiste të pija më shumë dhe, kur pa se unë s'po ia plotësoja dëshirën, më pyeti:

- Pse kaq pak?! Ju mbrëmë pitë më shumë!

- Ah, mbrëmë! Mbrëmë ishte ndryshe puna - i thashë, duke qeshur.

Molotovi atë çast iu drejtua shokut Stalin:

- Mbrëmë, tha, isha në darkë me shokun Enver të Vishinski. Na erdhi lajmi se dje më 31 mars Enver Hoxhës në Tiranë i lindi djalë. Nga gëzimi pimë diçka më tepër.

- Urime! - më tha atë çast Stalini dhe më drejtoi goo-tën. - Le të pimë një shëndet për djalin e vogël dhe shoqen tuaj !

E falënderova shokun Stalin, duke i uruar shëndet e jetë të gjatë për të mirën e Partisë Bolshevike e të shtetit sovjetik, për të mirën e revolucionit e të marksizëm-leninizmit.

Kaluam disa orë në këtë ambient kaq të ngrohtë, të përzemërt familjar. Si mua ashtu edhe gjithë shokëve tanë na kanë mbetur të pashlyera në kujtesë sjelljet dhe tiparet e Stalinit të lavdishëm, e atij njeriu emri dhe vepra e të cilit u futnin dridhmën armiqve imperialistë, fashistë, trockistë, reaksionarëve të çdo ngjyre, kurse komunistëve, proletarëve, popujve u ngjallnin gëzim e entuziazëm, u shtonin besimin dhe forcat tek e ardhmja.

Gjatë gjithë darkës ai ishte me humor shumë të mirë, i gëzuar, i qeshur, tepër i vëmendshëm në bisedat e lira që bënim dhe përpiquej që gjithë të pranishmit ta ndienin veten sa më të lirshëm. Rreth orës 23 të darkës Stalini na propozoi:

- Shkojmë pimë nga një kafe?

U ngritëm të gjithë dhe shkuam në sallën ngjitur. Ndërsa po na servirej kafeja, në një tavolinë pranë dy shokë sovjetikë, duke qeshur, po mundoheshin ta bindnin Xhafer Spahiun të pinte edhe ca. Xhaferi i kundërshtonte e diçka u thoshte. Stalini, i vëmendshëm, i vuri re, e gjithë shaka iu drejtua shokëve sovjetikë:

- Aa, nuk është e drejtë ` Ju nuk jeni në kushte të barabarta me mikun, jeni dy me një!

Të gjithë qeshëm dhe vazhduam të bisedojmë e të bëjmë shaka si në një rreth të ngushtë familjar. Pastaj Stalini u ngrit përsëri:

- Shokë, na tha, tani ju ftoj të shkojmë në kinema.

U ngritëm të gjithë dhe Stalini na çoi në kinemanë e Kremlinit, ku zgjodhi vetë filmat që pa delegacioni ynë. Ishin disa filma dokumentarë me ngjyra. që paraqitnin pamje nga vende të ndryshme të Bashkimit Sovjetik si dhe filmin «Nusja e largët».

Këtu mbaron edhe vizita jonë e dytë te Stalini.

TAKIMI I TRETE

Nëntor 1949

Takim prej 5 orësh në Suhumi. Bisedë kokë më kokë me shokun Stalin. Edhe një herë për problemin grek. Mbi gjendjen në Jugosllavi pas tradhtisë së Titos. Problemi i Kosovës dhe i viseve të tjera të banuara me shqiptarë në Jugosllavi. «Të sulmohet Shqipëria s'është punë e lehtë». «Në qoftë se Shqipëria do të jetë e fortë nga brenda, ajo nuk ka rrezik nga jashtë». Një darkë e paharruar. Përsëri mbi zhvillimin ekonomik e kulturor të Shqipërisë. Qëndrimi ndaj fesë e klerit. «Vatikani është një qendër reaksioni, vegël në shërbim të kapitalit e reaksionit botëror».

Në nëntor të vitit 1949 shkova në Moskë për të tretën herë. Gjatë udhëtimit për në Bashkimin Sovjetik qëndrova përkohësisht në Budapest, ku u takova me Rakoshin, i cili më priti shumë përzemërsisht dhe u interesua të dinte për gjendjen ekonomike të Shqipërisë, për punën armiqësore të titistëve dhe për luftën e forcave demokratike greke. Biseduam shoqërisht, shkëmbyem një sërë mendimesh dhe ai, me sa mbaj mend, më vuri në dijeni edhe për gjendjen në Hungari.

Para se të mbërrija në Moskë, qëndrova përkohësisht edhe në Kiev. Atje më pritën jashtëzakonisht mirë.

Në Moskë kishin dalë për të më pritur LGvrentievi, mareshal Sokolovski, Orlovi e personalitete të tjera ushtarake dhe civile. Pastaj u takova me Malenkovin, me të cilin bëra bisedimin e parë të shkurtër.

Malenkovi më tha që po të dëshiroja dhe po të kisha mundësi, t'i shkruaja çështjet që kisha ndër mend të shtroja në bisedime, me qëllim që ai ta kishte më lehtë për t'ia transmetuar shokut Stalin.

- Pastaj, më tha, do të presim përgjigjen e shokut Stalin nëse ju, shoku Enver, do të shkoni për të biseduar personalisht me të në qytetin Suhumi, ku ai është me pushime, ose do të bisedoni me ndonjë shok tjetër të udhëheqjes sovjetike, që d.o të rekomandojë Josif Visarionoviçi.

Në mbrëmje i shkrova çështjet që kishim menduar të bisedonim dhe ia dorëzova Malenkovit.

Stalini, pasi u vu në dijeni, porositi që unë të shkoja në Suhumi që të bisedonim së bashku. Kështu vepruam.

U takova me shokun Stalin në kopshtin e shtëpisë ku ai kalonte pushimet; një kopsht i mrekullueshëm, i mbushur me pemë e me bordura lulësh shumëngjyrëshe ndanë rrugëve e rrugicave. E pashë që nga larg tek ecte si zakonisht ngadalë, pakëz i kërrusur përpara dhe me duart prapa.

Si gjithmonë, më priti me shumë përzemërsi dhe u soll shumë shoqërisht. Dukej mjaft mirë me shëndet.

- Tërë ditën bredh jashtë, më tha, vetëm kur ha bukë më sheh dhoma.

I gëzuar që e shihja përsëri dhe që ishte kaq mirë me shëndet, e urova

- Të na rronfi edhe njëqind vjet, shoku Stalin!

- Njëqind? - tha ai me të qeshur, duke :nbyllur pakëz sytë. - Pak janë. Në Gjeorgji kemi pleq që janë 145 vjeç dhe rrojnë akoma.

- Edhe njëqind, shoku Stalin, kështu uron populli ynë, edhe njëqind mbi moshën që keni! i thashë.

- Tak harasho! - tha gjithë humor. - Kështu është mirë, jam dakord. - Qeshëm.

Bisedimet, në të cilat morëm pjesë vetëm sholcu Stalin dhe unë (si dhe përkthyesi ynë Sterjo Gjokoreci), i bëmë jashtë në ballkon. Ishte ora 9 e mbrëmjes me orën e Moskës. Stalini mbante kasketë në kokë, një shall bojë kafe në qafë dhe një palë rroba të leshta gjithashtu bojë kafe.

Kur do të uleshim për të filluar bisedimet, unë, për respekt, e hoqa kapelën dhe e vura në varëse, por ai më tha:

- Mos e hiq, mbaje edhe ti kapelën.

Unë kundërshtova, por ai nguli këmbë ngá meraku se mos ftoheshja ngaqë kishte lagështirë dhe ur dhëroi shoqëruesin e tij që të ma sillte.

Gjatë këtij takimi të paharruar diskutuam me shokun Stalin një sërë problemesh.

Ndër të tjera i parashtrova atij pikëpamjet tona mbi qëndrimet e gabuara të shokëve udhëheqës të Partisë Komuniste Greke dhe akuzat e padrejta që ata na kishin bërë neve. Midis të tjerash, i thashë se Komiteti Qendror i Partisë sonë gjithmonë ka pasur marrëdhënie të ngushta me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Greke, se Partia dhe populli ynë gjithmonë e kanë mbështetur hapur luftën e drejtë dhe heroike të popullit grek për liri e demokraci dhe kundër ndërhyrjes së huaj anglo-amerikane. Për vetë lidhjet e veganta që kemi pasur me shokët grekë ne, veçanërisht gjatë vitit 1949, kemi vënë re gabime e të meta tek udhëheqja e Partisë Komuniste Greke dhe pikëpamjet tona mbi këto gabime disa herë ua kemi shfaqur atyre hapur, në mënyrë shoqërore, me frymë të shëndoshë internacionaliste. Edhe një herë ne ua thamë atyre pikëpamjet tona pas goditjeve që forcat demokratike greke pësuan në Vici e Gramoz. Por shokët udhëheqës të Partisi Komuniste Greke, jo vetëm që as kësaj radhe unë, për respekt, e hoqa kapelën dhe e vura në varëse, por ai më tha:

- Mos e hiq, mbaje edhe ti kapelën.

Unë kundërshtova, por ai nguli këmbë ngá meraku se mos ftoheshja ngaqë kishte lagështirë dhe ur dhëroi shoqëruesin e tij që të ma sillte.

Gjatë këtij takimi të paharruar diskutuam me shokun Stalin një sërë problemesh.

Ndër të tjera i parashtrova atij pikëpamjet tona mbi qëndrimet e gabuara të shokëve udhëheqës të Partisë Komuniste Greke dhe akuzat e padrejta që ata na kishin bërë neve. Midis të tjerash, i thashë

se Komiteti Qendror i Partisë sonë gjithmonë ka pasur marrëdhënie të ngushta me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Greke, se Partia dhe populli ynë gjithmonë e kanë mbështetur hapur luftën e drejtë dhe heroike të popullit grek për liri e demokraci dhe kundër ndërhyrjes së huaj anglo-amerikane. Për vetë lidhjet e veganta që kemi pasur me shokët grekë ne, veçanërisht gjatë vitit 1949, kemi vënë re gabime e të meta tek udhëheqja e Partisë Komuniste Greke dhe pikëpamjet tona mbi këto gabime disa herë ua kemi shfaqur atyre hapur, në mënyrë shoqërore, me frymë të shëndoshë internacionaliste. Edhe një herë ne ua thamë atyre pikëpamjet tona pas goditjeve që forcat demokratike greke pësuan në Vici e Gramoz. Por shokët udhëheqës të Partisë Komuniste Greke, jo vetëm që as kësaj radhe Stalin - ata në fillim na i kanë bërë me gojë e pastaj me shkrim në një letër të tyre të fundit. Kopjen e kësaj letre dhe përgjigjen tonë jua tremi dërguar edhe juve nëpërmjet ambasadorit Cuvahin.

Stalini që nuk i kishte parë këto letra, pasi pyeti për datat e tyre, dha urdhër t'i kërkonin. Mbas pak ia sollën. Kur i lexoi, më tha:

- Unë tram qenë me pushime dhe këto materiale nuk i tram lexuar. Të gjitha letrat tuaja të tjera i tram lexuar.

Grekët kanë kërkuar të bisedojnë dhe të merren vesh me ju - shtoi pastaj ai.

- Për vërejtjet e kritikave që ne u tremi bërë shokëve grekë, i thashë shokut Stalin, jemi nisur kurdoherë nga qëllime të sinqerta e shoqërore, duke e konsideruar këtë një detyrë internacionaliste, pavarësisht nëse mendimet tona do t'u pëlqenin apo jo atyre. Ne kemi dashur dhe jemi përpjekur gjithmonë t'i zgjidhim shoqërisht e nie frymë të shëndoshë komuniste këto çështje me shokët grekë, kurse ata jo vetëm nuk kanë treguar të njëjtën frymë mirëkuptimi nga ana e tyre, por edhe na akuzojnë e përpiqen t'ua hedhin fajin të tjerëve. Të tilla pikëpamje e qëndrime janë të papranueshme për ne, thashë dhe shtova se për punët në Partinë, popullin e atdheun tonë shoku Gahariadhis duhet të ketë parasysh e të mos harrojë se jemi ne vetë përgjegjës para Partisë e popullit shqiptar, sikundër që dhe ai është përgjegjës para partisë e popullit të tij.

Duke më dëgjuar rr vëmendje shoku Stalin më pyeti:

- Kanë mbetur a)ma pjesëtarë nga demokratët grekë që u shuan përkohësisht në Shqipëri? Si treni menda të veproni më pas?

Lidhur me këto pyetje i parashtrova shokut Stalin me hollësi qëndrim tonë. I thashë, midis të tjerash, se imperialistë monarko-fashistët dhe

reaksioni, për qëllime të ktuara, prej kohësh na akuzojnë dulce shpifur scjoja ne «jemi shkakta rret për çka ndodh në Gni», se gjoja ndërhyjmë në punët e brendshme të EXreqisë, e të tjera. Por gjithë bota e di se ne as:emi ndërhyrë e as do të ndërhyjmë kurrë në unët e brendshme të Greqisë.

Për sa i përket përknjes që ne kemi shpre hur e shprehim për luftën popullit grek, këtë gjë e quajmë një të drejtë tël gjshme dhe detyrë që i takon ta kryejë çdo pope karshi luftës së drejtë të një vendi vëlla. Por fai që ne jemi fqinj me Greqinë bëri që shumë burra, gra dhe kalamaj të pafajshëm grekë, të sakasur, të terrorizuar, e të ndjekur këmba-këmbësiga monarko-fashistët, të kalonin kufirin tonë si'efugjatë. Ndash gjithë këtyre, ne mbajtëm një qtdrim shumë të drejtë e të kujdesshëm: i ndihmun, i strehuam, i grumbulluam në qendra të calcara larg kufirit grek.

Në vazhdim të sqarirt të këtij problemi, i thashë shokut Stalin, se për ne ardhja e këtyre refugjatëve krijoi vështirë;të shumta e të mprehta dhe ne u kujdesëm që, përveç kryerjes së detyrës humanitare, të mos linim rast që prania në tokën tonë e refugjatëve demokratë grekë të shërbente për nxitjen e mëtejshme të psikozës antishqiptare në qeveritarët grekë. Ishte kjo një ndër arsytet kryesore që ne e mirëpritëm kërkesën e shokut Zahariadhis dhe të vetë refugjatëve grekë për t'u larguar nga Shqipëria e të strehoheshin në vende të tjera. Aktualisht, shtova, pas qëndrimeve jo të drejta ndaj nesh të shokëve udhëheqës të Partisë Komuniste Greke dhe pas akuzave të rënda që na bëhen, Byroja jonë Politike mendon se është bërë akoma më iminent largimi edhe i atyre pak refugjatëve grekë që kanë mbetur akoma në vendin tonë. I thashë se jo vetëm ushtarët demokratë, por edhe ata udhëheqës grekë, që janë strehuar gjithashtu kohët e fundit në Shqipëri, duhet të largohen.

Në vazhdim të parashtrimit të pikëpamjeve tona në lidhje me problemin grek, i fola shokut Stalin edhe për disa gabime të tjera të shokëve grekë, si nënvleftësimi prej tyre i luftës partizane, të gjatë e

të përhapur në gjithë vendin dhe mbështetja e tyre vetëm të «lufta frontale» me «ushtri të rregullt»; eliminimi prej tyre i rolit të komisarit politik në njësitet partizane etj. Presioni i pikëpamjeve të gabuara mikroborgjeze të komandantëve të karrierës, që nuk donin e nuk duronin të kishin përbri njerëz të besuar të Partisë, i thashë shokut Stalin, bëri që në Ushtrinë Demokratike Greke roli i komisarit në komandë të errësohet, të lihet në plan të dytë, bile të eliminohet fare. Këto e të tjera gabime të tilla na bëjnë të mendojmë se në udhëheqjen e Partisë Komuniste Greke ka konfuzion, ka oportunitizëm, modesti false, ka fshehje të rolit udhëheqës të Partisë.

Pasi më dëgjoi me vëmendje për sa parashtrova shoku Stalin, midis të tjerash, më tha:

- Ashtu si ju edhe ne ramë dakord me kërkesën e Zahariadhisit për largimin e refugjatëve demokratë grekë nga Shqipëria dhe u interesuam e ndihmuam që ata të strehoheshin atje ku dëshirojnë. Këtë e bëmë pse një qëndrim i tillë ishte humanitar. Ndihma për këtë numër njerëzish edhe për ne ishte një barrë, por ata duhet të venin diku, sepse s'mund të qëndronin në një vend kufitar me Greqinë.

Qëndrimi që keni mbajtur ju ndaj ushtarëve demokratë që kapërcyen kufirin tuaj, shtoi shoku Stalin, më duket i drejtë. Sa për armët e tyre që kanë mbetur në Shqipëri, unë jam i mendimit që ato t'i mbani ju, shqiptarët, se i meritoni.

Duket që udhëheqësit e Partisë Komuniste Greke - vazhdoi shoku Stalin - nuk i kanë çmuar si duhet situatat, ata i kanë nënvleftësuar forcat e armikut, duke kujtuar se kishin të bënë vetëm me Caldarin dhe jo edhe me anglezët e me amerikanët. Për tërheqjen e fundit që bënë shokët grekë, ka njerëz që thonë se s'duhet të ritiroheshin, por mendoj se pas atyre që ndodhën, ushtarët demokratë në të vërtetë duhet të ritiroheshin doemos, ndryshe do të shuheshin të gjithë.

Në çështjet e tjera shokët grekë s'kanë të drejtë. Ata nuk mund të zhvillojnë një luftë frontale me ushtri të rregullt, pse s'kishin as një ushtri të aftë për këtë lloj lufte dhe as territor të gjerë për këtë punë. Duke mbivlerësuar forcat e mundësitë që kishin, ata çdo gjë e bënë hapur, duke i dhënë mundësi armikut t'i zbulonte të gjitha pozicionet dhe arsenalin e tyre.

Sidoqoftë unë mendoj se ju duhet të merreni vesh me shokët grekë. Kjo është pikëpamja ime. Ato që thonë ata, sikur ju shqiptarët keni mbajtur ndaj tyre qëndrime «trockiste» e «titiste», janë akuza pa vend.

Në darkë Stalini më pyeti se ku dhe kur mendoja unë të mblidheshim bashkë me udhëheqësit grekë për të sqaruar mosmarrëveshjet parimore që kishin lindur midis nesh.

- Jemi gati të mblidhemi kur të doni, i thashë, mundet edhe në muajin janar të vitit që vjen, dhe mbledhjen ta bëjmë në Moskë.

Në vazhdim të bisedës me shokun Stalin folëm për gjendjen e rëndë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë pas tradhtisë së Titos, për politikën antimarksiste, nacionaliste e shoviniste që ndiqte klika titiste kundër Shqipërisë e vendeve të tjera të demokracisë popullore. Në mënyrë të veçantë rrit demokratë në të vërtetë duhet të ritiroheshin doemos, ndryshe do të shuheshin të gjithë.

Në çështjet e tjera shokët grekë s'kanë të drejtë. Ata nuk mund të zhvillojnë një luftë frontale me ushtri të rregullt, pse s'kishin as një ushtri të aftë për këtë lloj lufte dhe as territor të gjerë për këtë punë. Duke mbivlerësuar forcat e mundësitë që kishin, ata çdo gjë e bënë hapur, duke i dhënë mundësi armikut t'i zbulonte të gjitha pozicionet dhe arsenalin e tyre.

Sidoqoftë unë mendoj se ju duhet të merreni vesh me shokët grekë. Kjo është pikëpamja ime. Ato që thonë ata, sikur ju shqiptarët keni mbajtur ndaj tyre qëndrime «trockiste» e «titiste», janë akuza pa vend.

Në darkë Stalini më pyeti se ku dhe kur mendoja unë të mblidheshim bashkë me udhëheqësit grekë për të sqaruar mosmarrëveshjet parimore që kishin lindur midis nesh.

- Jemi gati të mblidhemi kur të doni, i thashë, mundet edhe në muajin janar të vitit që vjen, dhe mbledhjen ta bëjmë në Moskë.

Në vazhdim të bisedës me shokun Stalin folëm për gjendjen e rëndë në Partinë Komuniste të Jugosllavisë pas tradhtisë së Titos, për politikën antimarksiste, nacionaliste e shoviniste që ndiqte

klika titiste kundër Shqipërisë e vendeve të tjera të demokracisë popullore. Në mënyrë të veçantë unë fola për gjendjen e popullsisë shqiptare në Kosovë e në vise të tjera të Jugosllavisë.

- Vija e Partisë Komuniste të Jugosllavisë ndaj Kosovës dhe viseve të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, i thashë shokut Stalin, që nga fillimi i Luftës Antifashiste e gjer në Çlirim dhe akoma më tepër pas Qlirimit, ka qenë dhe është në pozita shoviniste e nacionaliste. Partia Komuniste e Jugosllavisë, nëse do të që në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, duhej t'i kishte kushtuar rëndësi të veçantë gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare çështjes së popullsisë shqiptare në Jugosllavi, pse ishte një minoritet i madh në numër dhe ngjitur me kufirin shqiptar. Pikëpamja jonë në vitet e para të luftës ishte se gështja e së ardhmes së Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi nuk duhej ngritur gjatë luftës, por shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera shqiptare duhej të luftonin kundër fashizmit në kuadrin e Jugosllavisë dhe mbas luftës ky problem do të zgjidhej nga të dyja partitë motra, nga regjimet demokratike popullore që do të vendoseshin në Shqipëri e në Jugosllavi, nga vetë popullsia shqiptare e atjeshme.

Çështja kryesore ishte që shqiptarët e Kosovës e të viseve të tjera të Jugosllavisë të ishin të sigurt e të bindeshin se, duke luftuar fashizmin krah për krah me popujt e Jugosllavisë, pas fitores do të ishin të lirë e do t'u krijoheshin mundësitë të vetëvendosnin për të ardhmen e tyre, pra të vendosnin vetë nëse do të bashkoheshin me Shqipërinë apo do të qëndronin në kuadrin e Jugosllavisë si një entitet me status të veçantë.

Një politikë e drejtë dhe parimore në këtë drejtim do të bënte që popullsia e Kosovës dhe e viseve të tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, pavarësisht nga reaksioni i egër dhe propaganda demagogjike faslute, të mobilizohej me të gjitha forcat në luftën e madhe antifashiste. Qysh në fillim të luftës ne ua shfaqëm udhëheqësve jugosllavë mendimin tonë se ata duhet ta mobilizonin popullsinë shqiptare në frymë patriotike, të lejonin që krahas flamurit jugosllav të mbanin edhe flamurin shqiptar, të mendonin për pjesëmarrjen në numër më të madh të elementit shqiptar në pushtetin e ri që do të krijohej në luftë e sipër, të përkrahej e të zhvillohej të shqiptarët si ndjenja e madhe e dashurisë për Shqipërinë, atdheun e tyre, ashtu edhe ndjenja e vëllazërimit me luftën e drejtë të popujve të Jugosllavisë, të krijohej dhe të forcohej bashkëpunimi shumë i ngushtë i çetave shqiptar e të Kosovës me Luftën Nacionalçlirimtare të vendit tonë, duke qenë këto çeta të Kosovës e të viseve të tjera të lidhura e të drejtuara nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare e të Jugosllavisë etj. Por, siç tregoi realiteti, vazhdoja t'i par ashtroj mendimin tim shokut Stalin, udhëheqjes jugosllave nuk i leverdisnin këto kërkesa të drejta e të domosdoshme, ndaj ajo jo vetëm ishte e errët në deklaratat e saj me karakter parimor, por Titoja, edhe ne edhe ata shokë jugosllavë që i konsideronin të drejta këto kërkesa, na akuzoi për «devijim nacionalist».

Politika shoviniste e nacionaliste nga ana e udhëheqjes jugosllave në Kosovë e në viset e banuara nga shqiptarët u intensifikua më tepër pas luftës, pavarësisht nga demagogjia dhe disa masa gysmake, siç që hapja e ndonje shkolle shqipe, që ndërmoi në fillim klika Tito-Rankoviç.

Sidoqoftë në vitet e para pas luftës ne akoma e quanim Partinë Komuniste të Jugosllavisë një parti motër dhe shpresonim se çështja e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare do të gjente zgjidhjen e drejtë sapo të krijohej momenti i përshtatshëm.

Ky moment menduam se u krijua në kohën e nënshkrimit të traktatit* (Është fjala për Traktatin e miqësisë, të bashkëpunimit dhe të ndihmës reciproke midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, që nënshkrua në korrik të vitit 1946) me Jugosllavinë dhe në atë kohë unë ia shtrova Titos këtë problem. Titoja mpyeti se ç'mendoja unë për Kosovën. «Kosova e viset e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi, i thashë unë, janë toka shqiptare që fuqitë e mëdha padrejtësisht ia shkëputën Shqipërisë; ato i përkasin Shqipërisë dhe duhet t'i kthehen Shqipërisë. Tani që ne jemi dy vende socialiste janë kushtet që ky problem të zgjidhet drejt». Titoja më tha: «Jam dakord, ne e dëshirojmë këtë, por tash për tash nuk mund të bëjmë gjë, sepse nuk e kuptojnë dot serbët një gjë të tillë». «Në rast se nuk e kuptojnë sot, i thashë unë, duhet ta kuptojnë nesër».

Në këtë moment shoku Stalin më pyeti se kur i kam njohur unë Titon dhe udhëheqësit e tjerë jugosllavë. Pasi i thashë se i kam njohur pas luftës, në vizitën e parë që bëra në Beograd në vitin 1946, vazhdoja:

- Problemi i Kosovës dhe i popullsisë shqiptare me banim në vise të tjera të Jugosllavisë, e ardhmja e tij mbetet një çështje për të cilën i takon të vendosë vetë populli i Kosovës dhe i viseve të tjera. Por ne, riga aria jonë, pa ndërhyrë kurrësi në punët e brendshme të Jugosllavisë, asnjëherë s'do të pushojmë së përkrahuri të drejtat e vëllezërve tanë të një gjaku me banim në Jugosllavi, ne do të ngremë zërin kundër terrorit dhe politikës së shfarosjes që ndjek ndaj tyre klika e Tito-Rankoviçit. Në fund i thashë shokut Stalin, se rreth këtij problemi u kemi drejtuar juve një letër.

- Letrën tuaj e kam lexuar - m'u përgjigj shoku Stalin. - Jam i një mendimi me ju, se çështjen e së ardhmes së tij e vendos e do ta vendosë vetë populli i Kosovës.

Titoja, përveç politikës antimarksiste që ka ndjekur ndaj Kosovës, vazhdoi shoku Stalin, ka dashur të aneksojë edhe vetë Shqipërinë. Kjo u duk haptazi kur Titoja u orvat të dërgonte divizionet e tij në Shqipëri. Ne e ndaluan një veprim të tillë. Ne dhe ju e dimë se njësitë e ushtrisë jugosllave do të dërgoheshin në Shqipëri në ndihmë të Koçi Xoxës që ky, nëpërmjet forcave jugosllave, të likuidonte Shqipërinë e lirë dhe Qeverinë Shqiptare.

- Titoja, i thashë unë, përfitoi riga fakti që Greqia në atë periudhë, në çdo rast, bënte provokacione në kufijtë tanë dhe kurdisi intrigën se gjoja ne do të sulmoheshim «në shkallë të gjerë riga Greqia» se «sulmi është i afërt» dhe «përbën rrezik për Shqipërinë» etj. Pas kësaj Titoja, në bashkëpunim edhe me tradhtarët Koçi Xoxe e të tjerë. me të cilët qe lidhur tinëz, ria propozoi që të dërgonte forcat e veta ushtarake në Shqipëri, p:ker isht në Korçë e pastaj edhe në Gjirokastër për «të ria mbrojtur riga sulmi grek». Ne e kundërshtuam me forcë këtë propozim dhe menjëherë ju vumë në dijeni edhe ju. Ishim të bindur se, nën maskën e divizioneve të ndihmës, ai synonte të pushtonte Shqipërinë dhe kjo ishte edhe përgjigja që ria erdhi riga ju në lidhje me njoftimin tonë.

Stalini me një nënqeshje, ku dukej edhe zeniërimi edhe ironia e thellë, tha:

- Dhe tani Titoja ria akuzon ne, sovjetikëve, se gjoja ndërhyjmë në punët e brendshme të Jugosllavisë, se gjoja paskemi dashur të sulmojmë Jugosllavinë! Jo, ne kurrë as kemi dashur e as niund të ria shkojë ndër mend një gjë e tillë, sepse ne jemi marksistë-leninistë, jemi një vend socialist, dhe s'mund të veprojmë ashtu si mendon e vepron Titoja.

Unë, mendoj - vazhdoi shoku Stalin - që edhe në të ardhmen ne, si marksistë-leninistë, t'i godasim veprimet dhe pikëpamjet antimarksiste të Titos e të udhëheqjes jugosllave, por e theksoj, në asnjë mënyrë s'duhet të ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme. Kjo s'do të ishte marksiste. Këtë çështje ta shikojnë komunistët jugosllavë ,dhe populli jugosllav; atyre u takon të zgjidhin problemet e të sotmes dhe të së ardhmes së vendit të tyre. Në këtë kuadër e shoh unë edhe problemin 'e Kosovës e të popullsisë tjetër shqiptare me banim në Jugosllavi. Ne s'duhet të lëmë asnjë shteg që armiku titist të na akuzojë pastaj se gjoja luftën tonë e bëjmë për prishjen e Federatës Jugosllave. Ky moment është delikat dhe do trajtuar me shumë kujdes, pse Titoja, duke thënë: «Ja, kërkojnë të na copëtojnë Jugosllavinë», jo vetëm grumbullon reaksionin, por përpiqet të tërheqë në anën e tij edhe elementët patriotë.

Për sa i përket situatës së Shqipërisë, vazhdoi shoku Stalin, nga pikëpamja ndërkombëtare, kjo është përcaktuar nga mbledhja e tre ministrave të Jashtëm, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ~të Britanisë së Madhe dhe të Bashkimit Sovjetik. Ju i dini deklaratat e Hullit, të Idenit dhe të Molotovit në këtë drejtim. Shumë zhurmë bëhet se Jugosllavia, Greqia etj. gjoja do ta sulmojnë Shqipërinë, por kjo s'është një punë e lehtë as për ta, as për çdo armik tjetër - më tha shoku Stalin dhe më pyeti:

- I vazhdojnë grekët provokacionet në kufi?

- Pas mësimëve që u dhamë sidomos në verën e këtij viti, tani i kanë ndërprerë goditjet me armë, i thashë, por sidoqoftë ne jemi vazhdimisht vigjilentë e qëndrojmë në gatishmëri.

- Caldarisi - vazhdoi shoku Stalin - është shumë i zënë me ngatërresat që ka brenda; tani ai s'ka nge të merret me provokacione, se monarko-fashistët po grinden me njëri-tjetrin. Unë mendoj, gjithashtu, se anglo-amerikanët nuk mund t'ju sulmojnë nga jashtë, por do të përpiqen t'ju atakojnë nga brenda, duke u orvatur të organizojnë kryengritje dhe lëvizje, duke futur agjentë dhe a-entatorë për të vrarë udhëheqësit e Shqipërisë t etj. Armiqtë do të përpiqen të krijojnë turbullira e konflikte brenda Shqipërisë, por në qoftë se Shqipëria do të jetë e fortë nga brenda, ajo nuk ka

rrezik nga jashtë. Kjo është kryesore. Në qoftë se Shqipëria do të bëjë një politikë të urtë e parimore, s'ka arsye të ketë aspak frikë.

Sa për dokumentet e të tre ministrave të Punëve të Jashtme - tha shoku Stalin - këto duhet t'i keni parasysh dhe, herë pas here, në momentet oportune, duhet t'i përmendni që t'ua kujtoni «miqve».

Vetëm se situata e brendshme duhet forcuar vazhdimisht e në çdo drejtim, kurdoherë duhet forcuar. Kjo është kryesore - tha ai dhe më pyeti:- Keni forca të mbrojtjes nën drejtimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për të goditur bandat kundërrevolucionare dhe përpjekjet e reaksionit të brendshëm?

- Po, i thashë. - Këto forca të përbëra prej, djemve të popullit kanë bërë një punë të lavdërueshme veçanërisht në vitet e para për spastrimin e vendit nga bandat e kriminelëve, të armiqve që fshiheshin maleve e të diversantëve që hidheshin nga jashtë. Në bashkëpunim të ngushtë me popullin forcat tona ushtarake po i kryejnë për-herë e më mirë detyrat e tyre dhe Partia e pushteti janë kujdesur e kujdesen që ato të përgatiten e të pajisen sa më mirë.

- Ju duhet t'i mbani vazhdimisht në ga= tishmëri këto forca për të larë hesapet si me gru-pet kundërrevolucionare ashtu edhe me banditëeventuale - më këshilloi shoku Stalin lidhur me situatën e Shqipërisë dhe më pyeti:

- E denoncoi Titoja Traktatin e paqes e të rriqësisë me Shqipërinë?

- Po, i thashë. - Mënyrë a si e denoncoi Titoja traktatin ishte tamam titiste. Më 2 nëntor të këtij viti udhëheqësit jugosllavë na drejtuan njënotë zyrtare plot shpifje e akuza të ulëta ku bënin thirrje në formë ultimatumit që të heqim dorë nga rruga jonë e të kthehemi në rrugën e tyre tradhtarë. Kur, pa pritje përgjigjen e notës së parë, më 12 nëntor na drejtuan notën e dytë ku e denonconin traktatin. Sidoqoftë, ne ua dhamë përgjigjen për të dyja notat ashtu si e meritonin dhe vazhdojmë të jetojmë për bukuri edhe pa traktatin e tyre «të miqësisë».

Gjithë ky takim kaloi në një atmosferë të ngrohtë, të gëzuar, shumë intime. Pas bisedës që bëmë vetëm për vetëm me shokun Stalin, hymë në shtëpi për të ngrënë darkë. Kur do të hynim në sallën e ngrënies, ishte një si paradhomë ku varëm palltot dhe kapelet. Salla e ngrënies kishte një tryezë të gjatë, anës ishte e veshur përgjysmë nie dru dhe aty-këtu kishte ndonjë tryezë për servirjen e gjellëve e të pijeve. Në darkë ishin edhe dy gjeneralë sovjetikë, njëri - shoqëruesi i Stalinit dhe, tjetri që më shoqëronte mua gjatë vizitës. Stalini bisedonte, na pyeste, bënte shaka me ne dhe me dy gjeneralet. Kur u ulëm të hanim, bënte shaka edhe për gjellët. Shumë interesante ishte darka. Asnjë garson nuk servite. Një vajzë sillte të gjitha gjellët në pjatanca të mbuluara me kapakë, që të mos ftoheshin; i vinte pjatat mbi trapezë dhe largohej. Stalini ngrihej, e mer rreth gjellën vetë, ndante zogun në thela, duke qëndruar në këmbë, mandej ulej e vazhdonte nga shakatë.

- Fillojmë të hamë - m'u drejtua mua. Ç'pret, më tha, mos mendon të na vijnë garsonët për të na shërbyer? Ja ku i ke pjatat, merri, hiq kapakët dhe fillo e ha se do të mbetesh pa ngrënë.

Përsëri qeshi me gjithë shpirt, me atë të qeshurën e tij që të ngazëllente e ta bënte zemrën: behar. Herë pas here merrte gotën e pijes dhe ngrinte dolli. Në një çast, gjenerali që e shoqëronte, kur pa se Stalini po merrte një pije tjetër nga tavolina, u mat të mos e lejonte dhe i tha të mos i përziehte. Ai vepronte kështu, sepse kishte për detyrë të kujdesej për Stalinin. Stalini qeshi dhe i tha se s'prishej ndonjë gjë. Por kur gjenerali nguli këmbë në të tijën, Stalini iu kthye me një ton si të zemëruar, por edhe me humor:

- Lena rehat tani, ç'më je bërë edhe ti si Titoja! - dhe më pa mua drejt e në sy, duke qeshur. Qeshëm të gjithë.

Nga fundi i darkës më tregoi një frutë e më pyeti: - Ke ngrënë nga kjo frutë? - Jo, i thashë, nuk e njoh, si hahet? Ma tha emrin, ishte një frutë Indi a tropikale, e mori, e qëroi dhe ma dha. - Provoje, më tha, duart i kam të pastra. Dhe mua m'u kujtua zakoni i bukur i njerëzve tanë të popullit, që kështu, duke biseduar, e qërojnë mollën e ia vënë mikut përpara ta hajë.

Në këtë takim të paharruar me shokun Stalin, si gjatë bisedës që bëme jashtë, ashtu edhe gjatë darkës, ne biseduam në frymë të thellë shoqërore edhe për probleme të zhvillimit ekonomik e socialkulturore të vendit tonë.

Stalini, si në të gjitha takimet e tjera, pasi u interesua gjer në detaje për gjendjen tonë ekonomike, për zhvillimin në tërësi të Shqipërisë së re, më dha një varg këshillash të vlefshme, të cilat na kanë shërbyer e na shërbejnë kurdoherë në punën tonë.

Unë e njoha në vija të përgjithshme shokun Stalin me gjendjen e punëve tona, i fola për sukseset e arritura në realizimin e planeve, për mobilizimin e madh të popullit si dhe për një sërë vështirësish e të metash që ne i njihnim dhe luftonim. t'i kapërcenim.

- Përveç të metave të punës sonë - i thashë shokut Stalin - vështirësi shumë të mëdha për realizimin e planeve në sektorin e industrisë e në tjetër na krijoi sabotimi sistematik i ekonomisë sonë nga ana e jugosllavëve. Ne tani po bëjmë përpjekje të mëdha e të gjithanshme për t'i eliminuar pasojat e asaj pune sabotuese dhe rëndësi të veçantë po i kushtojmë sektorit të industrisë socialiste, i cili, megjithëse në hapat e parë, është me. perspektiva të mëdha për vendin tonë. Krahas ndërtimit të objekteve të reja, një fushë të madhe. e me vlera në këtë drejtim përbëjnë pasuritë tona minerale. Në vendin tonë ka pasuri minerale të. pashfrytëzuara. Grupi i shkencëtarëve dhe i gjeologëve që do të na dërgojë Qeveria Sovjetike këtë. vit do të na japë të dhëna të tjera se ku gjenden këto pasuri dhe në ç'sasi janë. Nga ana tjetër, ne kemi në shfrytëzim vendburime të naftës, të kromit, të bakrit dhe të tjera. Sipas të dhënave të specialistëve, te ne ka shumë naftë, bakër dhe krom, pa folur për bitumin natyror. Me luftë e me përpjekje, me mobilizimin e të gjitha forcave e mundësive tona si dhe me kreditë që na ka dhënë Qeveria Sovjetike, ne e kemi përmirësuar shfrytëzimin e këtyre prodhimeve të çmuara. Por ne e ndiejmë se duhen shumë investime që të mund të aktivizojmë në maksimum nxjerrjen e këtyre produkteve. Tani për tanfi është e pamundur ta bëjmë këtë me forcat dhe me mjetet që zotërojmë. Pjesën më të madhe të kredive të akorduara nga Qeveria Sovjetike dhe demokracitë popullore, vazhdova më tej, i kemi përdorur për të përmirësuar deri në njëfarë shkalle shfrytëzimin e vendburimeve ekzistuese. Kjo bën që, nga njëra anë, ne të mos mundim të shfrytëzojmë siç dëshirojmë pasuritë e nëntokës tashmë të zbuluara, si kromi, bakri e nafta dhe ato që do të zbulohen, dhe, nga ana tjetër, ne s'mund t'i zhvillojmë me ritme të shpejta degët e tjera të industrisë.

Byroja jonë Politike e ka studiuar këtë çështje që paraqet një interes shumë të madh për të ardhmen e popullit tonë dhe arriti në konkluzionin se tani për tanfi nuk i kemi mjetet e mundësitë e brendshme që ta kryejmë vetë dhe në shkallë të plotë këtë punë. Për këtë do të dëshironim të dinim mendimin tuaj nëse e shihni të drejtë që për industrinë e naftës, të bakrit e të kromit të formojmë shoqëri të përbashkëta shqiptaro-sovjetike. Ky mund të jetë një problem që ne mund t'ia paraqitim edhe Këshillit të Ndhmës Ekonorrike Reciproke, por, përpara se ta bëjmë këtë, ne duam mendimin tuaj, shoku Stalin.

Duke marrë fjalën shoku Stalin, pasi shprehu gëzimin e tij për sukseset tona në zhvillimin ekonomik të vendit, më tha se për krijimin e shoqërive të përbashkëta shqiptaro-sovjetike ai nuk ishte dakord dhe më shpjegoi se edhe ndonjë hap që ishte bërë në fillim në këtë drejtim, me ndonjë nga vendet e demokracisë popullore, e kishin konsideruar gabim dhe kishin hequr dorë.

- Ne - tha ai, në vazhdim të fjalës së tij - do t'ju ndihmojmë sot e në të ardhmen, prandaj do t'ju japim njerëz dhe çdo gjë tjetër më tepër se ç'ju kemi dhënë gjer tani. Praktikisht ne kemi mundësi tani që t'ju japim më shumë, sepse plani ynë i tanishëm pesëvjeçar shkon mirë.

E falënderova shokun Stalin për ndihmat që na kishin dhënë e ato që do të na akordoheshin.

- Më falëndero kur t'ju vijne ndihmat tha ai me të qeshur dhe pastaj më pyeti

- Me se punojnë trenat, me naftë apo me qymyr

- Kryesisht me qymyr, i thashë, por tipat e rinj të lokomotivave që kemi marrë punojnë me naftë.

- E përpunoni naftën? Si vete puna me rafinerinë? - më pyeti në vazhdim të bisedës.
- Jemi dulce ndërtuar rafinerinë e re, pajisjet e së cilës janë sovjetike, i thashë. - Vitin e ar dhshëm do të montojmë makineritë.

- Po qymyre keni?

- Kemi, i thashë, dhe të dhënat gjeologjike tregojnë se perspektivat tona në këtë degë janë të mira.

- Duhet të punoni të zbuloni e të nxirrni sa më shumë qymyr, më këshilloi shoku Stalin. Ai është shumë i nevojshëm për zhvillimin e industrisë e të ekonomisë në tërësi, prandaj i kushtoni vëmendje se pa të do ta keni vështirë.

Një interesim e vëmendje të veçantë, si në të gjitha takimet e tjera, shoku Stalin tregoi për gjendjen e fshatarësisë sonë, për zhvillimin e bujqësisë, për politikën e Partisë sonë në këtë fushë të rëndësishme. Më pyeti se si shkojmë me bereqetin dhe ç'farëra përdorim për drithërat e bukës.

I thashë shokut Stalin se nga viti në vit jemi përpjekur për ta rritur prodhimin e drithërave, i cili është një problem shumë i madh e jetik për vendin tonë, se kemi arritur një sërë suksesesh në këtë drejtim, por na duhet të bëjmë akoma shumë punë e përpjekje për sigurimin e bukës së popullit.

- Qeveria juaj - më tha ndër të tjera shoku Stalin - duhet të punojë me të gjitha forcat për zhvillimin e bujqësisë, të ndihmojë fshata rësinë që bujku ta shohë konkretisht se Qeveria po interesohet për të dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të jetës së tij. Pastaj më pyeti:

- Ju e keni klimën të mirë, apo jo?

- Të mirë e kemi, i thashë.

- Po, po, pohoi ai, çdo gjë mbin e rritet te ju. Rëndësi ka edhe se gfarë mbjell. Ju, më këshilloi ai, duhet të zgjidhni farëra të mira, për këtë kërkoni ndihmë nga ne. Për të ardhmen duhet të përgatitni shumë agronomë që t'i keni, se Shqipëria është një vend bujqësor dhe bujqësia ecën përpara me punë e me njohuri të thella shkencore. Dërgoni këtu, shtoi ai, edhe një agronom që të zgjedhë farë.

Pastaj më pyeti:

- Si veni me pambukun? Është i interesuar fshatari ta kultivojë atë?

I thashë shokut Stalin se në të kaluarën për këtë bimë industriale nuk kemi pasur asnjë traditë, por tani po i shtojmë nga viti në vit sipërfaqet e mbjella me pambuk. Kjo është e domosdoshme, sepse veç të tjerash kombinati i tekstileve që po ndërtojmë do të ketë në bazën e tij pam bukun tonë.

- Ju duhet ta nxitni fshatarin të prodhojë - më këshilloi shoku Stalin - dulce i paguar atij çmime më të larta për pambukun. Fshatari, kur akoma s'është rrënjësor në ndërgjegjen e tij ideologjia socialiste, s'të jep kollaj pa shikuar më parë interesin e tij.

Në vazhdim të bisedës më pyeti:

- Keni toka të pahapura e të pashfrytëzuara ?

- Kemi, i thashë, si në kodra e në male ashtu edhe në zonën fushore. Veçanërisht kënetat e moçalet kanë qenë një plagë e rëndë si për bujqësinë ashtu edhe për shëndetin e popullit.

Shtova se në vitet e pushtetit popullor po bëjmë një punë të madhe për tharjen e kënetave dhe të moçaleve, kemi arritur një sërë suksesesh, por planet tona në këtë sektor janë të mëdha e ne do t'i realizojmë hap pas hapi.

- Fshatarësia, më tha shoku Stalin, duhet të mos lërë asnjë pëllëmbë tokë pa punuar. Të binden fshatarët që ta shtojnë sipërfaqen e punueshme të tokës.

Për të evituar të këqijat e moçalishteve dhe për të luftuar kundër malarjes, më këshilloi ai, mbillni eukalipte. Është një dru mjaft i mirë që te ne rritet në shumë zona. Mushkonjat i largohen shumë këtij druri, i cili rritet shpejt dhe thith ujërat e moçalishteve.

Gjatë darkës shoku Stalin gjithashtu më pyeti:

- Ç'thonë fshatarët shqiptarë që vizituan Bashkimin Sovjetik?

I thashë se kishin ardhur në Shqipëri me përshtypje shumë të mira e të pashlyeshme. Në bisedat me shokë e të afërm, në mbledhje e në takime që kanë bërë me popullin flasin me ndjenja të adrririmit të thellë për gjithçka panë në Bashkimin Sovjetik, për sukseset tuaja të gjithanshme e veçanërisht për zhvillimin e bujqësisë sovjetike. I tregova, midis të tjerash, se si e shpjegonte një fshatari ynë që kishte qenë në Bashkimin Sovjetik mostrën e misrit gjeorgjian.

Shokut Stalin kjo i pëlqeu shumë dhe të nesërmen mësova se ai ua kishte treguar edhe disa shokëve sovjetikë që erdhën e më vizituan. Me këtë rast Stalini kishte porositur personalisht të më sillnin disa qese me misër për farë nga të Gjeorgjisë. Gjithashtu po atë ditë me porosi të tij na sollën edhe farë eukalipti.

Gjatë këtij takimi shoku Stalin, si gjithmonë, fliste qetë, shtruar, pyeste e dëgjonte me shumë vëmendje, shfaqte mendimin e tij, na këshillonte, por gjithmonë në frymë të thellë shoqërore.

- S'ka receta se si duhet sjellur në këtë apo atë rast, se si duhet zgjidhur kjo apo ajo punë - përsëriste shpesh ai, sipas çështjeve të ndryshme që shtroja.

Gjatë bisedës me Stalinin i vura në dukje qëndrimin e klerit, sidomos të atij katolik në Shqipëri, pozitën tonë në marrëdhënie me të dhe e pyeta se si e gjykonte qëndrimin tonë.

- Vatikani - më tha ndër të tjera shoku Stalin - është një qendër reaksioni, vegël në shërbim të kapitalit e të reaksionit botëror, të cilët e mbështetin këtë organizatë ndërkombëtare diversioni e spiunazhi. Është fakt se shumë priftërinj katolikë e misionerë të Vatikanit janë spiunë të regjuri në shkallë botërore. Me anën e tyre imperializmi është përpjekur e përpiket të realizojë qëllimet e tij. - Pastaj më tregoi çfarë i kishte ndodhur një herë në Jaltë, me Ruzveltin, me kryetarin e kishës katolike amerikane etj.

Duke biseduar me Ruzveltin, Çerçillin e të tjerë për probleme të luftës antihitleriane, ata i kishin thënë: «Të mos e luftojmë më papën e Romës. C'keni ju me të që e goditni?!».

«Asgjë s'kam me të», u qe përgjigjur Stalini.

«Atëherë ta bëjmë papën aleat - kishin thënë - ta futim në koalicionin e aleatëve të mëdhenj ».

«Dakord - u kishte thënë Stalini - por aleanca antifashiste është aleancë për të zhdukur fashizmin e nazizmin. Kjo luftë sikundër e dini, zotërinj, bëhet me ushtarë, topa, mitraloza, tanke, avionë. Le të na thotë papa ose na thoni ju se ç'ushtri, topa, mitraloza, tanke e të tjera ka papa për luftë dhe le të bëhet aleat. Aleat për llafe e temjan ne nuk kemi nevojë».

Pas kësaj s'e kishin zënë më në gojë çështjen e papës e të Vatikanit.

- A ka pasur priftërinj katolikë në Shqipëri që kanë tradhtuar popullin? - më pyeti mandej shoku Stalin.

- Po, i thashë. - Bile krerët e kishës katolike u bashkuan që në fillim me pushtuesit e huaj nazifashistë, u vunë kokë e këmbë në shërbim të tyre, bënë ç'është e mundur të shkatërronin Luftën tonë Nacionalçlirimtare e të përjetësonin sundimin e huaj.

- Çfarë keni bërë ndaj tyre?

- Pas fitores, i thashë, i kapëm, i nxorëm në gjyq dhe atje morën dënimin e merituar.

- Mirë keni bërë, më tha.

- Po të tjerë, që kanë mbajtur qëndrim të mirë a keni pasur? - pyeti.

- Po, i thashë, veçanërisht klerikë të fesë ortodokse e myslimane.

- Cfarë keni bërë me ta? - më pyeti.

- I kemi mbajtur pranë. Qysh në Rezolucionin e saj të Parë Partia jonë u bëri thirrje të gjitha masave, edhe klerikëve, që përpara çështjes së madhe kombëtare të bashkoheshin në luftën e madhe për liri e pavarësi. Shumë prej tyre u bashkuan, u hodhën në luftë dhe dhanë një kontribut të çmuar për çlirimin e atdheut. Pas Çlirimit ata përqafuluan politikën e Partisë sonë, vazhduan punën për rindërtimin e vendit. Ne gjithmonë i kemi çmuar e i kemi nderuar klerikë të tillë, ka prej tyre që tani janë zgjedhur deputetë në Kuvendin Popullor, që janë graduar oficerë madhorë. Bile ndonjë tjetër, ish-klirik, aq shumë u lidh me Lëvizjen Nacionalçlirimtare e me Partinë sa në luftë e sipër e kuptoi kotësinë e dogmës fetare, e braktisi fenë, përqafoi ideologjinë komuniste dhe në sajë të luftës, të punës e të bindjeve të tij e kemi pranuar edhe në radhët e Partisë.

- Shumë mirë - më tha Stalini. - E çfarë t'ju them më shumë? Në qoftë se e ke të qartë që feja është opium për popullin dhe që Vatikani është një qendër obskurantizmi, spiunazhi e diversioni për çështjen e popujve, atëherë di edhe si të veprosh, ja, sig keni vepruar edhe ju.

Luftën kundër klerikëve që kryejnë veprimtari spiunazhi e diversioniste mos e vini asnjëherë në planin fetar, tha Stalini, por gjithmonë në planin politik. Klerikët duhet t'u binden ligjeve të shtetit, pse këto ligje shprehin vullnetin e klasës punëtore dhe të popullit punonjës. Ua shpjegoni mirë

popullit ligjet dhe armiqësinë e klerikëve reaksionarë me qëllim që, edhe ajo pjesë e popullsisë që beson në fenë, ta shohë qartë se nën maskën e fesë edhe klerikë kryejnë veprimtari armiqësore kundër atdheut e vetë popullit. Ndaj populli i bindur me fakte e argumente, tok xne Qeverinë të jetë në luftë me klerikët armiq. Vetëm ata klerikë që s'i binden Qeverisë dhe kryejnë krime të rënda kundër shtetit. i dënoni dhe i mënjanoni. Por. e theksoj, populli duhet të bindet në krimet e këtyre klerikëve, të bindet gjithashtu në kotësinë e ideologjisë fetare dhe në të këqijat që vijnë prej saj.

Në konkluzion të këtij takimi të paharruar më kujtohet që shoku Stalin dha si këshillë të për tare, e braktisi fenë, përqafoi ideologjinë komuniste dhe në saje të luftës, të punës e të bindjeve të tij e kemi pranuar edhe në radhët e Partisë.

- Shumë mirë - më tha Stalini. - E çfarë t'ju them më shumë? Në qoftë se e ke të qartë që feja është opium për popullin dhe që Vatikani është një qendër obskurantizmi, spiunazhi e diversioni për çështjen e popujve, atëherë di edhe si të veprosh, ja, sig keni vepruar edhe ju.

Luftën kundër klerikëve që kryejnë veprimtari spiunazhi e diversioniste mos e vini asnjëherë në planin fetar, tha Stalini, por gjithmonë në planin politik. Klerikët duhet t'u binden ligjeve të shtetit, pse këto ligje shprehin vullnetin e klasës punëtore dhe të popullit punonjës. Ua shpjegoni mirë popullit ligjet dhe armiqësinë e klerikëve reaksionarë me qëllim që, edhe ajo pjesë e popullsisë që beson në fenë, ta shohë qartë se nën maskën e fesë edhe klerikë kryejnë veprimtari armiqësore kundër atdheut e vetë popullit. Ndaj populli i bindur me fakte e argumente, tok xne Qeverinë të jetë në luftë me klerikët armiq. Vetëm ata klerikë që s'i binden Qeverisë dhe kryejnë krime të rënda kundër shtetit. i dënoni dhe i mënjanoni. Por. e theksoj, populli duhet të bindet në krimet e këtyre klerikëve, të bindet gjithashtu në kotësinë e ideologjisë fetare dhe në të këqijat që vijnë prej saj.

Në konkluzion të këtij takimi të paharruar më kujtohet që shoku Stalin dha si këshillë të për gjithshme: Të forcohet mirë situata e brendshme të forcohet puna politike me masat.

Stalini më mbajti në takim plot 5 orë. Në orën 9 të mbrëmjes shkua dhe më 2 pas mesnate u larguam. Pasi u ngritëm nga tryeza, Stalini më tha:

- Shko vish pallton.

Dolëm tok me dy gjeneralët dhe unë po prisja të ktheheshim përsëri në dhomën e takimit që ta falënderoja për pritjen e përzemërt dhe Vi lija shëndetin. Pritëm një copë herë, futëm kokën në dhomë, por ai s'ishte.

Njëri nga gjeneralët na tha:

- Ai sigurisht ka dalë jashtë, në kopsht.

Me të vërtetë atje e gjetëm - të thjeshtë, hijeqeshur, me kasketën në kokë dhe me shallin kafe në qafë. Na përcolli deri tek automobili. E falënderova.

- S'ka përse, s'ka përse - m'u përgjigj - nesër do t'ju telefonoj, mund të takohemi prapë. Duhet të rrini nja dy ditë këtu që të vizitoni Suhumin.

Të nesërmen mbrëma, më 25 nëntor, prisja me padurim të binte zilja e telefonit, por për fat të keq s'u takova dot përsëri me shokun Stalin. Në orën 1 pas mesnate të datës 25, ai kishte mbërritur në Soci dhe me anë të gjeneralit që më shoqëronte me dërgoi të falat e tij. Nga Suhumi, më 25 nëntor 1949 i bëra Mehmetit këtë telegram:

«Mbarova punë dje. Do të na ndihmojnë për çdo gjë. Të gjitha ç'kërkova na i pranuan me një përzemërsi shumë të madhe. Unë jam mirë. Për festë do të jetë zor të jem aty. Ju uroj nga zemra festën. Me mjetin më të parë do të nisem».

Në datën 25 nëntor vizituam qytetin e Suhumit, kishte 60 000 banorë. Gjatë vizitës më shoqëronin ministri i Brendshëm i Republikës Socialiste Sovjetike të Gjeorgjisë dhe një gjeneral tjetër. Suhumi ishte një qytet shumë i bukur, i pastër, me kopshte dhe me parqe të lulëzuara. Kishte shumë pemë të vendeve tropikale. Lule kudo. Në mes të tjerash binte në sy një park i mrekullueshëm, që ishte ndërtuar nga banorët e këtij qyteti vetëm në 50 ditë. Parku ishte pak më i madh se fusha përpara hotel «Dajtit» tonë. Natën Suhumi llamburiste nga dritat. Banorët e tij ishin simpatikë, të qeshur, të

gëzuar, të lumtur. Nuk shihje pëllëmbë tokë pa punuar. Para syve tanë shtriheshin plantacione me mandarina, limonë, qitro, portokalle e vreshta, fusha pa mbarim të mbjella me grurë, me misër etj. Kodrat ishin të punuara, të mbuluara me pemë e me pyje. Në qytet e kudo shihje eukalipte me trungje të larta.

Shkuam e pamë një sovkoz afër qytetit. Atje kishte vetëm kodra të veshura me mandarina, me portokalle, me limonë dhe me vreshta. Degët e mandarinave po thyheshin se ishin rënduar nga kokrrat. Një rrënjë mandarinë jepte 1 500, 1 600, 2 000 kokrra. «Ndonjëherë nuk arrijmë t'i mbledhim», na tha drejtori i sovkozit. Vizituam vendin ku futeshin në arka mandarinat etj. Aty punonin gra. Një makinë e madhe i seleksiononte portokallet e mandarinat një nga një, sipas madhësisë së kokrrave.

Vizituam një urë të vjetër të ndërtuar që nga shekulli i 15-të dhe që ruhet si vepër antike si dhe kopshtin botanik. Ishte një kopsht i pasur me drurë, pemë e lule të varieteteve të ndryshme. Pamë dhe një qendër ku rritnin e mbanin majmunë që bënë lojëra të ndryshme zbavitëse. Më thanë që kjo qendër i kishte shërbyer Pavlovit për eksperimentet e tij shkencore.

Gjeorgjianët ishin njerëz shumë të dashur, na pritën e na përcollën përzemërsisht.

Në mëngjesin e datës 26 nëntor, shoku sovjetik që më shoqëronte erdhi me gazetën «Krasnaja zvezda» në dorë dhe më dha lajmin e gradimit që më kishte bërë Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH* .*(Më 21 nëntor 1949, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH me propozim të Këshillit të ministrave të RPSH dhe të Byrosë Politike të KQ të P'SH, lëshoi dekretin në bazë të të cilit shoku Enver Hoxha gradohej Gjeneral Armate.)

Më 27 nëntor, në mëngjes, në orën 8, u nisëm me aeroplan për në Moskë. Udhëtimi vazhdoi 5 orë e gjysmë. Pas pak ditësh u ktheva në atdhe.

TAKIMI I KATERT

Janar 1950

Ballafaqim te Stalini lidhur me mosmarrëveshjet parimore ndërmjet udhëheqjes së Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të PK Greke. Marrin pjesë: Stalini, Molotovi, Malenkovi; Enver Hoxha, Mehmet Shehu; Niko Zahariadhis, Miço Parcalidhis. Mbi strategjinë dhe taktikën e Ushtrisë Demokratike Greke. Varkiza. Taktika e mbrojtjes pasive ëslitë mëma e disfatës. Përse ndodhën disfatat në Vici e në Gramoz? Mbi rolin udhëheqës të Partisë në ushtri. Vendi dhe roli i komisarit. Niko Zahariadhis shpreh pikëpamjet e tij. Vlerësimi i Stalinit.

Gjatë bisedës që pata me shokun Stalin në Suhumi, në nëntor 1949, ai më pyeti se kur mund të bënim së bashku një takim me përfaqësuesit e Partisë Komuniste Greke për të sqaruar mosmarrëveshjet me karakter parimor ndërmjet nesh dhe udhëheqësve të kësaj partie. Ne ramë dakord për muajin janar dhe, pasi që marrë aprovimi edhe i shokëve grekë, mbledhja u bë në fillim të janarit të vitit 1950 në Moskë, në Kremlin. Nga pala sovjetike morën pjesë në mbledhje shoku Stalin, Molotovi, Malenkovi dhe një sërë funksionarësh të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Nga Partia jonë ishim shoku Mehmet Shehu dhe unë, kurse nga Partia Komuniste Greke shokët Niko Zahariadhis dhe Miço Parcalidhis. Mbledhja u bë në zyrën e Stalinit. Stalini, si zakonisht i thjeshtë e i dashur, na priti me buzëqeshje, u ngrit nga tryeza e tij, na u afrua dhe na shtrëngoi dorën të gjithëve me radhë. Bisedën ai e filloi nga unë me pyetjen:

- Çfarë keni për të thënë ju, shoku Hoxha për shokët e Partisë Komuniste Greke?

Njëkohësisht shokëve grekë iu drejtua duke u thënë:

- Të flasim një herë shokët shqiptarë, pastaj merrni fjalën ju dhe jepni mendimet që treni për sa do të thonë ata.

Duke marrë fjalën, i thashë:

- Ne, shoku Stalin, i kemi bërë një letër Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik për mosmarrëveshjet parimore që treni me Partinë Komuniste Greke, veçanërisht me udhëheqësit e saj kryesorë. E kemi kërkuar këtë takim me ju për të na gjykuar nëse i kemi drejt apo i kemi gabim pikëpamjet tona.

- Jam në dijeni të çështjeve që ngrini, më tha shoku Stalin, por problemet që ju preokupojnë dëshiroj t'i përsëritni edhe këtu përpara shokëve grekë.

- Sigurisht që do t'i them edhe këtu të gjitha çështjet që Partia jonë tra parashtruar në letrën që ju kemi dërguar. Këto çështje ne i kemi biseduar edhe me shokët grekë, sidomos me shokun Nitro Zahariadhis, me shokun Joanidhis, me gjeneralin Vllandas, me Barxhotasin dhe me shokë të tjerë të udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke. Qysh në fillim dëshiroj të vë në dukje se ne kemi pasur mosmarrëveshje për disa çështje, po këtu do të flas për më kryesoret.

- Kështu dëshirojmë edhe ne - theksoi Stalini.

Pastaj unë fillova ekspozenë time:

- Mosmarrëveshja e parë me shokët grekë tra qenë lidhur me strategjinë dhe me taktikën e luftës së Ushtrisë Demokratike Greke. Si për ne, shqiptarët, edhe për popullin grek, lufta kundër fashistëve hitlerianë dhe italianë tra qenë një luftë çrimitare, nga e cila varej fati i popujve tanë. Këtë luftë ne duhej ta mbështetnim dhe e mbështetëm në luftën heroike të Ushtrisë së Kuqe të Bashkimit Sovjetik. Ne, shqiptarët, që në fillim ishim të bindur se do të dilnim fitimtarë, pse populli ynë ishte ngritur i tëri në një luftë të madhe glirimtare, në të cilën kishte përkrah edhe Bashkimin e madh Sovjetik që do të dërmonte nazizirin gjerman.

Par tia jonë e përkrahu aleancën sovjeto-ano-amerikane, se e konsideroi këtë deri në fund z, i një koalicion antifashist për shtypjen e nazistëve gjermanë. Por, njëkohësisht, ne asnjëherë nuk krijuam iluzionin se imperialistët anglo-amerikanë do të ishin miqtë dhe aleatët besnikë të popullit shqiptar. Përkundrazi, që në fillim, duke e mbështetur aleancën në tërësi, ne bëmë dallimin rrënjësor në mes Bashkimit Sovjetik dhe anglo-amerikanëve. Me këtë dua të them se Partia jonë, Ushtria jonë, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë sonë jo vetëm që nuk iu nënshtuan asnjëherë diktatit të anglezëve dhe të Komandës Aleate të Mesdheut, por edhe ndonjë këshillë që lejonim t'na bënë ata, e merrnim me prurë shumë të madhe. Anglezëve u kërkonim armë, po shihnim se ata na hidhnin shumë pak. Ne, siç e dini, zhvilluam luftën partizane, nga e cila kaluam më vonë në reparte të mëdha, deri në krijimin e Ushtrisë së rregullt Nacionalçlirimtare.

Populli grek luftoi në të njëjtat kushte si edhe ne. Ai ngrii krye kundër agresorëve fashistë italianë, i vuri ata përpara, i theu, hyri edhe në Shqipëri. Ndonëse atëherë nuk qe themeluar Par tia jonë Komuniste, prapëseprapë komunistët dhe populli ynë i ndihmuan grekët në luftën që bënë kundër Italisë fashiste, pavarësisht se ishim vetë të pushtuar. Por, me ndërhyrjen e ushtrisë hitleriane në luftën kundër Greqisë, ushtria monarkiste greke u detyrua të tërhiqej në tokën e saj, ajo u thye. Pas kësaj kohe lindi rezistenca dhe Lufta Nacionalçlirimtare e popullit grek, e udhëhequr nga Partia Komuniste Greke, e cila krijoi EAM-in, organizoi çetat partizane dhe, më vonë, njësitë e tjera më të mëdha.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare që bënë, të dy popujt tanë u vëllazëruan edhe më shumë me njëri-tjetrin. Qysh në të kaluarën kanë ekzistuar lidhje miqësore midis popullit shqiptar dhe popullit grek. Sig dihet, shumë shqiptarë morën pjesë dhe luajtën një rol shumë të rëndësishëm gjatë revolucionit grek të viteve njëzet të shekullit të kaluar, të udhëhequr nga Ipsillanti. Por kësaj herë e karakteri i luftërave tona ishte i njëjtë dhe në udhëheqje të popujve të të dy vendeve ishin partitë tona komuniste. Ne vendosëm marrëdhënie ndërmjet njëri-tjetrit, bile edhe ushtarakisht vepruam me çeta të përbashkëta në territorin grek kundër ushtrive gjermane. Reaksioni, si në ventin tonë edhe në Greqi, ishte i madh dhe pushtuesit qenë të organizuar mjaft mirë. Edhe ky ishte një fenomen i përbashkët.

Nga ana jonë u bënë përpjekje dhe u arritën rezultate për izolimin e krerëve të reaksionit dhe për shkëputjen e elementëve të gabuar nga radhët e tij. Në Greqi nuk munti të themi me hollësi se si u veprua, por ne i tremi kritikuar shokët e udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke për arsye se EAM-i dhe vetë ata kishin bërë një gabim të madh parimor dhe politik që Luftën Nacionalçlirimtare të popullit grek ia nënshtruan strategjisë anglo-amerikane dhe e vunë gati nën drejtimin e anglezëve dhe të Shtabit të Mesdheut. Kritikën ia drejtuam personalisht shokut Niko Zahariadhis.

Faktori kryesor për këtë gjendje ishte Siantosi, i cili, në mungesë të Zahariadhisit, që në atë kohë ndodhej i burgosur në kampet gjermane të përqendrimit, ka qenë sekretar i përgjithshëm i Partisë Komuniste Greke. Kur, më pas, ia vumë në dukje këtë çështje shokut Zahariadhis, ky nuk më është përgjigjur qartë dhe anonte më shumë nga pikëpamja se nuk ishin bërë gabime. Unë kam ngulur këmbë në mendimin e Partisë sonë dhe, rrië në fund, i kam thënë shokut Zahariadhis se Siantosi ishte një provokator, një agjent i anglezëve. Po të ishte Siantosi te ne, Partia jonë do ta kalonte në gjyq, dhe do t'i jepte dënimin e merituar, kurse ju nuk bëtë kështu, i thashë shokut Zahariadhis. Natyrisht, kjo është puna juaj, por ky është mendimi ynë për këtë çështje.

Si konkluzion, shoku Niko Zahariadhis pranoi se «nuk duhej vepruar ashtu nga ana e Siantosit», se «për këtë shokët e kishin kritikuar, por në gjyq nuk e kaluan, vetëm e përjashtuan nga Partia», përfundoi ai.

Në vazhdim të kësaj çështjeje, dëshiroj të vë në dukje se me shokët udhëheqës të Partisë Komuniste Greke ne kemi pasur një sërë bisedimesh politike, ideologjike dhe ushtarake dhe kjo, kuptohet, se ne ishim dy parti komuniste, kishim një strategji të njëjtë - çlirimin e vendeve tona nga pushtuesit nazifashistë dhe nga borgjezia reaksionare e secilit vend.

Ne vumë re se, me gjithë trimërinë e shquar të partizanëve grekë dhe të komandantëve të tyre, shoku Niko Zahariadhis, pasi u lirua nga kampet hitleriane të përqendrimit, zuri një vend kryesor në drejtim, në Greqinë «e çliruar» me ushtrinë angleze brenda, në bazë të nënshkrimit që më parë të marrëveshjes së Kazertës dhe asaj të Kajros nga ana e përfaqësuesve të EAM-it, marrëveshje këto që çuan më së fundi në atë të Varkizës. Partia jonë nuk ishte dakord me këto veprime të Partisë Komuniste Greke, i konsideroi ato si një nënshtrim të luftës demokratike greke, si një falimentim të politikës së saj të çlirimit dhe kapitullim përpara reaksionit anglo-amerikan.

Më tej, në një miting masiv në stadiumin e Athinës, ku folën me radhë krerët e partive borgjeze greke, foli edhe shoku Niko Zahariadhis, si udhëheqës i Partisë Komuniste Greke, i cili, në mes të tjerash, deklaroi: «Në rast se partitë e tjera demokratike greke kërkojnë autonominë e «Vorio-Epirit», Partia Komuniste Greke do të bashkohej me to»(!). Partia jonë protestoi menjëherë haptazi dhe paralajmëroi se ajo do t'i luftojë pa mëshirë pikëpamje të tilla. Pas kësaj ngjarjeje, ne ftuam në një takim shokun Niko Zahariadhis, të cilin e kritikova ashpër, duke e konsideruar deklaratën e tij si një qëndrim antimarksist dhe antishqiptar dhe i bëra mirë të qartë se «Vorio-Epiri», që është tokë shqiptare, nuk do të bëhej kurrë Greqi. Dëshiroj të them me këtë rast se shoku Niko Zahariadhis e njohu gabimin e tij, pohoi para nesh që kishte gabuar rëndë në këtë drejtim dhe premtoi se do ta ndreqte gabimin që bëri.

Ne mund të jemi të gabuar, por kemi mendimin se Markos Vafiadhis, të cilin e eliminuan më vonë, ishte një komunist i mirë dhe komandant i zoti. Por, natyrisht, ky është vetëm një mendim nga ana jonë, që mund të jetë i drejtë, ashtu siç mund të jetë edhe i gabuar, prandaj nuk kemi asnjë pretendim për këtë, se fundi i fundit është një çështje që nuk na takon neve ta gjykojmë, por i përket Partisë Komuniste Greke.

Kundërshtimi ynë me udhëheqjen e Partisë Komuniste Greke, me shokun Zahariadhis në krye, qëndron, së pari, te Varkiza, ku Partia Komuniste Greke dhe EAM-i nënshkruan marrëveshjen, që nuk është gjë tjetër veçse një kapitullim, një dorëzim armësh. Partia e Punës e Shqipërisë e cilësoi këtë akt si një tradhti që iu bë Partisë Komuniste Greke dhe popullit vëlla grek. Varkiza jo vetëm që nuk duhej bërë, por ajo duhej dënuar rreptë. Këtë pikëpamje unë ua kam shprehur me kohë shokëve Niko Zahariadhis dhe Miço Parcalidhis, i cili ka qenë një ndër nënshkruesit e marrëveshjes. Ne kemi respekt për këta dy shokë udhëheqës grekë, Zahariadhisin dhe Parcalidhisin, por ky veprim, i frymëzuar dhe i kryer nga ana e tyre, ishte shumë i gabuar dhe i solli shumë të këqija popullit grek.

Niko Zahariadhisi ka mbrojtur një tezë të kundërt nga ajo jona në lidhje me Varkizën. Ai vazhdimisht ka ngulur këmbë se ajo nuk ishte aspak një kapitullim, as tradhti, por «një veprim që duhej bërë për të fituar kohë dhe për të lejuar marrjen e pushtetit».

Lidhur me Varkizën kam pyetur shokun Niko Zahariadhis se për ç'arsye u dënua dhe u vra Aris Veliqiotisi, i cili, pas nënshkrimit të marrëveshjes, u nis të vinte në Shqipëri për të marrë kontakt me Komitetin Qendror të Partisë sonë. Niko Zahariadhisi më është përgjigjur se «Aris Veliqiotisi, sido që ishte një gjeneral trim, ishte rebel, anarkist, ai nuk e kishte pranuar vendimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Greke për Varkizën, prandaj ne vetëm e përjashtuam nga Komiteti Qendror i Partisë, po se çfarë u bë më vonë me të, kush e vrau etj., tha Zahariadhisi, ne nuk e dimë». - «Ju sigurojmë se për vrasjen nuk jemi ne autorët», na tha ai. I kam shprehur shokut Niko Zahariadhis mendimin tonë se, pa dashur kurrsesi të ndërhyjmë në punën e tyre dhe pa e njohur personalisht Arisin, vetëm duke pasur parasysh se ishte një luftëtar trim i popullit grek, ai nuk duhej dënuar. Sa për vrasjen e tij, i thashë, ne u besojmë atyre që na keni treguar ju, po edhe për këtë, duke qenë konsekuentë në çështien e Varkizës, kemi kundërshtim me ju.

Ne, si marksistë-leninistë, na vinte shumë keq për popullin grek me të cilin kishim bashkëpunuar gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, prandaj edhe më pas, në momentet kur përpara këtij populli ngrihej përsëri çështja e çlirimit apo e robërisë, deshëm ta vazhdonim këtë bashkëpunim.

Nuk dëshiroj të flas këtu për përkrahjen dhe për mbështetjen internacionaliste që ne i kemi dhënë Partisë Komuniste Greke dhe Luftës Nacionalçlirimtare Greke, me gjithë kushtet shumë të vështira në të cilat lgjendej vendi ynë i porsaçliruar nga pushtuesit. Për këtë le ta thonë fjalën vetë shokët grekë. Me gjithë varfërinë tonë të madhe, kur erdhi puna, ne bëmë ç'që e mundur për t'u ardhur në ndihmë, me ushqime e me strehim refugjatëve grekë që hynë në tokën tonë. Ndhimë e madhe për Ushtrinë Demokratike Greke ishte fakti që Shqipëria ishte një vend mik i çliruar, ku kishin ardhur në fuqi populli dhe Partia e Punës e Shqipërisë, gjë që i jepte mundësi Ushtrisë Demokratike Greke t'i kishte krahët të ngrohta dhe të mbr ojtura nga ana e veriperëndimit.

Pas kapitullimit në Varkizë rifilloi Lufta Nacionalçlirimtare Greke. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Greke bëri mbledhjen e plenumit, ku u ftuan delegatë edhe nga Partia jonë dhe ne dërguam atje shokun Mehmet Shehu. Me këtë rast u bënë ndryshime në udhëheqje, por të gjitha këto ishin çështje të brendshme të Partisë Komuniste Greke. Ne vetëm gëzoheshim dhe inkurajonim goditjet e ashpra që u bëheshin monarko-fashistëve në të katër anët e Greqisë, të cilët, duke parë rrezikshmërinë e gjendjes së krijuar, kaluan

nga mbështetja tek anglezët, në atë të arnerikanëve. Shtetet e Bashkuara të Amerikës dërguan si komandant të ushtrisë së tyre në Greqi gjeneralin fomëkeq Van Flit, që e hiqnin si strateg të shquar.

Me Zahariadhisin, me Barxhotasin dhe me Joanidhisin ne kemi pasur kundërshtime për karakterin e luftës që duhej të bënte Ushtria Demokratike Greke kundër forcave të rregullta e të shumta të reaksionit grek të armatosur me mjetet më moderne ushtarake nga ana e imperialistëve amerikanë.

Midis dy partive tona ka pasur, pra, një kundërshtim parimor edhe në këtë çështje. Të bazuar në Luftën tdnë Nacionalçlirimtare, ne mendojmë se Lufta Demokratike Greke nuk duhet të kthehej në një luftë frontale, por të ruante karakterin e luftës partizane, me njësi të vogla e të mëdha. Në këtë mënjnë forcat e shumta të Van Flitit jo vetëm të rnos mundnin të asgjësonin dot Ushtrinë Demokratike Greke, por përkundrazi të ishte kjo që t'i shqetësonte dhe t'i godiste ato nga të katër anët me taktikën e luftës partizane, t'i dëmtonte dhe gradualisht t'i dobësonte, derisa të përgatiste kundërmësymjen. Ne mbështetnim tezën që lufta partizane greke duhej të bazohej në popull, ndërsa armatimet t'i merreshin armikut.

Pikëpamjet strategjike të Zahariadhisit ishin në kundërshtim me tonat. Rigrupimin e forcave partizane nacionalçlirimtare që mundën të bënin shokët e udhëheqjes së Partisë Komuniste Greke e cilësuan jo vetëm në formë ushtri të «rregullt» dhe «moderne», por këtë ushtri pretendojnë se e kishin pajisur me strategjinë dhe me taktikën e h.Itës frontale të një ushtrie të rregullt. Në të vërtetë, sipas mendimit tonë, forcat që ata rigrupuan ishin vetëm një ushtri partizane, e cila nuk arriti të pajisej as me taktikën partizane, as me taktikën e luftës së një ushtrie të rregullt. Nga ana tjetër, shokët grekë në veprimet luftarake ndoqën taktikën e mbrojtjes pasive që është mëma e disfatës.

Ky, për mendimin tonë, ishte një gabim i rëndë i shokëve udhëheqës të Partisë Komuniste Greke, të cilët kanë shkuar nga parimi jo i drejtë, sipas të cilit lufta partizane nuk ka asnjë qëllim final, domethënë nuk të çon dot në marrjen e pushtetit. Nga bisedimet që kemi pasur me ta, ne kemi krijuar mendimin se shokët grekë luftën partizane e kuptojnë si një luftë gueriljerësh prej 10-15 vetash, njësite të shkëputura që, sipas tyre, s'kanë perspektivë rritjeje dhe zhvillimi në brigada, në divizione, në korparmata etj. Kjo nuk është e drejtë. Siç ka treguar eksperiencia e çdo lufte të tillë, siç vërtetoi edhe Lufta jonë Nacionalçlirimtare, lufta partizane me njësite të vogla, po të drejtohet mirë, gradualisht rritet me zhvillimin e vetë luftës, me zmadhimin e hovit revolucionar të masave dhe arrin kështu deri në kryengritjen e përgjithshme të armatosur dhe në krijimin e një ushtrie të rregullt popullore. Por shokët udhëheqës të Partisë Komuniste Greke i kanë mbrojtur me këmbëngulje pikëpamjet e tyre dhe kanë ekskluduar kategorikisht domosdoshmërinë e zgjerimit dhe forcimit të luftës partizane në Greqi. Ne nuk jemi pajtuar dhe nuk pajtohemi me këto pikëpamje të tyre. Më lejoni t'ju shfaq mendimin tonë se si paraqitej situata në kohën kur Partia Komuniste Greke u hodh në ilegalitet e iu desh të rifillonte luftën: Repartet e ELAS-it* *(Ushtria Nacionalçlirimtare Greke.) në atë kohë kishin dorëzuar armët, bazat e tyre ishin shkatërruar, atyre u mungonin veshmbathja, ushqimi, armët; morali i ELAS-it kishte rënë, lëvizja ishte në tërheqje. Pikërisht rigrupimin e këtyre forcave Partia Komuniste Greke e quajti qysh në fillim «ushtri të rregullt» dhe «moderne», e cila, sipas tyre, mund të luftonte me strategjinë dhe me taktikën e një ushtrie moderne e të përballonte luftën frontale e të hapët me një armik dhjetë herë më të fortë. Ne mendojmë se kjo ushtri partizane duhej të luftonte sipas taktikës partizane, siç na mësojnë mësuesit tanë Marks, Engelsi, Lenini dhe Stalini. Si mund ta quash, pra, ushtri të rregullt këtë rigrupim forcash partizane që bër i Partia Komuniste Greke, kur ajo nuk kishte as kuadrot e nevojshëm, as tanke, as avionë, as artileri, as ndërlydhje, as rroba, as ushqime dhe as armë të lehta të domosdoshme?! Këto pikëpamje të shokëve grekë mendojmë se janë jo të drejta.

Udhëheqja e Partisë Komuniste Greke, duke e quajtur këtë rigrupim partizanësh ushtri të rregullt, të pajisur, sipas tyre me «strategjinë dhe me taktikën e luftës së një ushtrie të rregullt», (strategji dhe taktikë që në realitet nuk u vu kurrë në zbatim) as nuk mendoi seriozisht dhe në mënyrë marksiste se si do të furnizohej kjo ushtri. Shokët grekë thoshin: «S'ka mundësi t'i marrim armët nga armiku». Por pikëpamje të tilla, mendojmë ne, janë në kundërshtim me mësimet e Leninit, i cili ka thënë se në asnjë rast nuk duhet të priten ndihma nga jashtë ose nga lart, por duhet të sigurohet çdo gjë vetë; se nuk duhet të lihet në asnjë rast organizimi i reparteve ose riorganizimi i tyre me pretekst se mungojnë armët etj. Shokët udhëheqës grekë, duke e nënvleftësuar armikun, kanë kujtuar se marrja e pushtetit që një gjë e lehtë dhe mund të bëhej pa përpjekje të gjata e të përgjakshme dhe pa organizim të shëndoshë e të shumanshëm. Këto pikëpamje të shokëve grekë sollën konsekuenca të tjera të hidhura, të cilat shkaktuan disfatën e tyre të fundit, por është e çuditshme se ata edhe në bisedimet që kemi bërë kohët e undit i quajnë pikëpamjet e tyre të drejta.

Mirëpo taktika dhe strategjia që mbron shoku Niko për luftën, sipas mendimit tonë, të bazuar në fakte, është e gabuar. Në bisedën që kam pasur me shokun Zahariadhis, ky ka pretenduar se njësitë e Ushtrisë Demokratike Greke nuk që e mundur të futeshin në thellësinë e territorit grek, për arsye se monarko-fashistët dhe Van Fliti digjnin fshatrat dhe i kishin spastruar ato nga popullsia, kështu që, sipas tij, të gjitha qendrat e banuara kishin mbetur bosh. Unë i kam thënë se një gjë e tillë mund të ngjiste, por jo në atë përpjesëtim që pohonte Zahariadhis. Ky ishte mendimi im i mbështetur në logjikën e fakteve, sepse, kuptohet, është e pamundur të spastrohen të gjitha zonat e banuara të Greqisë prej popullsisë nga ana e monarko-fashistëve dhe nga ushtria amerikane.

Po ashtu ne jemi në kundërshtim me pretendimet dhe me pikëpamjet e shfaqura në një letër të Byrosë Politike të Partisë Komuniste Greke, drejtuar Byrosë Politike të Partisë sonë, ku ata, duke mos u thelluar në gabimet e tyre, dhe duke dashur t'i fshihnin këto, pretendojnë se disfatat e tyre rrjedhin ngaqë nuk qenë të furnizuar me armë, me municion dhe me veshmbathje në masën e duhur dhe se armiku zotëronte ajrin, detin dhe furnizohej shumë nga anglo-amerikanët. E vërteta është se armiku që shumë më i furnizuar e me forca të mëdha materiale e njerëzore. Por, në një rast të tillë, kur je duke zhvilluar një luftë kundër reaksionit të brendshëm e ndërhyrjes së huaj ushtarake, rruga

më e mirë është që armiku të bëhet burimi më i madh për furnizime. Ushtria Demokratike Greke duhet t'ia rrëmbente armët armikut, por këto armë nuk rrëmbehen duke ndjekur taktikën e luftës difensive, të mbrojtjes pasive. Megjithatë mendojmë se çështja nuk qëndron te furnizimet. Ne mendojmë se udhëheqja e Partisë Komuniste Greke, duke hedhur poshtë taktikën e luftës partizane dhe zhvillimin e saj deri në kryengritjen e përgjithshme me armë dhe në marrjen e pushtetit, ka zbatuar një taktikë difensive dhe pasive të papranueshme as nga një luftë partizane, as nga një luftë frontale me ushtri të rregullt. Duke ndjekur një taktikë të tillë, Ushtria Demokratike Greke, veg të tjerash, i privoi vetes mundësinë për t'u shtrirë në zona të tjera të vendit, ku domosdo do të gjente burimin e pashtershëm të forcave njerëzore të djemtë dhe të vajzat e popullit, po ashtu, e privoi veten nga rriundësia për t'i rrëmbyer armët armikut nëpërmjet përpjekjesh të vazhdueshme, të shpejta, të studiuara mirë e të kryera atje ku s'ia priste mendja armikut. Nuk duhet luajtur me kryengritjen e ar, matosur, na mëson marksizëm-leninizmi dhe historia e kaq e kaq luftërave ka vërtetuar se difensiva është vdekje për çdo kryengritje të armatosur. Në qoftë se mbetet në difensivë, kryengritja shpartallohet shumë shpejt nga një armik më i fuqishëm dhe i pajisur më mirë.

Këtë vërtetoi, për mendimin tonë, edhe ajo taktikë që ndoqën shokët grekë. Forcat e gjalla dhe më të mëdha të Ushtrisë Demokratike Greke kanë qenë vazhdimisht të gozhdhuara në sektorin e fortifikuar të Vicit dhe të Gramozit. Këto forca janë përgatitur për luftë llogore dhe difensive, atyre u është imponuar dhe kanë pranuar me dëshirën e udhëheqjes së tyre luftën frontale me ushtrinë e armikut. Me luftën difensive e pasive shokët grekë kanë menduar të marrin pushtetin në duart e tyre. Pushteti, sipas mendimit tonë, nuk mund të merret duke u mbrojtur në Gramoz. I vetmi manovrim që udhëheqja e Partisë Komuniste Greke ka bërë (dhe ky i imponuar nga rrethanat), ka qenë në luftën e zhvilluar në Gramoz në vitin 1948, ku me të vërtetë partizanët heroikë grekë kanë rezistuar për shtatëdhjetë ditë me radhë, i kanë shkaktuar dëme armikut në njerëz, por, më në fund, për t'i shpëtuar rrethimit dhe shfarosjes, kanë dalë nga Gramozi dhe kanë kaluar në Vici. Por marrja e pushtetit mbeti akoma shumë larg. Ushtria Demokratike Greke duhej të zhvillonte sulme për marrje qytetesh. Kjo nuk u realizua. Shokët grekë edhe atëherë pretendonin se u mungonin forcat. Kjo mund të jetë e vërtetë, por perse u mungonin forcat dhe ku duhej t'i gjenin ato, këtë problem shokët grekë nuk e thellonin dhe nuk e zgjidhën, as atëherë, as më pas, në rrugën e dhur marksist-leniniste. Taktika e shokëve grekë ishte, sikundër e shfaqin në letrën e tyre të Byrosë Politike drejtuar Byrosë sonë Politike, të mbanin me çdo kusht Vicin dhe Gramozin, bazën e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të luftës dhe suksesin e luftës e varnin ekskluzivisht nga furnizimet, por pa gjetur asnjëherë rrugën e drejtë për t'i siguruar me luftë ato furnizime.

Sidoqoftë, duke kaluar nga disfata në disfate, Ushtria Demokratike Greke u detyrua të tërhiqej dhe të vendosej përsëri në zonën e Vicit dhe të Gramozit. Kjo ishte një fazë shumë kritike, si për Ushtrinë Demokratike Greke, edhe për vendin tonë. Gjatë kësaj periudhe ne i kemi ndjekur me shumë vëmendje veprimet e shokëve grekë. Para o,ensivës së fundit të monarko-fashistëve kundër Ushtrisë Demokratike Greke, shokët udhëheqës gz-ekë kishin mendimin se situata e tyre politike e ushtarake ishte jashtëzakonisht e shkëlqyer, kurse ajo e armikut, sipas tyre, ishte shumë e dëshpëruar. Ata kishin pikëpamjen se «Vici është i fortifikuar jashtëzakonisht dhe i pamarrshëm nga armiku; po të sulmojë armiku Vicin, ai ka firmuar vdekjen e tij. Vici do të bëhet varri i monarko-fashistëve. Armiku është i detyruar ta bëjë këtë ofensivë pse ai s'ka rrugë tjetër daljeje, ai është në buzë të greminës. Ushtria monarko-fashiste dhe Van Fliti le të sulmojnë kur të duan, ne do t'i thyejmë».

Shoku Vllandas kishte mendimin se grushti kryesor i armikut do të jepej në Gramoz dhe jo në Vici, për arsye se «Gramozi është më pak i fortifikuar, pse është kufi me Shqipërinë dhe armiku, pasi të na mundë atje, do të kthehet në Vici për të na goditur, pse ai mendon se atje mund të na asgjësojë, meqenëse është Jugosllavia në kufi. Ne, pasi të kemi luftuar në Gramoz dhe t'i kemi shkaktuar humbje të mëdha armikut, do të manovrojmë me forca nga Gramozi për të sulmuar nga prapa forcat armike në Vici».

Por pak para sulmit të fundit shokët grekë u informuan nga ne se armiku sulmin kundër tyre do ta drejtonte në Vici në datën 10 gusht e jo në Gramoz. Kjo informate u jepte shokëve grekë mundësinë që ata të mos gjendeshin në befasi dhe të merrnin masa me kohë. Por edhe pas kësaj, ata vazhdonin të besonin se grushti kryesor do të ishte në Gramoz. Sipas tyre, sulmi armik në Vici e jo në Gramoz «nuk ndryshon gjëkafshë për ne. Ne i kemi marrë të gjitha masat si në Vici si në Gramoz. Vici është i pamarrshëm, mendonin ata, ai është jashtëzakonisht i fortifikuar, të gjitha rrugët nga ku mundet të kalojë armiku janë bërë të pakalueshme. Armët e rënda të armikut nuk mund të hyjnë në zonën e Vicit, fitorja është jona».

Këto ishin pikëpamjet e shokëve grekë dy dite para sulmit mbi Vici. Monarko-fashistët brenda një dite kapën vijën e tretë të mbrojtjes së Vicit dhe brenda dytri ditëve Vici u shpartallua. Lufta dhe rezistenca kanë qenë shumë të pakta. Kjo për ne ishte një gjë shumë e papritur. Por ne i kishim marrë të gjitha masat e mbrojtjes nga një sulm eventual në tokën tonë nga ana e monarko-fashistëve. Për këto masa mbrojtjeje që kishim marrë ne, shokët grekë, dhe vetë shoku Parcalidhis që është i pranishëm këtu, nuk kanë qenë shumë të bindur dhe i kanë quajtur të shpejtuara nga ana jonë. Shokët grekë nuk ishin realistë. Shumë refugjatë, midis të cilëve edhe ushtarë demokratë, që u thyen keqas, u detyruan të kapërcenin kufirin tonë. Ne ç'të bënim?! I pranuar dhe i vendosëm në vende të caktuara.

Analiza që Byroja Politike e PK Greke i bëri disfatës së Vicit ne nuk na kënaqi. Ne mendojmë se lipsej të bëhej një analizë e thellë, se atje kishte gabime të rënda. Pas tërheqjes nga Vici, perspektivat e fitores shoku Zahariadhis i mbështeti në Gramoz. «Gramozi, thoshte ai, është më i favorshëm për ne se Vici, tanket që kanë qenë elementi vendimtar i fitores së monarko-fashistëve në Vici: nuk rëndë të manovrojnë në Gramoz» etj.

Duhet thënë se në atë kohë tradhtia e Titos ishte bërë e njohur. Më vonë Zahariadhis pretendoi se «të vetmit që i strehuan refugjatët grekë ishin shqiptarët, se jugosllavët jo vetëm nuk pranuan kalimin e refugjatëve në territorin e tyre, por i qëlluan edhe pas krahëve». Ka mundësi të ishte edhe kështu, ne nuk mund të themi gjëkafshë.

Në një bisedë që bëra me shokun Zahariadhis për tërheqjen nga Vici, unë ngrita përsëri çështjen e gabimeve të tyre si dhe mungesën e një pamjeje objektive të situatës nga ana e Partisë Komuniste Greke dhe në mënyrë të veçantë nga komandanti i Vicit, gjenerali Vllandas. «Ato që mendonte ai, i thashë Nikos, u pa se nuk ishin të vërteta. Kjo u vërtetua me faktin që Ushtria Demokratike Greke nuk që në gjendje ta mbronte Vici».

Niko Zahariadhis më kundërshtoi. Ai më tha se Vici ra për gabimin e një komandanti, i cili në një pjesë të frontit nuk kishte vendosur batalionin që ishte caktuar dhe se nuk u gjend as vetë në vendin e luftimit. Kështu, sipas tij, ishte ai shkaktari i disfatës së Vicit, prandaj më tha «morëm masa dhe e dënuam». Ky ishte një shpjegim shumë simplist nga ana e shokut Niko për një disfatë kaq të madhe.

Unë i thashë haptazi dhe shoqërisht se nuk mund ta besoja një gjë të tillë.

«Në daç beso, në daç mos beso, më tha Nikoja, po kështu është».

Megjithatë vazhdova: - Po tash ç'do të bëhet?

Nikolja u përgjigj: «Do të luftojmë».

- Po ku do të luftoni?

«Në Gramoz, që është një kala e pamposhtur».

Unë i bëra pyetjen: - Ju mendoni të futni atje gjithë Ushtrinë Demokratike Greke?

«Po, u përgjigj Niko Zahariadhis, do ta rifutim të tërë në Gramoz».

I thashë se ju i dini punët tuaja e jeni ju ata që vendosni, por mendimi ynë është që Gramozi nuk mund të qëndrojë më, prandaj nuk duhen sakrifikuar kot gjithë këta trima të Ushtrisë Demokratike Greke, udhëheqësi i së cilës jeni ju. Ne ju kemi shokë dhe miq, për çështjet tuaja bëni ashtu si t'ju duket më mirë, por do të dëshiroja sikur të thërritnit shokun Barxhotas, komandantin e trupave grekë në Gramoz, dhe të bisedonit me të për këtë çështje. Nikolja ma kundërshtoi këtë mendim dhe më tha se kjo gjë ishte e pamundur të bëhej.

Më vonë e dimë çfarë ngjau. Gramozi u bë disfata e fundit e Ushtrisë Demokratike Greke.

Gramozi u shpartallua brenda katër ditëve. Atje, sipas mendimit tonë, lufta nuk ishte e organizuar. U qëndrua në një difensivë complete dhe pasive. Nuk përjashtojmë që të jenë zhvilluar luftime të ashpra në disa pika, si në Polje dhe në Kamenik, ku ushtarë demokratë grekë rezistuan me heroizëm. Gjithë tërheqja e Gramozit, me përjashtim të forcave të Kamenikut, u bë e çrregullt, si ajo e Vicit. Ushtarë dhe komandantë të Ushtrisë Demokratike Greke pëshpëritin për taktikën e gabuar difensive që është përdorur në Gramoz.

Këtë gjë na e ka kotnfirmuar dhe shoku Zahariadhis.

Ne mendojmë se shokët udhëheqës grekë në luftën e Gramozit dhe të Vicit nuk mbajtën parasysh parimet marksiste-leniniste të luftës popullore. Kolonat monarko-fashiste mbërritën në pozicionet e tyre të paracaktuara me një shpejtësi të madhe dhe pa u shqetësuar. Ato kaluan me shpejtësi nëpër krehëret e maleve, bënë rrethimin e forcave demokratike, të cilat ishin mbyllur në llogore dhe nuk kundërsulmonin; armiqtë sulmuan, nxorën partizanët nga llogoret dhe pushtuan fortifikatat. Komanda demokratike greke i kishte shpërndarë forcat në pozicione të fortifikuara, nuk përdori rezervat për kundërsulm dhe të shkatërronte me sulme të vazhdueshme e manovrimet të shpejta ofensivë të armikut. Ne mendojmë se pikëpamjet e tyre të gahuara mbi taktikën e luftës shkaktuan disfatën. Elementi njeri ishte në lartësinë e momentit, ishin partizanë të vjetër dhe të provuar në luftë, me një moral të lartë dhe që luftonin me heroizëm.

Nga ana tjetër, duke zbatuar taktikën e saj të mbrojtjes pasive, udhëheqja e Partisë Komuniste Greke lejoi rigrLipimin dhe riorganizimin e ushtrisë monarko-fashiste, nuk sulmoi për të goditur përgatitjet e armikut në mënyrë që të dështonte ofensiva e tij ose të paktën të dobësohej për t'u lejuar kështu forcave të gjalla të Ushtrisë Demokratike Greke të mzanovronin në shkallë të gjerë dhe të goditnin vazhdimisht dhe kudo forcat e armikut. Këto janë disa ndër arsye që kanë shkaktuar, sipas mendimit tonë, disfatat e fundit në Gramoz dhe në Vici. Në analizën që Byroja Politike e PK Greke i ka bërë disfatës së Vicit thotë se «udhëheqja ka përgjegjësi të rëndë», por ajo nuk thotë asgjë se ku qëndron kjo përgjegjësi dhe më poshtë s'mungon që këtë përgjegjësi ta shpërndajë nga të katër anët. Ne mendojmë se kjo s'është një analizë marksiste-leniniste.

Për të pasur sukses në luftën e tyre, shokët grekë nuk duhej të kishin ndjekur taktikën e mbrojtjes pasive, por duhej të kishin zbatuar mirë parimet marksiste-leniniste mbi kryengritjen e armatosur. Taktika që duhej ndjekur, ne mendojmë se duhet të kishte për qëllim ta dëmtonte armikun në shumë drejtime në mënyrë të vazhdueshme, t'ia bënte armikut gjendjen të pasigurt në çdo minutë, ta detyronte atë të shpërndante forcat e tij, t'i fuste panikun dhe tmerrin, t'ia bënte të pamundur kontrollin e gjendjes. Kështu lufta revolucionare e popullit grek do të rritej vazhdimisht, ajo fillimisht do ta shqetësonte armikun, më pas do të bënte që armiku të mos e kontrollonte dot situatën, do të bënte që të çliroheshin krahina dhe zona të tëra deri në qëllimin e mëtejshëm, dornethënë deri në kryengritjen e përgjithshme dhe çlirimin e gjithë vendit. Në këtë mënyrë lufta partizane në Greqi kishte një perspektivë zhvillimi.

Shumë herë, në bisedat që kemi pasur me ta, ne u kemi thënë shoqërisht shokëve grekë se Ushtria Partizane Greke duhet të përpiqet që armatimet duhet t'i marrë nga armiku me luftë; të luftojë me armët e armikut dhe ushqimin e veshmbathjen t'i marrë nga populli bashkë me të cilin e për të cilin do të luftojë.

Ushtria Partizane, u kemi thënë shokëve tanë grekë, në radhë të parë, duhet të lidhet me popullin nga i cili është shkëputur dhe pa të cilin as nuk mund të ekzistojë. Populli duhet të mësohet që të luftojë bashkë me ushtrinë dhe ta ndihmojë e ta dojë këtë si çlirimtarin e vet. Kjo është konditë e domosdoshme. Populli duhet të mësohet që të mos i dorëzohet armikut dhe radhët e ushtrisë të përforcohen me burra e gra, me të rinj e të reja të popullit, nga vetë Greqia.

Po ashtu ne, në mënyrë shoqërore, u kemi thënë shokëve grekë që në Ushtrinë Partizane Greke duhet të sigurohet më mirë roli udhëheqës i partisë; komisar politik në kompani, në batalion, në brigadë, në divizion duhet të jetë përfaqësuesi i vërtetë i partisë dhe, si i tillë, të ketë të drejtën e komandës njësoj sikurse edhe komandanti. Por ne kemi vënë re dhe shumë herë ua kemi vënë në dukje shokëve se rolin drejtues të partisë në ushtri ata nuk e kanë parë drejt. Për këtë problem unë edhe më parë i kam shfaqur shokut Stalin mendimin e Partisë sonë dhe në letrën që i kemi drejtuar

gjithashtu e trajtojmë këtë gjë. Moskuptimi i rolit udhëheqës të Partisë në ushtri, mendojmë ne, ishte një ndër arsyt kryesore që çoi në disfatën e luftës së Ushtrisë Demokratike Greke. Ne gjithnjë nisemi nga mësimi marksist-leninist se komandanti dhe komisari politik formojnë një unitet që drejton veprimet ushtarake dhe edukimin politik të njësiteve, se ata që të dy janë njëloj përgjegjës për gjendjen e repartit të tyre në çdo pikëpamje, se që të dy, komandanti dhe komisari, drejtojnë në luftë njësinë e tyre, repartin e tyre.

Pa komisarët politikë nuk do të kishim Ushtri të Kuqe, na mëson Lenini. Në Ushtrinë tonë Nacionalçlirimtare dhe tash në Ushtrinë tonë Popullore kemi ndjekur dhe vazhdojmë të ndjekim këto parime. Në Ushtrinë Nacionalçlirimtare Greke, ELAS, komandanti dhe komisari, si komandë e përbashkët, kanë pasë ekzistuar, por në praktikë kjo nuk zbatohet si duhet. Presioni i pikëpamjeve të gabuara borgjeze të komandantëve të karrierës që nuk duronin të kishin përbri, në komandë, njerëz të besuar të Partisë, ka pasur si rrjedhim që në atë kohë në Ushtrinë Demokratike Greke roli i komisarit në komandë të errësohej dhe të lihej në radhën e dytë. Kjo është konsekuencë e pikëpamjeve të udhëheqësve të Partisë Komuniste Gr else mbi «ushtrinë e rregullt». Shokët udhëheqës grekë eliminimin e rolit të komisarit politik përpiqen ta arsyetojnë duke marrë si shembull tipin e tishtrisë së ndonjë vendi tjetër, por ne mendojmë se shokët grekë në këtë çështje nuk janë realistë.

Gabime të tilla u vunë re edhe pasi Ushtria Nacionalçlirimtare Greke rifilloi luftën. Që prej largimit të gjeneral Markosit, kjo ushtri nuk ka pasur komandant të përgjithshëm. Ne mendojmë se një situatë e tillë s'ka qenë e drejtë. Te ne Sekretari i Përgjithshëm i Partisë ka qenë dhe është njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë. Ne mendojmë se kjo është e drejtë. Në kohë paqeje mundet të mos jetë kështu, mund të ketë Ministri të Mbrojtjes, po në konditat e Ushtrisë Demokratike Greke, kur ajo që në luftë e sipër, duhet të kishte një komandant të përgjithshëm të ushtrisë dhe kemi menduar dhe mendojmë, sipas eksperiencës sonë, se ky funksion politik dhe ushtarak i përket sekretarit të përgjithshëm të partisë. Këtë pikëpamje tonën ua kemi shfaqur shumë herë shokëve grekë. Arsyet që shokët grekë na kanë dhënë për të treguar pse nuk është vepruar kështu tek ata, nuk kanë qenë bindëse. Shokët grekë na kanë thënë se «shoku Zahariadhis është shumë modest», ose «u dogjëm me Titon që ishte njëkohësisht sekretar i përgjithshëm, kryeministër dhe komandant suprem i ushtrisë». Neve na duket se këtu s'kemi të bëjmë me çështje modestie; kjo s'ka lidhje as me thënien për Titon, pas së cilës na është dukur se bëhen insinuata të tjera.

Ne jemi çuditur me një sërë formash të mbuluara që përdornin shokët grekë, por shihnim se realiteti ishte krejt ndryshe. Këto ne nuk mund t'i shpjegojmë përveçse me përshtypjen tonë që në shokët grekë kishte konfuzion, kishte oportunitizëm, modesti false, kishte fshehje të rolit udhëheqës të partisë. Mundet që sekretari i përgjithshëm i partisë të mos jetë kryekomandant i ushtrisë, por një ushtri që lufton, të mos ketë një Aryekomandant, siç ishte rasti i Ushtrisë Demokratike Greke pas heqjes së Markosit, na është dukur e na duket e gabuar.

Për këtë situatë dhe për disfatat që rrodhën më pas, shokët grekë nuk bëjnë përgjegjës askënd, përgjegjësinë e ndajnë duke ia veshur dhe atij që ka faj dhe atij që s'ka faj. Fajin ata ua hedhin gjithë anëtarëve të Partisë, gjë që s'është aspak e drejtë, pse anëtarët e Partisë Komuniste Greke kanë luftuar dhe luftojnë me heroizëm. Ne mendojmë se shokët udhëheqës grekë kanë frikë të `hellohen në këto gabime që ne i quajmë të rënda, kanë frikë t'i vënë gishtin plagës. Mendojmë gjithashtu se në disa shokë udhëheqës grekë mungon kritika dhe autokritika dhe «shoqërisht» mbrojnë shoku-shokun për gabimet që kanë bërë.

Shokët udhëheqës grekë kanë qenë në kundërshtim me pikëpamjet tona, të cilat ua kemi shfaqur në mënyrë shoqërore si komunistë internacionalistë që luftojnë për të njëjtën çështje, që kemi interesa të mëdha të përbashkëta, që na dhimbej qështja e luftës së popullit grek. Ata nuk i kanë pritur mirë vërejtjet tona.

Shumë gjëra të papëlqyera ka ngritur shoku Niko Zahariadhis kundër nesh, të cilat, natyrisht, ne ia kemi hedhur poshtë. Dihet tashmë deklarata e tij për «Vorio-Epirin» që përmenda në fillim. Veç të tjerave, ai u grind me ne duke na akuizuar se gjoja kishim rekuizuar kamionët grekë që shërbenin për transportimin e refugjatëve e të materialeve të tyre dhe kërkoi që ne të mobilizonim edhe

kamionët tanë për nevojat që kishin. Që ne i kemi përdorur kamionët grekë për transportimin e refugjatëve grekë për në vendet e caktuara për ta, kjo është plotësisht e vërtetë. Refugjatët grekë ne i kemi marrë dhe i kemi transportuar në Shqipërinë e Veriut, ku, me gjithë vështirësitë tona, na u desh t'i furnizonim edhe me ushqime, pia të ndanim kafshatën e gojës me ta. Për sa u përket mjeteve tona, parkun e kamionëve e kishim shumë të vogël dhe me anën e tyre na cluhej të furnizonim anekënd me çdo gjë gjithë Shqipërinë.

Shokët grekë na i-itikojnë gjithashtu që ne nuk u kemi dhënë precedencë shkarkimit të ndihmave materiale, si veslimbathje, ushqime, çadra, batanije etj., që erdhën për refugjatët grekë në portet tona, para se refugjatët të largoheshin nga Shqipëria. Kjo nuk është e vërtetë. Ndihmat që :-inin nga jashtë me vaporë për refugjatët grekë, qëllonin që ishin nën materialet e malli at që vinin për re. Në rastet e Lilla, kuptohet, se duhet të hiqeshin më parë ngarkesat që janë sipër, pastaj ato poshtë, ndryshe nuk kishte si të bëhej; ne s'dimë ndonjë metodë që ta shkarkosh anijen nga fundi.

Sidoqoftë këto ishin mosmarrëveshje të vogla që kapërceheshin, ashtu sikundër u kapërcyen. Çështje vendimtare ishin ato të vijës politike e ushtarake të Partisë Komuniste Greke gjatë viteve të luftës, për të cilat unë fola më lart.

Shokët grekë jo vetëm s'i kanë pranuar pikëpamjet e vërejtjet tona, por kemi përshtypjen se ata i kanë marrë shtrembër ato dhe, bile, në letrën e tyre që i drejtuan Byrosë sonë Politike para disa kohësh, ata i krahasojnë pikëpamjet e qëndrimet tona parimore, në mënyrë të palejueshme dhe antimarksiste, të njëllajta me pikëpamjet e titistëve. Duke deformuar pikëpamjet e shfaqura nga shoku Mehmet Shehu për luftën e Vicit e të Gramozit për Via përshtatur arsyetimit të tyre jo të drejtë, shokët udhëheqës grekë, sipas mendimit tonë, kanë qëllim të fshehin gabimet e bëra nga ana e tyre. Ne i kuptojmë momentet e rënda që ka kaluar udhëheqja e Partisë Komuniste Greke pas disfatës së Vicit e Gramozit dhe momentet e nervozizimit që kanë ekzistuar ndër ta, por akuza të tilla të rënda, të pabazuara janë për ne të papranueshme dhe që duhet të maten dhe të peshohen mirë më parë se të thuhet, sidomos nga ana e Byrosë Politike të Partisë Komuniste Greke.

Pas këtyre akuzave, të cilat Byroja jonë Politike i gjykoi me gjakftohtësi, ne menduam se bëhej akoma më i domosdoshëm edhe largimi i atyre pak refugjatëve demokratë grekë që kishin mbetur ende në Shqipëri.

I kemi drejt apo gabim këto pikëpamje e qëndrime që kemi mbajtur, shoku Stalin le të na e thotë, ne jemi gati të njohim çdo gabim të mundshëm dhe të bëjmë autokritikë.

Shoku Stalin, duke m'u drejtuar mua, më ndërpreu fjalën dhe më tha:

- Kur shokët janë në fatkeqësi, nuk duhet t'u bihet me shqelm.

- Keni të drejtë, shoku Stalin, iu përgjigja, por ju siguroj se kurrë nuk u kemi rënë me shqelm shokëve grekë. Çështjet që shtrënim për diskutim, kishin rëndësi të madhe edhe për Ushtrinë Greke, edhe për ne. Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk mund të lejonte që udhëheqja e Partisë Komuniste Greke të kishin qendrën e veprimeve të sa në Shqipëri, nuk mund të lejonte, gjithashtu, që në vendin tonë të organizoheshin e të stërviteshin trupa për të rifilluar luftën në Greqi. Këtë unë ia kam thënë shoqërisht shokut Niko Zahariadhis, i cili qysh më parë kishte kërkuar që refugjatët grekë të shkonin në vende të tjera e që, në fakt, kështu ka ndodhur me shumicën e refugjatëve. Fjala ishte për një numër të kufizuar prej tyre që akoma kishin mbetur në vendin tonë. Ne nuk e kemi vënë kurrë çështjen që t'i dëbojmë refugjatët grekë nga vendi ynë, por përveç kërkesës që bënte vetë shoku Niko, që refugjatët të shkonin në vende të tjera, vetë logjika e drejtë na impononte për fundimin që, në rrethanat e krijuara, edhe ata që kishin mbetur duhej të largoheshin doemos nga Shqipëria.

Këto ishin problemet që unë desha të ngrija, probleme të cilat i kemi ngritur si me shokët grekë edhe në letrën që ju kemi dërguar më parë juve, shoku Stalin.

- Mbaruat? - më pyeti shoku Stalin.

- Mbarova, i thashë.

Atëherë ai ia dha fjalën shokut Zahariadhis.

Ky filloi të mbrojë Varkizën, duke theksuar se marrëveshja e nënshkruar atje nuk ishte gabim dhe e zhvilloi më gjerë këtë temë. Të njëjtat pikëpamje më kishte shprehur edhe mua më parë.

Për të shpjeguar arsyen e disfatës, në mes të tjerash, Zahariadhisi ngriti çështjen: «Po ta dinim që më 1946 se do të tradhtonte Titoja, nuk du ta kishim filluar luftën kundër monarko-fashistëve grekë». Ai shtoi pastaj edhe dica «arsye» të tjera për të shpjeguar disfatën, duke përsëritur se u mungonin armatimet, se shqiptarët, megjithëse u kanë dhënë kafshatën e gojës refugjatëve, prapëseprapë kanë nxjerrë disa pengesa etj. Disa probleme të dorës së dytë Zahariadhisi i ngriti si çështje parimore. Ai për mendim pastaj kërkesën tonë (që edhe ai vetë e kishte ngritur më parë) që dhe ata refugjatë demokratë grekë që ndodheshin akoma te ne të largoheshin nga Shqipëria. Sipas tij kjo gjë i jepte fund Luftës Nacionalçlirimtare Greke.

Dëshiroj të shpreh me këtë rast përshtypjen time që shoku Niko Zahariadhisi ishte shumë i zgjuar, me kulturë, par sipas mendimit tim, jo sa duhet marksist. Ai, me gjithë disfatën e pësuar, filloi të flasë në mbrojtje të strategjisë dhe të taktikës që kishte ndjekur Ushtria Demokratike Greke, duke ngulur këmbë se kjo strategji e taktikë kishin qenë të drejta, se ata nuk mund të vepronin ndryshe. Ai e shtjelloi gjerë e gjatë këtë çështje. Pra, secili nga ne qëndronte në pozitën e veta.

Kështu foli Niko Zahariadhisi. Biseda e tij zgjati aq kohë sa imja, në mos më shumë.

Shoku Stalin dhe shokët e tjerë udhëheqës sovjetikë e dëgjuan edhe atë me vërejtje.

Pas Nikos, shoku Stalin pyeti Miço Parcalidhisin

- A keni ju ndonjë mendim për të shprehur rreth atyre që thanë shokët Enver Hoxha dhe Niko Zahariadhisi?

- Nuk kam asgjë tjetër për të thënë veç atyre që parashtrori shoku Niko - u përgjigj Parcalidhisi dhe shtoi se ata ishin në pritje të gjykimit të çështjeve nga ana e shokëve sovjetikë dhe e Partisë Bolshhevike.

Atëherë e mori fjalën Stalini, i cili foli në mënyrë të qetë, siç e kemi njohar kurdoherë që jemi takuar me të. Foli me terma të thjeshtë, të prerë dhe të ashpër. Lëzakonisht të qartë. Ai pohoi se iifta e popullit grek që një luftë heroike, gjatë së cilës u treguan trimëri, por u vërtetuan edhe gabime.

- Për sa i përket Varkizës shqiptarët kanë të drejtë - theksoi Stalini dhe, pasi e shtjelloi këtë problem, shtoi: - Ju, shokë grekë, duhet të kuptoni se marrëveshja e Varkizës ishte një gabim i madh. Ju nuk duhej ta kishit nënshkruar atë dhe as të lëshonit armët, se ajo i ka shkaktruar dëm të madh luftës së popullit grek.

Për sa i përket vlerësimit të strategjisë dhe të taktikës suaj të ndjekur në luftën demokratike greke, megjithëse kjo luftë ishte heroike, mendoj se shokët shqiptarë, prapë kanë të drejtë. Ju duhej të bënit një luftë partizane, pastaj nga fazat e kësaj lufte të kalonit në luftën frontale.

Unë e kritikova shokun Enver Hoxha, të cilit i thashë se në fatkeqësi shokut nuk i duhet rënë me shqelm, por, nga sa dëgjuam këtu, del se shokët shqiptarë kanë mbajtur qëndrin të drejtë ndaj pikëpamjeve dhe veprimeve tuaja. Rrethanat që u krijuan dhe kushtet e Shqipërisë ishin të atilla që ju nuk mund të qëndronit në atë vend, pse kështu mund të vihej në rrezik pavarësia e Republikës Popullore të Shqipërisë.

Ne pranuar kërkesën tuaj që të gjithë refugjatët demokratë grekë të kalonin në vende të tjera dhe tashmë të gjithë ata janë tërhequr. Çdo gjë tjetër, si armët, municionet etj., që shokët shqiptarë u morën atyre ushtarëve demokratë grekë që kapërcyen kufirin dhe hynë në Shqipëri, i përkitnin Shqipërisë, nënvizoi Stalini. Prandaj armët duhet të qëndronin në Shqipëri, tha ai, sepse ky vend, duke i pranuar ushtarët demokratë grekë, megjithëse i çarmatosi, prapëseprapë kishte rrezikuar pavarësinë e vet.

Për sa i përket mendimit tuaj, sipas të cilit «po ta dinim që më 1946 se do të tradhtonte Titoja, nuk do të kishim filluar luftën kundër monarko-fashistëve», ky është i gabuar, theksoi Stalini, pse për lirinë e popullit duhet luftuar edhe kur je në rrethim. Megjithatë duhet ditur se ju nuk ishit në gjendje rrethimi, pse në krah tuaj nga veriu kishit Shqipërinë dhe Bullgarinë; në përkrahje të luftës suaj të drejtë qenë të gjithë. Ne kështu mendojmë, përfundoi shoku Stalin dhe shtoi:

- Çfarë thoni, ju, shokë shqiptarë, Hoxha dhe Shehu?

- I pranojmë të gjitha mendimet tuaja - u përgjigjëm ne.

- Po ju, shokë grekë, Zahariadhisi dhe Parcalidhisi, çfarë thoni?

Shoku Niko tha:

«Ju na ndihmuat shumë, tash e kuptojmë që nuk kemi vepruar drejt dhe do të përpiqemi t'i ndreqim gabimet tona», e të tjera e të tjera.

- Shumë mirë - tha Stalini duke rimarrë fjalën. - Atëherë kjo çështje konsiderohet e mbyllur.

Në kohën kur ts gjithë po bëheshim fiati të largoheshim, ndërhyri Molotovi, dulce i thënë Niko Zahariadhisi:

- Kisha diçka për t'ju thënë, shoku Niko. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ka marrë një letër nga një shoku juaj në të cilën shkruan se «Niko Zahariadhisi është agjent i anglezëve». Nuk na përket neve ta zgjidhim këtë çështje, por nuk mund ta mbajmë të fshehur pa ju vënë në dijeni mbi përmbajtjen e saj, sidomos kur në të akuzohet një shok udhëheqës i Partisë Komuniste Greke. Ja edhe letr a. Çfarë thoni ju për këtë?

- E shpjegoj unë këtë çështje - u përgjigj Niko Zahariadhisi dhe tha: - Kur trupat sovjetike na çliruan nga kampi i përqendrimit unë shkova në komandën sovjetike për të kërkuar që të më dërgonin sa më parë në Athinë, se atje e kisha vendin. Ishin momente vendimtare që unë duhej të gjendeslla në Greqi. Por komanda juaj në ato momente nuk kishte me se të më transportonte. Atëherë u detyrova të shkoja në komandën angleze, ku kërkoja të më çonin në atdhe. Anglezët më hipën në një avion dhe kështu u ktheva në Greqi. Kthimin tim në atdhe nëpërmjet komandës angleze ky shok e konsideron sikur unë jam bërë agjent i anglezëve, gjë që nuk është e vërtetë.

Stalini ndërhyri e tha:

- E qartë, edhe kjo çështje mbyllet. Mbaroi takimi !

Stalini u ngrit, na dha dorën të gjithëve me radhë njërit pas tjetrit dhe ne u nisëm të dilnim. Salla ishte e gjatë dhe, kur arritëm pranë derës së daljes, Stalini na thirri:

- Ndaluni pak, shokë! Përqafohuni me njëri-tjetrin, shoku Hoxha dhe shoku Zahariadhisi!

Ne u përqafoam.

Kur dolëm jashtë Miço Parcalidhisi shtoi:

- Nuk ka si Stalini, ai u soll si babai ynë. Tani çdo gjë është e qartë.

Kështu u mbyll ky ballafaqim te Stalini.

TAKIMI I PESTE

Prill 1951

Mbi gjendjen politike, ekonomike e shoqërore në Shqipëri. Reaksioni i jashtëm synon të rrëzojë pushtetin tonë popullor. Vendimi përfundimtar i Gjyqit të Hagës. «Me vigjilencë të lartë dhe me qëndrime të vendosura zbulohen dhe shkatërrohen tentativat e armikut». «Krahas ndërtimit të veprave industriale ju duhet të forconi klasën punëtore dhe të përgatitni kuadro». Mbi kolektivizimin e bujqësisë. «Specialistët sovjetikë t'i keni jo për të qëndruar në zyrë, por për të ndihmuar në terren». Vërejtje të rrepta të shokut Stalin për një pjesë operistike sovjetike që lustronte realitetin. Në Kongresin e 19-të të PK (b) të BS - për herë të fundit me Stalinin e paharruar.

Takimi i fundit që kam pasur me shokun Stalin ka qenë ai që u zhvillua në Moskë më 2 prill 1951 në mbrëmje, në orën 10.30 sipas orës së Moskës. Në këtë takim merrnin pjesë edhe Molotovi, Malenkovi, Beria e Bulganini.

Gjatë bisedimit u prekën probleme të ndryshme mbi gjendjen e brendshme në Parti e në shtetin tonë, mbi çështjet ekonomike, veçanërisht të sektorit të bujqësisë, mbi marrëveshjet ekonomike që mund të përfundoheshin me shtete të ndryshme, mbi forcimin e punës në institutet tona të larta, probleme të situatës ndërkombëtare etj.

Fillimisht unë i fola shokut Stalin në vija të përgjithshme për gjendjen politike në vendin tonë, për punën e madhe që ka bërë e bën Partia për edukimin e masave me frymë të lartë revolucionare, për

unitetin e shëndoshë që është krijuar e forcohet dita-ditës në Parti e në popullin tonë, për besimin e madh e të patundur që ka populli te Partia. - Këto arritje, i thashë shokut Stalin, ne do t'i forcojmë pandërprerje duke qenë kurdoherë vigjilentë e të gatshëm për të mbrojtur pavarësinë e lirinë, integritetin tokësor të vendit dhe fitoret e popullit nga çdo armik i jashtëm dhe i brendshëm që do të përpiqet të na kërcënojë. Në mënyrë të veçantë ne ndjekim me vigjilencë, i thashë shokut Stalin, përpjekjet e panumërta të imperializmit amerikan që me anën e lakenjve të tij, nacionalistëve të Beogradit, monarko-fashistëve të Athinës dhe neofashistëve të Romës, synon të rrëzojë pushtetin tonë popullor, të skllavërojë e të copëtojë Shqipërinë.

E vura, gjithashtu, në dijeni shokun Stalin edhe për vendimin përfundimtar të Gjyqit të Hagës.

- Ky Gjyq, i thashë midis të tjerash, sikurse ju kam thënë edhe më parë, shqyrtoi të ashtuquajturin incident të kanalit të Korfuzit dhe, së fundi, i manipuluar nga imperialistët anglo-amerikanë, na dënoi padrejtësisht me zhdëmtim në favor të anglezëve. Ne nuk e pranuan këtë vendim arbitrar, por anglezët vunë dorë mbi arin tonë që na kishin grabitur nazistët gjermanë në ish-Bankën Kombëtare të Shqipërisë. Kur u zbulua ari i grabitur nga vendet e pushtuara, i transportuar nga nazistët në Gjermani, Komisioni Trepalësh, i ngarkuar për ndarjen e tij, në mbledhjet që bëri në Bruksel në vitin 1948, i caktoi një pjesë nga ato që i përkitnin edhe Shqipërisë. Mbi këtë sasi të arit tonë tash vunë dorë anglezët, të cilët e bilokuan dhe nuk na lejojnë që ta tërheqim atë s~ pas vendimit të marrë në Bruksel.

Lidhje të ngushta dhe tash fare të hapëta po krijohen në mes armiqve të jashtëm të vendit tonë, i thashë më tej shokut Stalin. Provokacionet e tyre kundër nesh kanë qenë të vazhdueshme si nga kufiri jugosllav ashtu edhe nga ai grek e italian, si nga toka, ashtu edhe nga deti e ajri. Në këto tri vende, përveç politikës së hapët antishqiptare që ndjekin qeveritarët në fuqi, janë grumbulluar edhe tradhtarët fashistë, emigrantët shqiptarë, banditë, dezertorë e kriminelë të çdo kallëpi, të cilët përgatiten nga të huajt që të hidhen në Shqipëri për të organizuar lëvizje me armë, sabotime në ekonomi, atentate kundër udhëheqës ve të Partisë e të shtetit, të krijojnë qendra spiunazhi për vete e për padronët e tyre etj.

Ne kemi qenë gjithmonë vigjilentë ndaj këtyre përpjekjeve të reaksionit të jashtëm dhe çdo tentative të tyre i kemi dhënë e do t'i japim përgjigjen e merituar. Ushtria jonë dhe Arma e Sigurimit të Shtetit kanë dhënë kontributin e tyre të madh në këto drejtime, ato janë forcuar pareshtur, janë edukuar mirë dhe po modernizohen hap pas hapi, duke përvetësuar artin ushtarak marksist-leninist. Në vazhdim të fjalës sime i fola shokut Stalin për një sërë problemesh ushtarake dhe për drejtmet kryesore nga mendonim se mund të na vinte një sulm i jashtëm.

- Nga e dini ju se do t'ju sulmojnë në këto drejtime? - më pyeti atë gast shoku Stalin.

Unë iu përgjigja me hollësi për këtë problem dhe ai, pasi më dëgjoi, më tha:

- Për sa u përket problemeve ushtarake që ju ngritët, ne tremi caktuar shokun Bulganin të bisedojë me ju hollësisht.

Pastaj më drejtoi një sërë pyetjesh të tjera si: Me ç'armë e mbroni kufirin? Ku i keni armët trofe? Sa njerëz mund të mobilizoni në rast lufte? Ç'ushtri keni sot? etj.

Unë iu përgjigja me radhë pyetjeve të shokut Stalin. Ndër të tjera fola për lidhjet e fuqishme të ushtrisë sonë me popullin, për faktin që populli e do me gjithë shpirt ushtrinë e vet dhe, në rast të një sulmi të huaj, i thashë shokut Stalin, i gjithë populli ynë është i gatshëm të ngrihet në këmbë për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e vendit, pushtetin popullor.

Pasi dëgjoi përgjigjet e mia për këto probleme, fjalën e mori shoku Stalin. Duke shprehur gezimin e tij për forcimin e ushtrisë sonë dhe për lidhjet e saj me popullin, ai ndër të tjera më këshilloi:

- Mendoj se mjaft e keni ushtrinë efektive, prandaj ju këshilloj të mos e shtoni më tepër se mbajtja e saj ju kushton. Ju duhet të shtoni pak tanket dhe avionët.

Në situatën aktuale trini kujdes që të mos u vijë ndonjë rrezik nga Jugosllavia. Titistët kanë agjentë te ju, bile do t'ju futin edhe të tjerë. Ata duan t'ju atakojnë, por nuk munden, sepse kanë frikë. Ju s'duhet të trembeni, por t'i viheni punës që të forconi ekonominë, të edukoni kuadrot, të forconi Partinë, të jeni vigjilentë dhe të stërvitni ushtrinë. Po të treni Parti, ekonomi dhe ushtri të fortë, mos trini aspak frikë nga kurrkush.

Monarko-fashistët grekë, tha ndër të tjera në vazhdim të fjalës ai, kanë frikë prej bullgarëve, se mos këta të fundit i sulmojnë. Edhe jugosllavët, për të siguruar ndihmë nga amerikanët, bërtasin se gjoja do të sulmohen nga Bullgaria. Bullgaria s'ka të tilla qëllime as kundrejt grekëve as kundrejt jugosllavëve.

Në vazhdim të bisedës i foli shokut Stalin për punën e madhe që bëhet te ne për forcimin e unitetit në popull e midis popullit e Partisë dhe për goditjet që u kemi dhënë elementëve tradhtarë e armiq brenda vendit. I thashë se me të tillë elementë ne nuk jemi treguar të lëkundur e oportunistë, por kemi marrë masat e duhura për të mënjanuar çdo pasojë të veprimtarisë së tyre armiqësore. Ata që me veprimtarinë e vet kriminale e armiqësore e kanë mbushur kupën, i thashë shokut Stalin, u janë dorëzuar gjyqeve tona dhe kanë marrë dënimin e merituar.

- Mirë keni bërë - më tha Stalini. - Armiku, vazhdoi ai, do të përpiqet të futet edhe në Parti, bile edhe gjer në Komitetin e saj Qendror, por me vigjilencë të lartë dhe me qëndrime të vendosura zbulohen dhe shkatërrohen tentativat e tij.

Me shokun Stalin edhe këtë radhë ne diskutuam gjerësisht për situatën tonë ekonomike, për arritjet dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit tonë. I foli, midis të tjerash, shokut Stalin për sukseset e politikës së Partisë në lidhje me industrializimin socialist të vendit e të zhvillimit të bujqësisë dhe për disa nga parashikimet tona për planin e parë pesëvjeçar 1951-1955.

Shoku Stalin, si gjithmonë, tregoi një interesim të madh për gjendjen tonë ekonomike dhe politikën e Partisë në këtë drejtim. Më pyeti me radhë se kur mbaronin kombinati i tekstileve, fabrika e sheqerit dhe vepra të tjera industriale që ngriheshin në vendin tonë.

Iu përgjigja pyetjeve të shokut Stalin dhe theksova se krahas sukseseve të arritura për ndërtimin e këtyre veprave, të objekteve të tjera industriale e sociale, si edhe në fushën e bujqësisë, ne kemi pasur gjithashtu edhe një sërë mosrealizimesh. Shkaqet e mosrealizimeve ne i analizuam në Komitetin Qendror të Partisë me frymën e kritikës e të autokritikës dhe përcaktuam përgjegjësitë që i takojnë secilit. Në mënyrë të veçantë ne po i kushtojmë rëndësi forcimit të rolit udhëheqës të Partisë, bolshevizimit të vazhdueshëm të jetës së saj, lidhjes sa më të ngushtë me masat e popullit, i thashë shokut Stalin, dhe vazhdova t'i bëja një përmbledhje të gjendjes së brendshme në Partinë tonë.

- Përse na i thoni ne këto probleme, që ju, i dini më mirë, shoku Enver? - më ndërpreu shoku Stalin dhe vazhdoi: - Ne na vjen mirë që te ju po ngrihen një varg veprash industriale. Por unë dua të theksoj që krahas ndërtimit të veprave industriale, ju duhet t'i vini rëndësi të madhe edhe forcimit të klasës punëto.re dhe përgatitjes së kuadrove. Partia në mënyrë të veçantë duhet të ketë kujdes, për klasën punëtore, e cila do të krijohet e do të forcohet dita-ditës krahas me zhvillimin e industrisë në Shqipëri.

- Në mënyrë të veçantë - i thashë në vazhdim të bisedës shokut Stalin - çështja e zhvillimit dhe e përparimit të bujqësisë ka një rëndësi të madhe për ne. Ju e dini se vendi ynë është një vend bujqësor që ka trashëguar një prapambetje të madhe nga e kaluara. Pikësynimi ynë ka qenë dhe është shtimi i prodhimeve bujqësore dhe, dulce marrë parasysh që pjesa më e madhe e bujqësisë përbëhet nga ekonomi të vogla private, na është dashur e do të na duhet të marrim masa të shumta për ta ndihmuar e për ta inkurajuar fshatarin që ai të punojë më mirë dhe të prodhojë më shumë. Rezultate janë arritur, shtim të prodhimit ka, -por ne jemi të ndërgjegjshëm se niveli i tanishëm i bujqësisë nuk i përgjigjet siç duhet rritjes së nevojave të vendit për prodhimet ushqimore të popullsisë, për lëndën e parë të industrisë dhe për -zgjerimin e burimeve të eksportit. Ne e dimë se rruga e vetme që do ta nxjerrë përfundimisht bujqësinë tonë nga prapambetja e do ta vërë në baza të shëndosha për një prodhim të madh, është ajo -e kolektivizimit. Por në këtë drejtim ne kemi qenë ~e jemi të matur.

- Keni shumë kooperativa tani në Shqipëri? - më pyeti shoku Stalin.

- Rreth 90, i thashë.

- Si është gjendja e tyre? Si jetojnë fshatarët në këto kooperativa? - më pyeti sërish ai.

- Shumica e këtyre kooperativave - i thashë shokut Stalin në përgjigje të pyetjes së tij nuk kanë më tepër se 1-2 vjet jetë, por sidoqoftë një pjesë e tyre po e tregojnë epërsinë ndaj pronës së vogël e të

copëtuar individuale. Puna e përbashkët dhe e organizuar, ndihma e vazhdueshme, e shtetit për këto kooperativa me farëra, me mjete të mekanizuara, me kuadro etj., kanë bërë që prodhimi në to të vihet në baza më të shëndosha e të shënojë ngritje. Megjithatë mbetet shumë për t'u bërë që kooperativat bujqësore të bëhen shembull e model për fshatarësinë individuale. Prandaj edhe pikësynimi ynë kryesor në fushën e organizimit të bujqësisë sonë është që krahas forcimit të kooperativave ekzistuese, ndihmës e kujdesit më të madh për to, të hidhen hapa të matur edhe për krijimin e kooperativave të reja.

Stalini, pasi më dëgjoi, më këshilloi:

- S'duhet të shpejtoheni në ngritjen e kooperativave të tjera bujqësore. Përpiquni të forconi ato kooperativa që keni, por ama rendimen-. tet e kulturave bujqësore të këtyre kooperativave duhet të jenë të larta. - Kështu, vazhdoi ai, nga rezultatet e mira të prodhimit në kooperativë do të jenë të kënaqur anëtarët e saj dhe nga këta do të shohin e do të kërkojnë të kolektivizohen edhe të tjerët.

Derisa fshatarët s'janë të bindur për epërsinë e pronës kolektive, s'keni gjë në vijë për shtimin e numrit të kooperativave. Nëse kooperativat ekzistuese do t'u japin fitime fshatarëve, atëherë edhe fshatarët e tjerë do t'ju ndjekin.

Biseda me shokun Stalin për problemet e bujqësisë sonë, për gjendjen e fshatarësisë, për traditat e mentalitetet e saj zuri pjesën më të madhe të kohës në këtë takim. Shoku Stalin ishte i interesuar të dinte sa më shumë, ai interesohej gjer në hollësi, gëzohej për sukseset, por nuk mungonte të na bënte edhe vërejtje shoqërore e të na jepte këshilla të vyera se si ta përmirësonim në të ardhmen punën tonë.

- Misri vazhdon të jetë kultura kryesor e e arave në Shqipëri? - më pyeti shoku Stalin.

- Po, i thashë, misri e pas tij gruri. Megjithatë këto vitet e fundit po përhapen më shumë edhe pambuku, luledielli, perimet, panxharsheqeri etj.

- Mbillni shumë pambuk? Ç'rendimente merrni?

- Po e rritim vazhdimisht sipërfaqen e mbjellë me këtë kulturë industriale dhe bujqit tanë kanë fituar tashmë një eksperiencë jo të vogël. Sivjet mendojmë të mbjellim afër 20 000 hektarë, i thashë, por për sa u përket rendimenteve të marra nga pambuku dhe cilësisë së tij jemi akoma prapa. Gjer tani kemi arritur një mesatare prej afër 5 quintalë pambuk për hektar. Neve na duhet ta përmirësojmë këtë situatë. Shumë herë e kemi diskutuar e analizuar këtë problem i cili ka rëndësi të madhe për ne, sepse është i lidhur me veshjen e popullit, kemi marrë e marrim masa të shumta, por akoma s'kemi arritur rezultatet e duhura. Kultura e pambukut do diell dhe ujë. Ne diell kemi, i thashë shokut Stalin, dhe toka e klima janë të përshtatshme për zhvillimin e kësaj kulture, por sa për ujitjen jemi akoma mbrapa. Na duhet të krijojmë një sistem të mirë ujitës që edhe kjo kulturë të ecë përpara.

- Fshatarët tuaj kujt i japin më shumë ujë, misrit apo pambukut? - më pyeti Stalini.

- Misrit, i thashë unë.

- Domethënë se fshatarët akoma s'e duan pambukun, e nënvleftësojnë atë, tha ai.

Në vazhdim të bisedës i thashë shokut Stalin se edhe kohët e fundit ne diskutuam për dobësitë e shfaqura dhe detyrat që na dalin në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të kulturës së pambukut. Theksova se nga konsultat e bëra në terren doli që në disa raste, veç të tjerash, është përdorur farë jo e përshtatshme për kushtet tona dhe i paraqita disa kërkesa për ndihmë me qëllim që të vazhdonte puna normalisht si në kombinatin e tekstileve ashtu edhe në uzinën e zhveshjes së pambukut.

- Unë mendoj që në këtë çështje mund të ketë gabuar ndonjë specialist, tha ai. - Por kryesorja është puna e bujqit. Për sa u përket kërkesave që bëtë ju për pambukun, ne do t'ju plotësojmë të gjitha në qoftë se janë të nevojshme. Megjithatë do të shohim.

Disa herë me radhë gjatë këtij takimi shoku Stalin u interesua për kooperativat tona bujqësore, për gjendjen aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të tyre. Mбай mend se ndër të tjera ai më drejtoi- edhe këto pyetje:

- Çfarë makinash kanë kooperativat bujqësore? Si punojnë SMT-të? Keni instruktorë për kooperativat? etj.

Iw përgjigja për sa më pyeti, por ai nuk u kënaq pl.otësisht nga organizimi i punës sonë né këto drejtime, prandaj më tha:

Nuk e keni ashtu siç duhet këtë punë. Kështu ka. rrezik t'i dëmtoni edhe ato kooperativa bujqësore që keni krijuar. Krahas aftësisë të vazhdueshëm të kuadrove tuaj, mirë do të ishte të kishit edhe dica këshilltarë sovjetikë për kooperativat bujqësore. Këta t'i keni jo për të qëndruar né zyrë, por për të ndihmuar né terren.

Né- qoftë se drejtuesit tuaj kryesorë të bujqësisë, vazhdoi shoku Stalin, nuk kanë parë si drejtohen e si organizohen kooperativat bujqësore gjatë, atëherë ata e kanë të vështirë ta drejtojnë si duhet këtë punë, prandaj le të vijne e të shikojnë këtu né Bashkimin Sovjetik, të mësojnë nga eksperiencia jonë e t'ua çojnë bujqve shqiptarë.

Në diskutimin tim i fola shokut Stalin edhe për nevojën e lidhjes së marrëveshjeve ekonomike me shtete të tjera. Shoku Stalin, pasi më dëgjoi, m'u drejtua me këto fjalë:

- Kush ju ka penguar të lidhni marrëveshje me të tjerët? Ju keni traktate me demokracitë popullore, që ju kanë akorduar kredi. Marrëvesh, je si ajo që keni me Bullgarinë, ju lutem, provoni të lidhni edhe me të tjerët. Për këtë ne s'kemi kundërshtim, përkundrazi e quajmë një gjë shumë të mirë.

Gjatë bisedës i shtrova shokut Stalin edhe dosja kërkesa për ndihmë nga ana e shtetit sovjetik për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës sonë. Si né të gjitha rastet e tjera shoku Stalin i priti me bujari kërkesat tona dhe më tha se, për të biseduar hollësisht e për të vendosur mbi këto kërkesa, unë duhet të bisedoja me Mikojanin, me të cilin gjatë atyre ditëve u takova nja tri herë.

Aty për aty shoku Stalin e pranoi kërkesën time për disa pedagogë sovjetikë që na nevojite-. shin né institutet tona të larta, por më pyeti

- Si do të bëjnë pedagogët tanë që nuk e dinë gjuhën shqipe?

Pastaj shoku Stalin, duke më shikuar drejt né sy, më tha

- Ne e kuptojmë drejt gjendjen tuaj, prandaj ju kemi ndihmuar e do t'ju ndihmojmë edhe më shumë. Por unë kam një vërejtje për ju, shoke shqiptarë: Kam studiuar kërkesat tuaja dhe, shoh se për bujqësinë nuk keni kërkuar shumë. Ju doni më shumë ndihma për industrinë, por industria pa bujqësinë nuk mund të mbahet më këmbë dhe të ecë përpara. E kam fjalën, shokë, se duhet treguar kujdes më i madh për zhvillimin e bujqësisë. Ne ju kemi dhënë edhe këshilltarë për t'ju ndihmuar për çështjet ekonomike, shtoi ai, por, me sa duket, ata s'janë të mirë.

- Ata na kanë ndihmuar - i ndër hyra unë. por Stalini, duke mos u bindur për sa i thashë lidhur me këshilltarët sovjetikë, përsëriti mendimin e tij. Pastaj më pyeti duke qeshur:

- Ç'bëtë me farën e misrit gjeorgjian që ju dhashë, e mbollët apo e hodhët nga penxherja?

Ndjeva që u skuqa se më zuri ngushtë dhe i thashë që e kemi shpërndarë në disa zona, por nuk jam në dijeni të rezultateve. Ky qe një mësim i mirë për mua. Kur u ktheva në Tiranë, u interesova menjëherë dhe shokët më thanë që ka dhënë rezultate të mrekullueshme; bujqit që e kanë mbjellë atë kanë arritur të marrin edhe 70 quintalë për hektar dhe kudo po dëgjohet të flitet për misrin gjeorgjian që fshatarët tanë e quajnë «dhurata e Stalinit».

- Po me eukalitet ç'bëtë? I mbollët farët që ju dhashë?

- I kemi dërguar në zonën e Myzeqesë ku ka më tepër moçalishte, i thashë, dhe u kemi dhënë specialistëve tanë të gjitha porositë tuaja.

- Mirë - tha shoku Stalin. - Duhet të kujdesen që të mbijnë e të rriten. Është një dru që rritet shumë shpejt dhe ka efekte të mëdha ndaj lagështirës.

Fara e misrit që ju dhashë mund të shtohet shpejt dhe ju mund ta përhapni në gjithë Shqipërinë - më tha pastaj shoku Stalin dhe më pyeti:

- Keni ju institucione të posaçme që merren me seleksionimin e farës?

- Po, i thashë, kemi krijuar një sektor për farërat nën vartësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe në të ardhmen do ta forcojmë e do ta zgjerojmë më tej.

- Mirë do të bëni! - më tha shoku Stalin. At.a duhet të njohin mirë se ç'lloj bimësh e ç'farëra janë më të përshtatshme për zonat më të ndryshme të vendit dhe t'i sigurojnë ato. Edhe te ne duhet të kërkonim e të merrni farëra që japin dy e tri herë më tepër prodhim. Unë ju thashë edhe më parë, ne do t'ju ndihmojmë me të gjitha mundësitë tona, por kryesorja është puna juaj, shokë, puna e madhe

dhe e pandërprerë për zhvillimin e gjithanshëm të vendit, të industrisë, të bujqësisë, të kulturës, të mbrojtjes.

- Ne do t'i zbatojmë patjetër porositë tuaja, shoku Stalin! - i thashë dhe e falënderova nga zemra për pritjen e ngrohtë e të përzemërt, për këshillat e porositë e vyera që na dha.

Kësa j here qëndrov a në Bashkimin Sovjetik gjatë gjithë muajit prill.

Dina ditë pas këtij takimi, më 6 prill, shkova në «Balshoj Teatër» për të parë pjesën e re operistike «Nga thellësia e zemrës», e cila, siç më thanë para fillimit të shfaqjes, bënte fjalë për jetën e re në fshatin kolkozian. Po atë mbrëmje kishte

ardhur ta shikonte këtë operë edhe shoku Stalin, i cili që ulur në llozhën e katit të parë, përbr i skenës, kurse unë isha në llozhën e katit të dytë, nga krahu tjetër i skenës së bashku me shokët tara e dy shokë sovjetikë që na shoqëronin.

Të nesërmen më thanë se Stalini e kishie kritikuar mjaft rreptë këtë operë, e cila më parë nga disa kritikë arti ishte ngritur në qiell si një krijim muzikor me vlerë.

Shoku Stalin, më thanë, e kritikoi këtë pjes operistike, sepse në të nuk pasqyrohej drejt e objektivisht jeta e fshatit kolkozian. Shoku Stalin kishte thënë se jeta e kolkozit në këtë vepër idealizohej, humbiste vërtetësinë, nuk pasqyrohej lufta e masave kundër të metave e vështirësive të ndryshme, por gjithçka mbulohej nga lustra dhe ideja e rrezikshme se «çdo gjë shkon mirë e bukur».

Më pas kjo operë u kritikua edhe në shtypin qendror të partisë dhe unë e kuptova shqetësimin e thellë të Stalinit kundër fenomeneve të tilla që mbartnin në vetvete farët e një rreziku të madh për të ardhmen.

Nga vizitat e paharruara të atyre ditëve më ka mbetur në mendje edhe ajo që bëra në Stalingrad, ku, veç të tjerash, shkova edhe në kodrën e Mamai Kurganit. Luftëtarët e Ushtisë së Kuqe, me emrin e Stalinit në gojë në vitet e luftës antihitleriane e mbrojtën këtë kodër jo pëllëmbë për pëllëmbë, por milimetër për milimetër. Toka e Mamai Kurganit u lërua dhe ndërroi shumë hërë formën nga bombardimet e tmerrshme, ajo u ndërrua nga një vend me bar e lule që ishte para betejës së famshme të stalingradit, në një vend të mbuluar me hekur e eelik, me mbeturina të ta.nkeve që qenë përplasuf me njëri-tjetrin. U përkula dhe mora me respekt një grusht dhe nga kjo kodër që simbolizon hëroizmat e ushtarit stalinian dhe më pas, kur u kthe-va në Shqipëri, ia dhurova Muzeut të Luftës Nacic~nalçlirimtare në Tiranë.

Nga Mamai Kurgani dukej si në pëllëmbë të dorës gjithë qyteti i dtalingradit, përmes të cilit gjarpëronte lumi i gjerë i Vollgës. Në këtë qytet legjendar, në bazë të planit stalinian për goditjen e hordhive hitleriane, ushtarët sovjetikë shkruan faqe të lavdishme, ata fituan mbi agresorët nazistë dhe shënuan fillimin e kthesës në ngjarjet e krejt Luftës së Dytë Botërore. U dogj, u shkatërrua, u kthye i gjithë në gërmadhë ky qytet që mban emrin e Stalinit të madh, por s'u dorëzua.

Para meje tani hîtpej një pamje krejt tjetër. Qyteti i shkatërruar nga lufta që ndërtuar nga themelet me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Ndërtesat e reja shumëkatëahe të banimit, institucionet socialkulturore, shkollit, universitetet, kinematë, spitalet, fabrikat e uzinat moderne, rrugët e reja të gjera e të bukura, ia kishin transformuar krejt pamjen qytetit. Rrugët ishin plot pemë në gjelbërim, parqet e lulishtet të mbushura me lule dhe fëmijë. Shkova edhe në iuzinën e traktorëve të këtij qyteti dhe u takova me shumë punëtorë. «. , . Ne e duam shumë popullin shqiptar dhe tash né paqe punojmë, gjithashtu edhe për të, më tha një punëtor i kësaj uzine. Ne do t'u dërgojmë edhe më shumë traktorë fshatarëve shqiptarë, ky është vullneti dhe porosia e Stalinit».

Kudo ne e ndjemë dashurinë dhe re,~pektin që kishte edukuar te njerëzit e thjeshtë sovjetikë Stalini i madh, miku i dashur dhe i paharrWr i popullit shqiptar dhe i Partisë sé Punës të Shqipërisë.

Kështu përfundoi edhe kjo vizitë né Igashkimin Sovjetik gjatë sé cilës u takova për herë të fundit direkt me Stalinin e madh, për të cilin, si(; e kam thënë edhe her ë tjetër, ruaj kujtime e mbresa të pashlyeshme që nuk do t'i harroj tërë jetën.

Në tetor të vitit 1952 shkova përsëri në Moskë në krye të delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë për të marrë pjesë në Kongresin e 19-të të PK (b) të BS. Pikërisht atje e pashë për herë të fundit Stalinin e paharruar, atje e dëgjova për herë të fundit zërin e tij aq të dashur e fryrlëzues, atje ai nga tribuna e Kongresit, pasi tregoi se borgjezia ka hedhur hapur përtokë flamurin e, lirive demokratike, të sovranitetit e të pavarësisë, iu drejtua partive komuniste e demokratike dhe nuk kishte marrë pushtetin me fjalët historike: «Unë mendoj se këtë flamur duhet ta ngrini ju, . . . dhe ta shpini atë përpara, në qoftë se doni që të grumbulloni rreth vetes shumicën e popullit, . . . në qoftë se doni të jeni patriotë të vendit tuaj, në qoftë se doni të bëheni forca udhëheqëse e kombit. Atë s'ka njeri tjetër se kush ta ngrëjë».

Të freskët e të gjallë e kam ruajtur dhe do ta ruaj kurdoherë në mendje e në zemër pamjen e tij në atë moment kur nga tribuna e Kongresit, i ngriti peshë zemrat tona. kur i quajti Partinë Komuniste të vendeve socialiste «brigada sulmuese të lëvizjes revolucionare botërore».

Ne u betuam që ato ditë se Partia e Punës e Shqipërisë do ta mbante lart emrin «brigadë sulmuese» dhe se mësimet e porositë të Stalinit do t'i ruante si dritën e syrit, si një amanet historik e do VI vinte në jetë me konsekuencë të plotë. Këtë betim solemn e përsëritëm edhe në ditët e pikëllimit të madh, kur i pavdekshmi Stalin u nda nga ne, dhe jemi krenarë që Partia jonë, si brigadë sulmuese staliniane, kurrë s'e bëri dy fjalën e dhënë. kurrë s'vuri e s'do të vërë tjetër gjë mbi vete veç mësimet e Marksit, Engelsit, Leninit dhe të nxënësit e vazhduesit konsekuent të veprës së tyre, mikut tonë të shtrenjtë. udhëheqësit të lavdishëm Josif Visarionoviç Stalin.